



RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

**“MBI AUDITIMIN E PËRPUTHSHMËRISË NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA”**

Maj 2020



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

	faqe
I.PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
II.HYRJA	4
a. Titulli	4
b. Marrësi	4
c. Objektivat dhe qëllimi	4
d. Identifikimi i çështjes:	4
e. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar	5
f.Përgjegjësia e audituesve.....	5
g.Kriteret e vlerësimit.....	5
h.Standardet e auditimit	6
III.PËRSHKRIMI AUDITIMIT	7
IV.GJETJE DHE REKOMANDIME	8
1.Mbi realizimin e rekomandimeve nga auditimi i mëparshëm.	8
2.Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese (Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtoria), vendimet e marra dhe zbatimi i tyre.	9
3.Hartimi, miratimi dhe realizimi i programit ekonomik-financiar në organet drejtuese të shoqërisë, si dhe realizimi i tij.	9
4.Mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore. Zbatimi i ligjshmërisë gjatë procesit të rekrutimit dhe largimit të punonjësve nga puna.....	13-20
5.Auditim me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit, sponsorizime, etj.).....	20-23
6.Mbajtja e evidencës kontabël, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë, dërgimi dhe miratimi i tij në organet e vartësisë, analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj, ndaj buxhetit të shtetit.....	23-26
7.Zbatimi i ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave.....	26-29
8.Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.....	29-31
9. Mbi respektimin e dispozitave ligjore në lidhjen dhe zbatimin e kontratave me subjektet private që operojnë në port, si dhe zbatimi i tarifave përkatëse.....	32-35
10.Zbatimi i procedurave për arkivimin e dokumentacionit referuar Modelit nr. 8 “Norma tekniko profesionale dhe metodologjisë të shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë” miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në zbatim të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”.....	35-36
V. ANEKSET	50



I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.1 PËRSHKRIM I PROJEKTIT TË AUDITIMIT

Porti Detar Shëngjin është ndërtuar në gjirin e Shëngjinit, pjesa veriore e Republikës së Shqipërisë, dhe ndodhet 67 km në veri-perëndim të Tiranës. Sipërfaqja e basenit uxor është 3.5 ha dhe ka një kanal hyrës 300 m të gjatë dhe 80 m të gjerë si edhe thellësi deri 7 m.

Porti pranon një kapacitet maksimal të anijeve deri në 5000 ton, në varësi të tipologjisë së tyre.

“Porti Detar” Shëngjin sh.a, funksionon si shoqëri aksionare me Vendimin Nr.21243 datë 29.04.1999 të Gjykatës së Rrethit Tiranë. dhe me aksionar të vetëm Ministrinë e Infrastruktues dhe Energjisë.

Organet e shoqërisë janë:

a) Asambleja e Përgjithshme (Aksioner i vetëm, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë).

b) Këshilli Mbikëqyrës i përbërë nga tre anëtarë.

c) Administratori i shoqërisë/Drejtori.

Me Urdhërin Nr. 15135/2 prot, datë 11.09.2019 të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë është emëruar z. Gj. P. në detyrën e Drejtorit të shoqërisë.

Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga 3 anëtarë: M. Dh., L. S. dhe V. C.

Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj në zbatim të Ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar; Rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Portit Detar Shëngjin SHA” miratuar me Vendimin Nr. 4, datë 29.07.2016 nga Këshilli Mbikëqyrës, ndryshuar me Vendimin Nr.2, datë 09.02.2018; Ligjit Nr.9251, datë 08.07.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e strukturave të sigurisë” miratuar me Urdhërin Nr.23, datë 08.01.2018, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë.

Sipas organigramës struktura e shoqërisë përbëhet nga 10 sektorë. Forca e Sigurisë Portuale, Shërbimi Zjarrfikës, Dega e Ngarkim-Shkarkimit dhe Dega e Shërbimeve përbëjnë sektorët operacional, ndërsa Administrata dhe Burimet Njerëzore, Sektori Mekanik, Zyra e Marketingut, Zyra Juridike, Zyra e Investimeve dhe Zyra e Financës përbëjnë pjesën funksionale administrative. Nga auditimi i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, rezultoi që komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit janë të implementuara në shkallë të ulët. Për periudhën 01.01.2017-31.12.2019, në total janë ndërprerë marrëdhëniet e punës për 23 punonjës të shoqërisë, 18 prej të cilëve janë larguar me dorëheqje. Nga mos ndjekja e procedurave ligjore në ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, deri më datë 31.12.2019, kjo shoqëri është palë (e paditur) në 3 çështje gjyqësore në lidhje me marrëdhëniet e punës. Deri më datë 31.12.2019, ka përfunduar gjykimi në gjykatën e shkallës së parë dhe në apel. Vlera e kërkuar dhe e likuiduar është 4,501,760 lekë, vlerë e cila përbën efekt financiar negativ për shoqërinë. Dëm në formën e të ardhurave të munguara jashtë kontratës së qirasë Nr.172Prot., datë 31.07.2019 me subjektin “Rozafa” sh.p.k., për dhënien e sheshit prej 200m² në kalatën lindore, në ndihmë të aktivitetit të peshkimit në vlerën 243,240 lekë. Diferenca të konstatuara në nivelin e pagave janë 2,430,709 lekë, vlerë e cila përbën efekt negativ financiar. Mangësi në procedurat e prokurimit, etj.



II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 973/1, datë 13.12.2019, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 16.12.2019 deri me datë 21.12.2020, u krye auditimi “Mbi zbatimin e përputhshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare” në subjektin “Porti Detar Shëngjin SHA”, për periudhën 01.01.2017 deri më 31.12.2019, me përbërje:

E. S. Përgjegjës Grupi
S. H. Auditues
M. B. Audituese
A. R. Auditues

a. Titulli

Raport mbi auditimin e përputhshmërisë në “Portin Detar Shëngjin SHA”.

b. Marrësi

“Porti Detar Shëngjin SHA”, me Administrator z. Gj. P.

c. Objektivat dhe qëllimi

Objektivi kryesor i grupit të auditimit të KLSH është dhënia e opinionit për përdorimin ligjor të fondeve dhe rregullshmëria financiare e paraqitjes së dokumentacionit që Porti Detar Shëngjin SHA, ka bërë me fondet në dispozicion, në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke audituar rregullaritetin, ligjshmërinë e transaksioneve si dhe argumentimin e shpenzimeve të kryera në funksion të veprimtarisë së shoqërisë. Auditimi ka për qëllim **promovimin e transparencës** duke ofruar raporte të besueshme për fondet nëse janë administruar siç kërkohet në aktet ligjore si dhe nëse u është shërbyer subjekteve sipas standardeve që kërkohen. Gjithashtu, projekti i auditimit ka për qëllim **promovimin e përgjegjshmërisë** ndaj devijimeve të raportimit dhe ndaj shkeljeve të kuadrit ligjor, në mënyrë që të mund të merren veprime korrigjuese dhe personat përgjegjës të përgjigjen për veprimet e tyre. Auditimi i përputhshmërisë i ndërmarrë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ka për qëllim promovimin e qeverisjes së mirë në sektorin publik duke marrë parasysh rrezikun e mashtrimit në lidhje me përputhshmërinë (*sipas ISSAI 400, p 18*).

d. Identifikimi i çështjes: Shoqëria duhet të ketë organizimin e duhur, duhet të funksionojë duke respektuar aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për rritjen e cilësisë së shërbimit, duke patur në konsideratë shpenzimin e fondeve me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet.

Në veprimtarinë tonë audituese jemi fokusuar dhe mbështetur në: Sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit nëse komponentet e tij janë në përputhje me aktet ligjore, aktet nënligjore dhe rregulloret në fuqi. Përputhshmëria ligjore e procedurave të prokurimeve; përputhshmëria ligjore lidhur me plotësimin e evidencave financiare; përputhshmëria ligjore e planifikimit dhe arkëtimit të të ardhurave nga aktiviteti kryesor; zbatimi i detyrave të lëna në auditimin e mëparshëm, etj. Për këtë jemi mbështetur në hartimit e pyetësorëve, të inspektimeve dhe duke kryer testime mbi transaksionet financiare, në kombinimin e intervistave, rishikimin e



KONTROLLI I LARTË I SHËTETIT RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR SHËNGJIN SHA

dokumenteve për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e veprimeve në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të veprimtarisë së subjektit të audituar.

e. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim.

Titullari përgjigjet për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike në mënyrë të ligjshme, me ekonomikitet, efektivitet dhe efikasitet, sigurimin, nëpërmjet akteve të brendshme administrative dhe të zbatimit të rregullave për kontrollin e brendshëm.

Përgjegjësitë e Nëpunësit Zbatues, i cili është edhe përgjegjës për sektorin e financës, përgjigjet përpara nëpunësit autorizues apo titullarit për: garantimin para miratimit të shkresave/urdhrave me karakter financiar, ligjshmërinë, rregullshmërinë dhe respektimin e parimeve të ekonomikitetit, efikasitetit dhe efektivitetit; dokumentimin e të gjitha transaksioneve financiare dhe të tjera dhe garantimin e gjurmës së auditimit për të gjitha proceset që ndodhin në njësi; pranimin ose jo të dokumentacionit, bazuar në kontrollet pas faktit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi; mbajtjen e sistemit të kontabilitetit, raportimi për vendimmarrjen, në funksion të realizimit të objektivave, kontabilizimin e plotë, të saktë dhe në kohë të të gjitha transaksioneve, si dhe përgatitjen e pasqyrave financiare të njësisë, në përputhje me rregullat e aktet ligjore në fuqi.

Përgjegjësitë e Menaxherve të tjerë Menaxherët e tjerë të strukturave të të gjitha niveleve të njësisë publike janë përgjegjës dhe raportojnë e i japin llogari eprorit sipas shkallës hierarkike, për: Mbikëqyrjen dhe menaxhimin efektiv të punonjësve të strukturës që drejtojnë dhe ruajtjen e nivelit të tyre profesional, zbatimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit degët që drejtojnë, etj.

f. Përgjegjësitë e audituesve

Garantimi i sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të shoqërisë me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi për përdorimin e duhur dhe eficient i burimeve financiare të saj, është objektiv më i rëndësishëm i auditimit.

Vlerësimi i riskut, me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm të shoqërisë dhe riskut të auditimit, për arritjen e nivelit të sigurisë së arsyeshme.

Përcaktimi i materialitetit të gjetjeve nga ana e audituesve, duke përfshirë edhe skepticizmin profesional të tyre.

Dokumentimi i rezultateve të auditimit i mbështetur në kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH- së. Nga audituesit u kërkua dhe u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesive dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

g. Kriteret e vlerësimit

Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar; Ligji Nr.9251 datë 08.07.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; i ndryshuar; Ligji nr. 154/2014 “Mbi Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

“Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar; Ligji nr. 10405, datë 24.03.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”; Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; Ligji nr. 7892, datë 21.12.1994 “Për sponsorizimet”, i ndryshuar; Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar; Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar; Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”; VKM nr. 642, datë 11.10.2005 “Për funksionimin e Këshillave Mbikëqyrës”, i ndryshuar; Udhëzimin nr. 318, datë 08.04.2009 i Ministrisë të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës në Shoqëritë Anonime Shtetërore”; Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”; V.K.M Nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteoze apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar me V.K.M Nr.735, datë 5.11.2014; Urdhërit të Përbashkët të Ministrisë të Financës dhe Ministrisë të Transportit dhe Infrastrukturës Nr.3069, datë 14.6.2016 “Për Përcaktimin e Tarifave të Shërbimeve në Portet Detare Vlorë, Sarandë dhe Shëngjin” (ndryshuar me urdhrin nr. 6132/1, datë 16.5.2017) etj. Manualet e Auditimit dhe Udhëzimet e KLSH.

h. Standardet e auditimit

- ISSAI 100 (Parimet themelore të auditimit të sektorit publik)
- ISSAI 4000 (Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë).
- SA 450 (Vlerësimi i anomalive dhe gabimeve gjatë auditimit).
- KLSH (Manuali i Përputhshmërisë).



III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

III.1 Informacion i përgjithshëm i veprimtarisë

Veprimtaria e shoqërisë është koordinimi i aktiviteteve tregtare brenda territorit të portit, ndërtimi, menaxhimi, ruajtja e objekteve të portit, ngarkim-shkarkimi dhe magazinim mallrash për llogari të subjekteve juridike private apo shtetërore.

Shoqëria brenda caqeve të parashikuara në legjislacionin në fuqi, kryen çdo operacion tregtar dhe financiar që lidhet drejtpëdrejt ose tërthorazi me objektin e saj.

Aktiviteti kryesor i shoqërisë është përpunimi i mallrave dhe mjeteve. Sipas raporteve të shoqërisë, përpunimi i mallrave dhe mjeteve është realizuar si më poshtë:

Për vitin 2017 në një volum prej 248 330 ton mallra, me vlerë prej 61,860 milion lekë ose 66.35% të të ardhurave gjithsej. Për vitin 2018 shoqëria ka realizuar një volum prej 200 826 ton mallra, me vlerë prej 56,310 milion lekë ose 57.56% të të ardhurave gjithsej. Për vitin 2019 shoqëria ka realizuar një volum prej 227 872 ton mallra, me vlerë prej 63,980 milion lekë ose 81% të të ardhurave gjithsej.

Nga auditimi i kryer për hartimin dhe realizimin e programit ekonomik konstatojmë se shoqëria paraqet një performancë ekonomike dhe financiare të paqëndrueshme dhe se nuk janë realizuar të ardhurat nga aktiviteti kryesor i saj.

III.2 Objekti, qëllimi dhe fushëveprimi i auditimit

Objektivi kryesor i auditimit është dhënia e opinionit bazuar në vlerësimin dhe evidentimin e shkeljeve të parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndoshë financiar si edhe shfrytëzimin me eficiencë, efektivitet dhe ekonomicitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike, ndërmarrjen e veprimeve korigjuese sipas rastit, rritjen e përgjegjshmërisë, llogaridhënies, rikuperimin e dëmeve të shkaktuara si dhe parandalimin e shkeljeve, me synim rritjen e vlerës së parasë publike në mbrojtje të interesave të taksapaguesve.

Auditimi i përputhshmërisë i ndërmarrë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ka për qëllim promovimin e qeverisjes së mirë në sektorin publik duke marrë parasysh rrezikun e mashtrimit në lidhje me përputhshmërinë (sipas ISSAI 400, p 18).

Qëllimi i auditimit është hartimi i Raportit të Auditimit mbi bazën e vlerësimit të gjetjeve për periudhën nga data 01.01.2017 deri më 31.12.2019, si dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e aktivitetit të shoqërisë, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me:

Zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm; zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e Këshillit Mbikëqyrës dhe Drejtorisë, si dhe bazueshmërinë ligjore të vendimeve të marra dhe realizimin e tyre; Auditim mbi hartimin, shqyrtimin dhe miratimin e planit të biznesit nga organet drejtuese, zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi; Auditim me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla; Organizimi dhe mbajtja e evidencës kontabile, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e pasqyrave financiare nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi e miratimi i tij në institucionet e prore. Analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj, ndaj buxhetit të shtetit. Zbatimi i ligjshmërisë në prokurimet për investime, për blerje mallrash e shërbimesh, si dhe zbatimi i kontratave; Mbi zbatimin e ligjshmërisë për



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit; Zbatimi i dispozitave ligjore për dhënien me qira të ambienteve dhe trojeve të depozitimit; Respektimi i dispozitave ligjore në lidhjen dhe zbatimin e kontratave me subjektet private që operojnë në port, si dhe zbatimi i tarifave përkatëse.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

1. Mbi realizimin e rekomandimeve nga auditimi i mëparshëm.

KLSH, në auditimin e mëparshëm ka rekomanduar masa për përmirësimin e situatës dhe nga shoqëria niveli i pranimit dhe zbatimit të tyre paraqitet si vijon:

Titulli i Gjetjes	Porti Detar Shëngjin SHA, nuk ka zbatuar dhe realizuar të gjitha rekomandimet e dhëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm.
Situata:	KLSH për përmirësimin e situatës ka rekomanduar: - 18 masa organizative, nga të cilat janë zbatuar 7 masa, 2 janë realizuar pjesërisht, 5 janë në proces realizimi dhe 4 prej tyre nuk janë zbatuar. - 13 masa për shpërblim dëmi, në shumën 10,689,582 lekë, nga të cilat 2 masa janë zbatuar në vlerën 134,160 lekë, 5 janë në proces në vlerën 5,671,446 lekë, 5 masa nuk janë pranuar në vlerën 4,151,556 lekë dhe 1 masë nuk është realizuar në vlerën 732,420 lekë. - 7 masa për shpenzime jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit, nga të cilat 3 janë zbatuar, 1 është zbatuar pjesërisht, 2 janë në proces realizimi dhe 1 masë nuk është zbatuar. - 9 masa disiplinore, nga të cilat janë zbatuar të gjitha.
Kriteri:	Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, neni 15, pika c.ku përcaktohet se: “Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas rastit, në fillim, përgjatë dhe/ose në përfundim të veprimtarisë, duhet: c) t’u rekomandojë drejtuesve të njërive të audituara apo organeve të kompetencës të ndërmarrin, në mënyrën dhe rrugët e përcaktuara nga ligji, masa strukturore dhe organizative, duke përfshirë edhe nisjen e procedurave disiplinore apo administrativ ,,.
Ndikimi:	Mos zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm ka ndikuar në mbarëvajtjen e aktivitetit ekonomiko-financiar.
Shkaku	Mos marrja në konsideratë e të gjitha rekomandimeve.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandimi:	-Strukturat drejtuese të Porti Detar Shëngjin SHA, të marrin masa për zbatimin dhe realizimin e plotë të rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme të KLSH-së, si edhe të ndiqen me prioritet në të gjitha shkallët e gjykimit ato të cilat janë në procese gjyqësore. (Më hollësisht trajtuar në Aneks 1,të këtij Raporti).



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

2. Mbi zbatimimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese (Këshilli/ Bordi Mbikëqyrës dhe Drejtoria), vendimet e marra dhe zbatimi i tyre.

Këshilli Mbikëqyrës për vitin 2017 ka zhvilluar 4 mbledhje dhe ka marrë 13 vendime, për vitin 2018, janë zhvilluar 5 mbledhje dhe janë marrë 10 vendime dhe për vitin 2019 janë zhvilluar 4 mbledhje dhe janë marrë 7 vendime.

Titulli i Gjetjes	Shpërblim i përfituar në mënyrë të padrejtë.
Situata:	Referuar pagesave të kryera dhe dokumentacionit shoqërues për shpërblimin/mbledhje të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës sipas përcaktimeve ligjore, u konstatua se 1 nga anëtarët e Këshillit ka munguar më shumë se në 3 mbledhje radhazi dhe ka përfituar padrejtësisht shpërblimin në vlerën 116,280 lekë. Më konkretisht zj. L. S. nuk ka qenë prezent në mbledhjet e datave 17.06.2019, 18.09.2019 dhe 02.12.2019 e megjithatë pagesa për zj. S. ka vazhduar normalisht.
Kriteri:	Statusi i shoqërisë nr. 7777/1 prot., datë 23.11.2011, neni 13 <i>“Skualifikimi dhe largimi i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës”</i> , pika 5. <i>“ka munguar për më shumë se gjashtë muaj radhazi pa lejen e anëtarëve të tjerë të Këshillit Mbikëqyrës në mbledhjet e këtij këshilli të mbajtura gjatë kësaj periudhe dhe Asambleja e Përgjithshme, me propozim të Këshillit Mbikëqyrës, vendos ta shkarkojë”</i> .
Ndikimi:	Pagesa të përfituara padrejtësisht për 6 muaj në shumën prej 116,280 lekë.
Shkaku	Mos paraqitja në mbledhje
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandimi:	Këshilli Mbikëqyrës t'i propozojë Asamblesë së Përgjithshme për shkarkimin e anëtares së tij zj. L. S. Nga Drejtoria e Portit Detar Shëngjin sha ti propozohet Këshillit Mbikëqyrës të ndiqen të gjithë procedurat administrative në të gjitha shkallët e gjyqimit për të kërkuar shpërblimin e dëmit ekonomik, në vlerën 116,280 lekë , të përfituar në mënyrë të padrejtë nga anëtarja e Këshillit Mbikëqyrës znj. L. S. <i>(Më hollësisht trajtuar në Aneks 2, të këtij Raporti)</i> .

3. Auditim mbi hartimin, shqyrtimin dhe miratimin e planit të biznesit nga organet drejtuese të Portit Detar, Këshilli Drejtues dhe Ministria Infrastrukturës dhe Energjisë.

Projekt programet ekonomiko-financiare për vitet 2017, 2018 dhe 2019 janë hartuar mbi bazën e realizimit të treguesve të vitit paraardhës dhe realizimit të pritshme të vitit aktual, për vitin pasardhës që programohet. Projekt programi i çdo viti është hartuar nga Drejtoria e shoqërisë dhe pasi është miratuar nga këshilli mbikëqyrës është paraqitur për mendim në MIE dhe



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

përfundimisht për miratim nga MFE, sipas procedurave dhe afateve të përcaktuara në Udhëzimin e METE nr. 394 datë 21.08.2014 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital tërësisht shtetëror” i ndryshuar me “Udhëzimin e METE nr. 15, datë 02.05.2018 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital tërësisht shtetëror”, si dhe në ligjin 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Titulli i Gjetjes	Mbi programin ekonomik.
Situata:	<p>Programi ekonomik i shoqërisë për periudhën objekt auditimi, nuk është hartuar saktë mbi baza reale referuar kapaciteteve për realizimin e treguesve ekonomik-financiarë, si edhe flet për punë të pamjaftueshme nga strukturat drejtuese të shoqërisë, kjo si rezultat i mos vënies në efektivitet të plotë të aseteve të shoqërisë.</p> <p>-Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të programit ekonomik financiar të shoqërisë dhe realizimin e objektivave për vitet 2017, 2018 dhe 2019 rezultoi se, realizimi i të ardhurave në 3 vite paraqitet me oshilacione negative: viti 2017- 70%, viti 2018- 80%, viti 2019 -68.5%, duke sjellë përkeqësim të situatës ekonomike dhe thellim të rezultatit ekonomik negativ në fund të vitit 2019 me humbje në shumën 105,210 mijë lekë.</p> <p>-Shoqëria për 3 vitet, nuk ka realizuar të ardhurat nga përpunimi i anijeve, i cili është aktiviteti kryesor i punës dhe krijimit të të ardhurave, kjo jo vetëm për shkak të rënies së aktivitetit në përpunimin e anijeve por edhe pasojë e keqmenaxhimit të burimeve të brendshme të shoqërisë, pasi procesi i ngarkim-shkarkimit është kryer me mjetet e operatorëve ekonomikë privat me zbritje të vlerës së tarifës me 56 % se tarifatat e miratuara për proceset e punës me mjetet e portit. Rritja e të ardhurave nga zëra “të tjerë” si tarifatat portuale, qiratë etj., jo vetëm që shfaq mangësitë e programimit, por në të njëjtën kohë shfaq prirjen për sigurimin e të ardhurave jashtë aktivitetit kryesor të shoqërisë, duke shkaktuar paqëndrueshmëri financiare afatgjatë.</p> <p>-Shoqëria Porti Detar Shëngjin, për 3 vitet objekt auditimi, konstatohet se nuk ka realizuar investimet e parashikuara, për vitet 2017 dhe 2019 janë parashikuar 2,570 milionë lekë investime, realizuar 0 lekë dhe për vitin 2018 janë parashikuar 1,183 milionë lekë, realizuar vetëm 9.6%. Realizimi i investimeve në këto nivele flet për një punë të dobët nga strukturat drejtuese si edhe nga Dega e investimeve, e cila përbëhet nga 6 punonjës, 1 shef sektori dhe 5 specialistë.</p> <p>-Në programimin e të ardhurave 2017, shoqëria ka parashikuar si volum pune ngarkim-shkarkimi prej 290,000 ton me një tarifë 502 lekë/toni, që do të sjellë të ardhura 145,500 mijë lekë, ose 52% e të ardhurave gjithsej, janë parashikuar të ardhura nga zënia e kalatës, aktiviteti trageti, të ardhura nga qiratë, etj.</p> <p>Parë në tërësi konstatohet se shoqëria rezulton me humbje për vitin 2017 në vlerë 39,889 mijë lekë, nga 1,3 milionë lekë, programuar me fitim, si pasojë e mosrealizimit të disa treguesve krahasuar me programin si:</p> <p>-Volumi i ngarkim shkarkimit në më pak të ardhura prej 14,179 mijë lekë.</p>



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

<p>-Mosrealizimi i të ardhurave nga zënia e kalatës prej 1,321 mijë lekë. -Përpunimi i trageteve prej 19,846 mijë lekë. -Qiradhënia prej 80,000 lekë. Realizimi i të ardhurave është në masën 70%, flet për një programim jo të saktë dhe mbi baza reale referuar kapaciteteve për realizimin e tyre si edhe punë e pamjaftueshme nga strukturat drejtuese të shoqërisë. -Në programimin e të ardhurave 2018, shoqëria ka parashikuar si volum pune ngarkim-shkarkimi prej 280,000 ton me një tarifë 363 lekë/toni, që do të sjellë të ardhura 101,640 mijë lekë, ose 65% e të ardhurave gjithsej, janë parashikuar të ardhura nga zënia e kalatës, aktivitet trageeti, të ardhura nga qiratë, etj. Parë në tërësi konstatohet se shoqëria rezulton me humbje për vitin 2018 në vlerë 32,671 mijë lekë, nga 3 milionë lekë, programuar me fitim, si pasojë e mosrealizimit të disa treguesve krahasuar me programin si: -Volumi i ngarkim shkarkimit në më pak të ardhura prej 30,130 mijë lekë, si pasojë e mosrealizimit të volumit të punës prej 79,179 ton. -Mosrealizimi i të ardhurave nga zënia e kalatës prej 1,030 mijë lekë. -Përpunimi i trageteve prej 19,846 mijë lekë. Realizimi i të ardhurave është në masën 80%, flet për një programim jo të saktë dhe mbi baza reale referuar kapaciteteve për realizimin e tyre dhe punë e pamjaftueshme nga strukturat drejtuese të shoqërisë. Referuar realizimit të volumit të punës për vitin 2017, ku realizimi i volumit të punës është 248,330 ton, nga strukturat drejtuese të portit programimi i volumit të punës prej 280,000 ton është parashikim euforik dhe i parealizueshëm në kushtet ku në vitin 2017, nuk janë realizuar investimet e parashikuara për përmirësimin e kushteve të punës në Port si edhe nuk janë paraqitur politika të studiuara marketingu për rritjen e volumit të punës, etj. -Në programimin e të ardhurave 2019, shoqëria ka parashikuar si volum pune ngarkim-shkarkimi prej 280,000 ton me një tarifë 363 lekë/toni, që do të sjellë të ardhura 99,250 mijë lekë, ose 55% e të ardhurave gjithsej, janë parashikuar të ardhura nga zënia e kalatës, aktivitet trageeti, të ardhura nga qiratë, etj. Parë në tërësi konstatohet se shoqëria rezulton me humbje në për vitin 2019 në vlerë 32,650 mijë lekë, nga 3 milionë lekë, programuar me fitim, si pasojë e mosrealizimit të disa treguesve krahasuar me programin si: -Volumi i ngarkim shkarkimit në më pak të ardhura prej 18,923 mijë lekë, si pasojë e mosrealizimit të volumit të punës prej 52,128 ton. -Mosrealizimi i të ardhurave nga zënia e kalatës prej 1,320 mijë lekë. -Përpunimi i trageteve prej 10,000 mijë lekë. Realizimi i të ardhurave është në masën 68.5 %, flet për një programim jo të saktë dhe mbi baza reale referuar kapaciteteve për realizimin e tyre dhe punë e pamjaftueshme nga strukturat drejtuese të shoqërisë. Referuar realizimit të volumit të punës për vitin 2018, ku realizimi i volumit të punës është 200,826 ton, nga strukturat drejtuese të portit programimi i volumit të punës prej 280,000 ton, është parashikim euforik dhe i parealizueshëm në</p>



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

	<p>kushtet ku në vitin 2018, nuk janë realizuar investimet e parashikuara për përmirësimin e kushteve të punës në Port, si edhe nuk janë paraqitur politika të studiuara marketingu për rritjen e volumit të punës, etj.</p> <p>Programimi i shpenzimeve 2017, është bazuar në nivelin e realizimit të vitit 2016, duke reflektuar rritje të nivelit të pagave në masën 10%. Shpenzimet janë realizuar në masën 98%.</p> <p>Investimet janë parashikuar të realizohen kryesisht me fondet e buxhetit të shtetit në shumën 1,358,754 mijë lekë, ku peshën kryesore e zë “Vazhdimi i ndërtimit të kalatës lindore”, po kështu është parashikuar financimi i punimeve për financimin e punimeve për “Thellimin e basenit të portit faza V”, pasi pa këtë financim Kalata e re e ndërtuar nga fondet e BE nuk mund të vihet në punë. Nga porti Detar Shëngjin nuk është realizuar asnjë nga investimet e parashikuara, realizimi i investimeve është 0 nga 19 investime të parashikuara.</p> <p>Programimi i shpenzimeve 2018, është bazuar në nivelin e realizimit të vitit 2017, Shpenzimet janë realizuar në masën 111 %, ose me tejkalim prej 11%, ku ka ndikuar tejkalimi i shpenzimeve në zërin “Amortizim”.</p> <p>Investimet janë parashikuar të realizohen kryesisht me fondet e buxhetit të shtetit në shumën 1,145,845 mijë lekë, ku peshën kryesore e zë “Vazhdimi i ndërtimit të kalatës lindore”, po kështu është parashikuar financimi i punimeve për “Thellimin e basenit të portit faza V”, pasi pa këtë financim Kalata e re e ndërtuar nga fondet e BE nuk mund të vihet në punë. Realizimi i investimeve është në nivelin 0.</p> <p>Programimi i shpenzimeve 2019, është bazuar në nivelin e realizimit të vitit 2018, Shpenzimet janë realizuar në masën 94 %,</p> <p>Investimet janë parashikuar të realizohen kryesisht me fondet e buxhetit të shtetit në shumën 1,145,845 mijë lekë, ku peshën kryesore e zë “Vazhdimi i ndërtimit të kalatës lindore”, po kështu është parashikuar financimi i punimeve për financimin e punimeve për “Thellimin e basenit të portit faza V”, pasi pa këtë financim Kalata e re e ndërtuar nga fondet e BE nuk mund të vihet në punë. Nga porti Detar Shëngjin nuk është realizuar asnjë nga investimet e parashikuara, realizimi i investimeve është 0.</p> <p>Si përfundim, konstatohet se programi ekonomik i shoqërisë për 3 vitet 2017, 2018 dhe 2019, nuk është hartuar saktë mbi baza reale referuar kapaciteteve për realizimin e treguesve ekonomiko-financiarë si edhe flet për punë të pamjaftueshme nga strukturat drejtuese të shoqërisë. Porti Detar Shëngjin nuk ka realizuar asnjë nga investimet e parashikuara, si edhe nuk janë bërë përpjekje me Ministrinë e linjës për çeljen e financimeve. (Më hollësisht trajtuar në Aneks 3, të këtij Raporti).</p>
Kriteri:	Udhëzimi i METE nr. 394 datë 21.08.2014 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital tërësisht shtetëror” i ndryshuar me “Udhëzimi i METE nr. 15, datë 02.05.2018 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital tërësisht shtetëror”, si dhe në ligjin



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

	9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.
Ndikimi:	Përkeqësim i situatës ekonomike dhe thellim të rezultatit ekonomik negativ me <i>humbje në fund të vitit 2019 në shumën 105,210 mijë lekë.</i>
Shkaku	Planifikimi i pa studiuar i programit ekonomik-financiar dhe mungesa e financimeve.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	<p>-Këshilli Mbikëqyrës dhe Strukturat drejtuese të Portit Detar Shëngjin të marrin në analizë ecurinë e zbatimit të programit ekonomik duke evidentuar përgjegjësitë për situatën e krijuar, marrjen e masave për vënien në efikasitet të aseteve të shoqërisë me qëllim arritjen e rezultatit ekonomik pozitiv, përmirësimin e treguesve ekonomik-financiar dhe arritjen e objektivave të zhvillimit të shoqërisë.</p> <p>-Strukturat drejtuese të Portit Detar Shëngjin, Dega e Investimeve, Dega e Financës dhe Dega e Përpunimit, të marrë masa për programimin e saktë dhe të argumentuar të nevojave për investime, uljen e numrit të punonjësve në degën e investimeve, forcimin e kapaciteteve profesionale në degën e investimeve, nëpërmjet bashkërendimit të punës së degëve e specialistëve duke njohur dhe vlerësuar kapacitetet me qëllim arritjen e objektivave të përcaktuara për zhvillimin e shoqërisë.</p>

4. Mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

-Struktura organizative e “Porti Detar Shëngjin” SHA është miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës Nr. 3, datë 11.01.2017 me një total prej 149 vetë dhe ka mbetur e pa ndryshuar deri 09.2.2018. Kjo strukturë është rritur në 157 veta në vitin 2018 me vendimin nr.1 datë 09.02.2018. Kjo strukturë përbëhet dhe organizohet nga Drejtori i Përgjithshëm dhe 3 nëndrejtorë. Degët kryesore janë Dega teknike dhe e Investimeve e përbërë nga 18 punonjës, Dega e financës e përbërë nga 5 punonjës, Ngarkim Shkarkimi e përbërë nga 62 punonjës, drejtorja e emergjencave civile 27 punonjës etj.

Titulli i Gjetjes	Ligjshmëria dhe pa rregullshmëria për përcaktimin e nivelit të pagave.
Situata:	<p>Niveli i pagave për vitin 2017 është i pa përcaktuar dhe është operuar sipas urdhërave të titullarit të shoqërisë. Në këtë mënyrë i lihet hapësirë e lirë titullarit për vendimmarrje në nivelin e pagave të punonjësve ku konstatohet se për pozicione të njejta ka nivele të ndryshme page duke treguar sjellje preferenciale ndaj punonjësve. Po kështu niveli i pagave për vitin 2017 nuk është miratuar në Këshillin Mbikëqyrës.</p> <p>-Për vitet 2018-2019 nivelet e pagave janë miratuar nga organet kolegjiale drejtuese të shoqërisë brenda kufirit minimal e maksimal të pagës së caktuar nga Këshilli i Ministrave, në varësi të mundësive financiare të shoqërisë, por nuk janë miratuar nga ministri përkatës.</p>



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

	-Për vitin 2018 është miratuar niveli i pagave për këtë shoqëri me vendimin nr. 3, datë, 09.02.2018, i aplikuar edhe për vitin 2019 me ndryshimet e miratuara në vendimin nr. 8 datë, 28.09.2018 duke përcaktuar klasat sipas kualifikimit dhe pozicioneve të punës.
Kriteri:	Ligji Nr. 10405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve” nenet 2 dhe 6. si mëposhtë: Neni 2, <i>Kompetencat per caktimin e pagës i cili citon Në Republikën e Shqipërisë kanë kompetencë për caktimin e pagës, sipas përkatësisë: ç) organet kolegjiale drejtuese të njëjësive të fondeve speciale, të ndërmarrjeve shtetërore, shoqërive aksionare dhe të institucioneve të tjera publike;</i> Neni 6 <i>Kompetencat e organeve kolegjiale 1. Organet kolegjiale drejtuese të njëjësive të fondeve speciale, të institucioneve publike, të ndërmarrjeve shtetërore dhe të shoqërive tregtare, me kapital mbi 50 për qind shtetëror, miratojnë: a) nivelet e pagave të punonjësve të tyre, brenda kufirit minimal e maksimal të caktuar nga Këshilli i Ministrave, në varësi të mundësive të tyre financiare dhe pas miratimit nga ministri përkatës; b) masën e shpërblimit të punës, por jo më shumë se një pagë mujore në vit, pas daljes së rezultatit financiar vjetor, si dhe pas miratimit nga ministri përkatës.</i>
Ndikimi:	Diskriminim në caktimin e nivelit të pagave.
Shkaku	Përcaktime të niveleve të pagave jashtë kompetencave ligjore.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandimi:	Përcaktimi i nivelit të pagave të kryhet sipas legjislacionit në fuqi nga Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë dhe në çdo kohë pozicione pune të ngjashme duhet të kenë pagë të njëjtë. Diferencimi mund të kryhet në performancën e secilit punonjës, në çdo rast e dokumentuar me rezultate konkrete në punë dhe jo vetëm me vendim të titullarit duke favorizuar/diskriminuar punonjësit.

Titulli i Gjetjes	Largime të pajustificuara nga puna
Situata:	Për periudhën 01.01.2017-31.12.2019, janë ndërprerë marrëdhëniet e punës për 23 punonjës të shoqërisë, 18 prej tyre larguar me dorëheqje. Largimet e punonjësve, si dhe mosndjekja e procedurave ligjore në ndërprerjen e marrëdhënieve të punës nga ish titullari Gj. T. si dhe nga Këshilli Mbikëqyrës për shkarkimin e ish titullarit Gj. T., deri më datë 31.12.2019, kjo shoqëri është palë (e paditur) në 3 çështje gjyqësore në lidhje me marrëdhëniet e punës. Deri më datë 31.12.2019, ka përfunduar gjykimi në të gjitha shkallët. Vlera e kërkuar dhe e likuiduar është 4,501,760 lekë, e cila përbën efekt financiar negativ për shoqërinë . Po të marrim parasysh që shoqëria ka në proces edhe një vendim me pretendimin e 16 pagave ose 1,085,760 lekë, efekti negativ do jetë edhe më i lartë për shoqërinë.
Kriteri:	Ligji nr. 7961, datë 12.7.1995 “ <i>Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë</i> ” pika 3, neni 155 Zgjidhja e menjëhershme e pajustificuar e kontratës së punës nga punëdhënësi, neni 27, ku përcaktohet se: <i>Në rastet e zgjidhjes së menjëhershme,</i>



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

	<p>të pajustificuar, të kontratës së punës nga punëdhënësi, gjykata, me kërkesë të punëmarrësit dhe duke vlerësuar të gjitha rrethanat, vendos dëmshpërblimin, deri në një vit pagë, që i shtohet pagës që ai duhet të marrë gjatë afatit të njoftimit. Për punëmarrësit në administratën publike, kur ka një vendim të formës së prerë për kthimin në vendin e mëparshëm të punës, punëdhënësi është i detyruar të zbatojë këtë vendim.</p> <p>Neni 27 - Përgjegjësia e punëmarrësit</p> <ol style="list-style-type: none">1. Punëmarrësi përgjigjet ndaj punëdhënësit për dëmin që i shkakton kur shkel detyrimet kontraktuale me dashje ose nga pakujdesia.2. Shkalla e kujdesit, që duhet të tregojë punëmarrësi në punë, varet nga njohuritë teknike, të nevojshme për të kryer punën e caktuar, duke pasur parasysh aftësitë dhe cilësitë e punëmarrësit, që punëdhënësi i njihë ose duhet t'i kishte njohur. Dëmi, që lidhet në mënyrë të qenësishme me kryerjen e punës, përballohet nga punëdhënësi.3. Dëmi përfshin dëmin real dhe fitimin e munguar.4. Gjykata mund të shkarkojë plotësisht ose pjesërisht punëmarrësin nga detyrimi për shpërblimin e dëmit kur:<ul style="list-style-type: none">-punëmarrësi ka vepruar me pakujdesi të lehtë;-punëdhënësi, në organizimin dhe kontrollin e punës, bën të njëjtin gabim që lidhet me shkaktimin e dëmit;-detyrimi për të zhdëmtuar plotësisht dëmin s'është i përballueshëm duke pasur parasysh burimet e të ardhurave të punëmarrësit.
Ndikimi:	Largimet e pajustificuara nga puna ndikojnë në rritjen e kostove operative të shoqërisë.
Shkaku	Largime nga puna duke shkelur klauzolat e Kodit të Punës dhe kontratave individuale.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	<p>-Shoqëria duhet të marrë masa për shqyrtimin e <i>efektit financiar negativ</i> në vlerën totale 4,501,626 lekë, me probabilitet për tu rritur edhe me 1,085,760 lekë, për çështjet të cilat janë ende në gjykim, ardhur si pasojë e mos-ndjekjes së procedurave ligjore në largimin e punonjësve nga puna, për evidentimin e përgjegjësive.</p> <p>-Sektori Juridik të marrë masa për ndjekjen e të gjitha çështjeve gjyqësore në të gjitha shkallët e gjykimit për shmangien e kostove shtesë nga proceset gjyqësore të cilat mbartin risk të lartë për këtë shoqëri. Shoqëria duhet të marrë masa të analizojë në mënyrë të detajuar rastet e largimit nga puna, si dhe krijimin e detyrimeve të shtuara përmbartimore, duke evidentuar përgjegjësitë individuale, humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme.</p>
Titulli i Gjetjes	Mbi keq organizimin e mbajtjes së dosjeve të personelit dhe emërimet me risk



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

Situata:	<p>Shoqëria, sipas strukturës së miratuar është i organizuar me 150 punonjës. Nga auditimi me zgjedhje i 15 dosjeve të punonjësve të marrë rishtas në punë për periudhën objekt auditimi, rezulton se dokumentacioni në dosjet e personelit ka mangësi. Në tre raste emërimet në punë janë vetëm me dëftesë shkolle të mesme, ndërkohë që emërimi është kryer në pozicionin e specialistit të prokurimit, një sektor me shumë risk për shoqërinë, të cilin ish drejtori Ermal Pacaj ia beson këtë detyrë punonjësve të pakualifikuar, duke riskuar edhe proceset e tenderimit. Raste që mund të përmenden janë marrja në dorëzim e “Uniformave për punonjësit” apo edhe ajo e “Riparimit të Tarracës” ku në komisionin e marrjes në dorëzim është caktuar një punonjës i cili emërimin e ka marrë më 03.09.2019 në pozicionin e punonjësit të zyrës së investimve dhe më 26.09.2018 caktohet nga ish drejtori në grupin e marrjes në dorëzim. E njëjta situatë është edhe në procedura të tjera duke vendosur punonjës të paspecializuar dhe jo të profilit. Dosjet janë me mangësi në dokumentacion si: karta e identitetit, certifikatë familjare, dëftesa/diploma e studimeve të kryera (fotokopje të noterizuara) dokumente shtesë për grada e tituj shkencorë, për kurset e trajnimit, gjuhët e huaja, dëshmi penaliteti, etj.</p> <p>-Për vitin 2017, nga ish drejtori i përgjithshëm Gj. T. me urdhërin nr. 70 prot. datë 04.05.2017 është emëruar në detyrë z.D. M. me pagë 66,560 lekë në pozicionin e “Sinjalizuesit dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve”. Emërimi në detyrë i një punonjësi, në kundërshtim me VKM nr. 816 datë 16.11.2016 “Për strukturën, kriteret e përzgjedhjes dhe marrëdhëniet e punës së punonjësve të njësisë përgjegjëse në autoritetete publike” ka rritur shpenzimet me 9 paga x 65,560 lekë/pagë = 590,040 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për shoqërinë Porti Detar Shëngjin.</p>
Kriteri:	<p>Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 Kodi i Punës ku, <i>Spektori i Personelit dhe Burimeve Njerëzore, mban dosjet e personelit dhe të dhënat e të gjithë të punësuarve në Shoqëri. Spektori i Burimeve Njerëzore duhet të zhvillojë mundësitë për trajnim, për të siguruar programe të vazhdueshme, të përshtatshme për të kënaqur nevojat e gjithsecilit për sa i përket planifikimit të karrierës.</i></p> <p>Vendimi Nr. 117, datë 05.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrimit qendror të personelit” kreu I.</p> <p>-Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 816, datë 16.11.2016 “Për strukturën, kriteret e përzgjedhjes dhe marrëdhëniet e punës së punonjësve të njësisë përgjegjëse në autoritetete publike”, në zbatim të ligjit nr. 60/2016 “Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve” , emërimi i D. M. apo ndonjë individ tjetër është në kundërshtim me VKM nr. 816 datë 16.11.2016 “Për strukturën, kriteret e përzgjedhjes dhe marrëdhëniet e punës së punonjësve të njësisë përgjegjëse në autoritetete publike”, VKM e marrë në referencë për punësimin e këtij punonjësi pasi në pikën 3 shprehet fare qartë se kush është struktura përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve. ku citohet: <i>Në ato raste kur autoriteti publik nuk ka në strukturën e tij strukturë auditimi të</i></p>



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

	<i>brendshëm, njësia përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve është drejtuesi i strukturës së burimeve njerëzore dhe një nëpunës/punonjës i saj. Në mungesë të tyre, kjo njësi përbëhet nga dy nëpunës/punonjës të strukturës së burimeve njerëzore.</i>
Ndikimi:	Mungesa e dokumentacionit në dosje, emërimet jo në përputhje me pozicionin real ose emërimet në mospërputhje me aftësitë reale lënë hapësirë për abuzime në pozicione pune për të cilën punëmarrësit nuk janë të arsimuar ose të profesionalizuar.
Shkaku	Dosjet e pasakta të punonjësve, emërimet me risk
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	-Të plotësohen të gjitha dosjet e punonjësve dhe sidomos kontrata e punës ku të specifikohet qartë pozicioni i punës në përputhje me nivelin arsimor dhe profesional të çdo punonjësi si dhe paga bruto për periudhën e punësimit. Në çdo kohë, në dosjen e punonjësit duhet të figurojnë kopje të të gjithë urdhrave të transferimit në pozicione pune të tjera brenda shoqërisë për të rritur transparencën në afrimin e pozicioneve të punës me formimin përkatës. Nga Drejtoria e financës dhe administratori të shqyrtohet dëmi ekonomik në vlerën 590,040 lekë dhe të merren të gjitha masat për arkëtimin e vlerës.

Titulli i Gjetjes	Mbi parregullsitë në hartimin e listëpagesave dhe emërimeve në punë
Situata:	<p>-Për vitin 2017, u konstatuan pasaktësi në pozicione pune të cilat nuk janë në strukturën e miratuar të sektorit/degës, por janë në listëprezencë, listëpagesë dhe në sistemin tatimor, mospërputhje midis emërimit të pozicionit të punës të shënuar në kontratën e punës dhe atij të shënuar në listëprezencë, listëpagesë dhe në sistemin tatimor dhe dublim të pozicioneve të punës. Për të njëjtin departament gjatë vitit 2018 figurojnë 2 persona të siguruar si shef zyre me ndryshime të vogla në emërtime në sistemin tatimor ku paga aplikohet në nivel përgjegjësi; pozicione pune të cilat nuk paguhen sipas nivelit referues të pagave të miratuara nga Këshilli Mbikqyrës. Kjo ka krijuar diferenca ku disa persona paguhen për pozicione pune të ndryshme nga kontrata punës ose të ndryshme nga pozicioni i punës i miratuar.</p> <p>Diferencat e pagave sipas strukturës ekzistuese dhe emërimeve të drejtorit, për vitin 2017 janë 1,723,929 lekë. Për muajin janar 2018 i cili ka si referencë nivelin e pagave të vitit 2017 të Këshillit Mbikqyrës është krijuar një efekt negativ në shumën 150,184 lekë.</p> <p>Diferencat për vitin 2018 janë 210,453 lekë dhe për vitin 2019 janë 346,143 lekë. Në total diferencat e konstatuara në nivelin e pagave janë 2,430,709 lekë, vlerë e cila përbën efekt negativ financiar.</p> <p>-Nuk ka unifikim të emërtimeve në sistemin tatimor për pozicione pune të ngjashme dhe ka diferenca në caktimin e pagave për të njëjtat pozicione pune duke nxitur diskriminimin në punë.</p> <p>-Gjithashtu administratori për disa punonjës ka nxjerr urdhëra me një nivel</p>



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

	page të përcaktuar në kundërshtim me pagat e miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës dhe për disa të tjerë nxjerr urdhër ku niveli i pagës të vendoset sipas strukturës së miratuar nga Këshilli.
Kriteri:	Kodin e Punës, Neni 115, “Barazia në shpërblim” (Ndryshuar me Ligjin nr. 136/2015, datë 5.12.2015) -Penalitetet në sistemin tatimor llogariten sipas Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Sanksionet, Neni 114 -Kontratat individuale të punës -Struktura e vitit 2017 miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 03 datë 11.01.2017 ndërsa niveli pagave për vitin 2017 është vendimi i KM nr. 09 datë 01.07.2011 -Struktura e vitit 2018 miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 03 datë 09.02.2018
Ndikimi:	Diskriminim i punonjësve dhe rritja e kostove operative
Shkaku	Përcaktime preferenciale të pozicioneve të punës, strukturës ose nivelit referues të pagave, përcaktime të niveleve të pagave sipas vendimmarrjes së titullarit.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	-Këshilli Mbikëqyrës dhe Titullari i Portit Detar Shëngjin, të marrin masa për përcaktimin e nivelit të pagave sipas pozicionit dhe vendit të punës, pozicione pune të ngjashme duhet të kenë pagë të njëjtë. -Shoqëria të marrë masa për uljen e numrit të punonjësve, të rekrutojë punonjës të kualifikuar dhe të menaxhojë me efektivitet procedurat operationale të përditshme për rritjen e rentabilitetit të shoqërisë. -Këshilli Mbikëqyrës dhe Strukturat drejtuese të shoqërisë të marrin në shqyrtim dhe analizojnë <i>efektin negativ financiar shkaktuar në shumën 2,573,749 lekë</i> , duke ristrukturuar nivelin e pagave dhe pozicioneve të punës në përputhje me vendimet e miratuara.

Titulli i Gjetjes	Mbi procedurat e pasakta të rekrutimit të punonjësve ose sipas kriterëve të pa përcaktuara
Situata:	Shoqëria nuk ka rregullore të miratuar, ku të përcaktohen procedurat që ndiqen për mënyrën e rekrutimit të stafit. Për periudhën objekt auditimi, mungon transparenca për shpalljen e vendeve vakante dhe intervistimin ose testimin e kandidatëve deri në përzgjedhjen e tyre. Në vitin 2017 nga ish titullari Ermal Pacaj është bërë prokurim me vlerë të vogël për njoftim në mediat lokale me vlerë 85,833 lekë (Spot televiziv për 1 muaj) nga 05.12.2017-04.01.2018 ndërkohë që gjatë kësaj periudhe titullari ka kryer lëvizje të punonjësve, ku rekrutimet në punë kanë qenë vetëm me një urdhër të ish titullarit, pra përzgjedhjen e kandidatëve është kryer në mënyrë subjektive, pa marrë në konsideratë nivelin arsimor dhe eksperiencën e tyre, duke e ekspozuar drejt një risku akoma më të madh këtë shoqëri.
Kriteri:	Ligji nr. 9901, datë 14.4.2008 Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare, i ndryshuar, Neni 167 Përbërja, të drejtat e detyrimet e këshillit mbikëqyrës dhe



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

	<p>administratorët</p> <p>1. Këshilli mbikëqyrës është përgjegjës për të gjitha funksionet e përcaktuara në pikat 1, dhe 2 të nenit 154 të këtij ligji.</p> <p>Neni 154</p> <p>Të drejtat dhe detyrimet</p> <p>1. Këshilli Mbikqyrës ka këto të drejta dhe përgjegjësi:</p> <p>a) të japë direktiva për administratorët për zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë;</p> <p>b) të kontrollojë e të mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë nga administratorët;</p> <p>i) të kryejë veprimet e tjera, të përcaktuara në ligj dhe në statut.</p> <p>Anëtarët e këshillit mbikëqyrës përgjigjen për dëmet e shkaktuara nga shkelja e detyrave të tyre dhe standardit të kujdesit, të përcaktuara në pikat 1, 2 e 3 të nenit 163 të këtij ligji.</p> <p>Neni 163 dh) lejojnë që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të ishte parashikuar se shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese, për të shlyer detyrimet;</p> <p>-Kontrata kolektive e punës datë 18.05.2016</p>
Ndikimi:	Mungesa e Rregullores krijon konfuzion dhe le shteg për abuzim në përzgjedhjen e punonjësve të rinj.
Shkaku	Rekrutimi i punonjësve pa kritere të mirëpërcaktuara ose me procedurë të paqartë.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	-Drejtori i shoqërisë dhe Dega e Burimeve Njerëzore, të hartojnë rregulla dhe procedura specifike ku të specifikohen qartë kriteret e punësimit për çdo pozicion pune lidhur me nivelin arsimor, përvojën në punë, formimin bazë apo trajnimet profesionale të nevojshme për përmbushjen efikase të detyrave për çdo pozicion pune, duke rritur transparencën e mënyrës së punësimit dhe rekrutimit në bazë të meritokracisë.

Titulli i Gjetjes	Mos respektim i vendimeve të marra për shoqërinë.
Situata:	Administratori i shoqërisë nuk informon organet drejtuese, në këtë rast Këshillin Mbikqyrës, për rritjen e kostove operative për punësimet pa kriter, për marrjen në punë të punonjësve të pa specializuar ose të pa profesionalizuar, për emërimet pa kriter, për procedurat e pasakta të prokurimit, për moszbatim të vendimeve të asamblesë së aksionarëve, etj. Për efekt zinxhir, mos marrja e asnjë mase nga organet drejtuese, Drejtori i Përgjithshëm, Këshilli Mbikëqyrës dhe mos zbatimi i vendimit të Asamblesë së Aksionarëve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 69 datë 15.08.2019 ku shprehet se kërkohet urgjentisht reduktimi i shpenzimeve ndër to dhe personelit, është në kundërshtim me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

	- Për 4 mujorin e fundit të vitit 2019, për këtë situatë ngarkohet me përgjegjësi edhe drejtori në detyrë z. Gjergj Prendi pasi edhe pse ka një vendim të asamblesë së përgjithshme nr. 69, datë 15.08.2019 ku është vendosur dhe i kërkohet urgjentisht reduktimi i shpezimeve ndër to edhe ato të personelit, nga ana e titullarit nuk është marrë asnjë masë, për më tepër mundësia ka qenë e madhe, nisur nga dorëheqjet e shumta që i janë paraqitur titullarit në këtë periudhë, sërisht ky i fundit ka bërë zëvendësim stafi. Administratori nuk respekton gjendjen e vështirësisë financiare të shoqërisë si edhe vendimin e asamblesë së përgjithshme duke e thelluar rezultatin negativ.
Kriteri:	Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, Nenet 15 dhe 154.
Ndikimi:	Rritje e kostove operacionale të shoqërisë dhe moskryerje e detyrave dhe përgjegjësive të strukturave drejtuese.
Shkaku	Mos pasqyrim i informacionit real financiar-ligjor
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	-Administratori dhe Këshilli Mbikqyrës të analizojnë situatën e krijuar dhe të nxjerrin përgjegjësitë gjithsecili për lënien dhe përkeqësimin e situatës me veprimet dhe mos veprimet e tyre si dhe në mos zbatimin e urdhërave. <i>(Më hollësisht trajtuar në Aneks 4, të këtij Raporti).</i>

5. Auditim me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit, sponsorizime, etj).

Për veprimet e kryera nëpërmjet bankës u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Regjistri i parashikimit dhe realizimit të blerjeve me vlera të vogla.
- Procedurat e ndjekura për realizimin e blerjeve (nga hartimi nevojave, urdhër prokurime, ngritja e komisioneve - marrja në dorëzim)
- Dokumentacioni shoqërues i likuidimeve të kryera.
- Ditarët e bankës, dokumentacioni mbi mbajtjen e shpenzimeve për karburant, dieta, etj.

Titulli i Gjetjes	Veprimet e kryera nëpërmjet bankës dhe blerjet me vlera të vogla
Situata:	Nga Porti Detar, nuk janë zbatuar plotësisht përcaktimet ligjore të bëra në: -VKM nr.914, datë 19.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. -Udhëzimin e Ministrisë Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. -Udhëzimin nr.3, datë 27.01.2015 “Për blerjet me vlera të vogla”, ndryshuar me udhëzimin nr.2, datë 24.04.2017. Për çdo veprim të kryer nëpërmjet bankës, është bashkëlidhur dokumentacioni justifikues, ato janë pasqyruar kronologjikisht, për regjistrimin e veprimeve mbahen ditarët përkatës, por pa u evidentuar në programet e informatizuara të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

financës. Veprimet janë kryesisht për shpenzimet e kryera për paga, sig. shoqërore, energji elektrike, ujë dhe shpenzime për blerje me vlera të vogla.

-Nëpërmjet bankës për vitet 2017-2018, është likuiduar shuma prej **80,000 lekë**, për gjoba të vendosura nga Dega e tatimeve, për vonesa në deklarim tatim fitimi, sigurime shoqërore, etj.

-Arkëtimi i detyrimeve nga subjektet të cilat kanë kontrata të nënshkruara me Portin Detar Shëngjin, është kryer 1-6 vjet me vonesë, pra faturat dhe situacionet e hartuara nga Porti Detar për punën e kryer ndaj tyre datojnë prej vitit 2014 e në vazhdim, ndërsa pagesat e detyrimeve vazhdojnë ende, duke sjellë vështirësi financiare për aktivitetin e Portit.

Megjithëse janë dërguar disa shkresa për njoftim për pagesën e detyrimeve, si edhe përcaktimi në shkresën nr.159, datë 04.07.2019 se: detyrimet monetare përbëjnë titull ekzekutiv dhe vihen në ekzekutim të detyrueshëm, përsëri **nga strukturat drejtuese nuk është vepruar**. Detyrimi nga kompanitë e kontraktuara për ushtrimin e aktivitetit në Port kryesisht “Rafaelo 2002”, është **10,839 mijë lekë dhe 37,746 Euro, krijuar prej vitit 2014**.

Në procedurat e kryera për blerjet me vlera të vogla konstatohet se:

- AK, në 4 raste ka kryer blerje me vlera të vogla në formë shkresore duke shmangur procedurat on line dhe copëzuar fondin,
- Titullari i Autoritetit Kontraktor ka ngritur komisionet për blerjet me vlera të vogla në 6 mujorin e fundit të vitit
- Autoriteti Kontraktor ka përdorur procedurën e blerjeve me vlera të vogla edhe në rastet kur kryerja e blerjes dhe shërbimeve nuk janë në kushtet e emergjencës, pa u respektuar përcaktimet sipas Udhëzimit nr.3, datë 27.01.2015, i ndryshuar me udhëzimin nr.2, datë 24.04.2017.
- Në procedurat e zhvilluara për blerjet me vlera të vogla nuk janë përcaktuar specifikime teknike për mallrat/punët apo shërbimet,

Për vitin 2017 janë parashikuar dhe audituar blerje me vlera të vogla në shumën 3,200 mijë lekë dhe janë realizuar 1,614 mijë lekë.

Konstatohet se AK ka kryer blerje me vlera të vogla në formë shkresore duke shmangur procedurat on line dhe copëzuar fondin, në kundërshtim me VKM nr.914, datë 19.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 40, pika 6, Udhëzimin nr.3, datë 27.01.2015 “Për blerjet me vlera të vogla”, pikat 7 dhe 8, ndryshuar me udhëzimin nr.2, datë 24.04.2017, si për: “Riparim motori zjarrfikëse” në shumën 100 mijë lekë dhe “Riparim mjeti lefterak” në shumën 85 mijë lekë, të cilat janë fituar nga e njëjta kompani “S.”, “Riparim tarace zyrat e administratës” në shumën 100 mijë lekë dhe “Riparim zyra e drejtorit” në shumën 100 mijë lekë, të cilat janë fituar nga e njëjta kompani “D.”.

Për vitin 2018 janë parashikuar dhe audituar blerje me vlera të vogla në shumën 2,599 mijë lekë dhe janë realizuar 3,100 mijë lekë.

Konstatohet se AK ka kryer blerje me vlera të vogla në formë shkresore duke shmangur procedurat on line dhe copëzuar fondin si për: “Riparim kompjutera”



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

në shumën 100 mijë lekë dhe “Riparim kondicioneri” në shumën 100 mijë lekë, të cilat janë fituar nga e njëjta kompani “M.”, “Riparim dyer e dritare” në shumën 100 mijë lekë dhe “Riparim dyer tualeti” në shumën 100 mijë lekë, të cilat janë fituar nga e njëjta kompani “D.”.

Po kështu, për procedurat e ndjekura për blerjet me vlera të vogla, konstatohen mangësi në lidhje me hartimin e specifikimeve teknike, marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, kërkesat nga degët, etj.

Për blerjet me vlera të vogla kryetari i AK, ka nxjerrë urdhërat përkatëse “Për krijimin e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël” për vitin 2017, Urdhri nr.51/1, datë 27.11.2017, Për vitin 2018, Urdhri nr.72, datë 02.07.2018, ky urdhër ka ndryshuar me urdhri nr. 2, datë 24.10.2018.

Ngritja e komisioneve për blerjet me vlera të vogla në 6 mujorin e fundit të vitit, është në kundërshtim me VKM nr.914, datë 19.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 40, pika 2.

Autoriteti Kontraktor ka përdorur procedurën e blerjeve me vlera të vogla edhe në rastet kur kryerja e blerjes dhe shërbimeve nuk janë në kushtet e emergjencës, pa u respektuar përcaktimet sipas Udhëzimit nr.3, datë 27.01.2015, i ndryshuar me udhëzimin nr.2, datë 24.04.2017.

Për vitin 2019 janë parashikuar dhe audituar blerje me vlera të vogla në shumën 4,661 mijë lekë dhe janë realizuar 3,129 mijë lekë.

Konstatohet se AK ka kryer blerje me vlera të vogla në formë shkresore duke shmangur procedurat on line dhe copëzuar fondin si për:

-“Shërbime mirëmbajtje dhe riparime” në shumën 100 mijë lekë dhe “Shërbime mirëmbajtje të ndryshme” në shumën 80 mijë lekë, të cilat janë fituar nga e njëjta kompani “S. D.”.

-Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël rezultoi se, në procedurën e prokurimit “*Blerje pajisje elektronike, kompjutera, printere dhe bateri(UPS)*” me fond limit 794,834 lekë, furnizimi i kryer nga operatori ekonomik është bërë duke mos respektuar specifikimet teknike për pajisjet Desktop dhe UPS. Furnizimi me mallra prej **553,000 lekë** në kundërshtim me specifikimet teknike konsiderohet dëm ekonomik deri në zëvendësimin e tyre, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20/11/2006 “*Për prokurimin publik*”, të ndryshuar si dhe VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar neni 64.

-Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël rezultoi që, në procedurën e prokurimit “*Blerje mobilje zyre*” me fond limit 794,834 lekë, furnizimi i kryer nga operatori ekonomik është bërë duke mos respektuar specifikimet teknike për llojin e materialit të përdorur nga MDF në Melamin një product il ngjashëm nga ana vizuale por jo në cilësi dhe në vlerë, produkti i cili ka një vlerë rreth 40% më të ulët krahasuar në librin dogonar të referencave. Furnizimi me mallra në vlerën prej **260,120 lekë** në kundërshtim me specifikimet teknike konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet kthehet nga përfituesi. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20/11/2006 “*Për*



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

	<i>prokurimin publik</i> ”, të ndryshuar si dhe VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar nenin 64.
Kriteri:	VKM nr.914, datë 19.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Udhëzimi i Ministrisë Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.Udhëzimin nr.3, datë 27.01.2015 “Për blerjet me vlera të vogla”, ndryshuar me udhëzimin nr.2, datë 24.04.2017.
Ndikimi:	Mosarritje e prokurimeve me efektivitet dhe sipas objektivave të kërkuara. Thellimi i detyrimeve ndaj Portit nga kompanitë të cilat kryejnë aktivitetet në Port prej 10,839 mijë lekë dhe 37,746 Euro, krijuar prej vitit 2014 duke vështirësuar ecurinë e shoqërisë.
Shkaku	Mosnjohje dhe moszbatim i procedurave të VKM nr. 914, datë 19.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Udhëzimit nr.3, datë 27.01.2015 “Për blerjet me vlera të vogla”, ndryshuar me udhëzimin nr.2, datë 24.04.2017.
Rëndësia:	I mesëm
Rekomandimi:	<p>-Nëpunësi autorizues, Drejtori i shoqërisë, të hartojnë dhe miratojnë rregullat për gjurmët e auditimit, për procedurat standarde të shpenzimeve; AK të marrë masa që të mos kryhet asnjë blerje apo shërbim me procedurë të vogël, pa u kaluar nëpërmjet platformës elektronike, në respektim të legjislacionit të prokurimit publik në fuqi, me qëllim arritjen e objektivave të kërkuar.</p> <p>-Strukturat drejtuese të Portit Detar Shëngjin, Dega e Financës dhe Dega e Përpunimit, të marrin masa për kryerjen në afat të arkëtimit dhe detyrimeve të prapambetura nga subjektet private të cilat kryejnë aktivitetet në Port sipas kontratave të nënshkruara, duke ndjekur procedurat ligjore me qëllim eliminimin e vonesave të pajustificuara, rritjen e të ardhurave të shoqërisë duke ndikuar në përmirësimin e treguesve ekonomik-financiarë.</p> <p>-Drejtori i Portit Detar Shëngjin SHA në të ardhmen në çdo grup pune të vendosë specialist të fushës për shmangien e këtyre situatave. Komisioni për marrjen në dorëzim të marrë masa për zbatimin e kriterëve të miratuar e pranuar në kërkesa për mallra punë apo shërbime, për menjanimin e furnizimeve në kundërshtim me specifikimet teknike të kërkuara si dhe arkëtimi i vlerës prej 553,000 lekë nga operatori ekonomik A. sh.p.k.</p> <p>Drejtori i Portit Detar Shëngjin SHA në të ardhmen në çdo grup pune të vendosë specialist të fushës për shmangien e këtyre situatave. Komisioni për marrjen në dorëzim të marrin masa për të zbatimin e kriterëve të miratuar e pranuar në kërkesa për mallra punë apo shërbime, për menjanimin e furnizimeve në kundërshtim me specifikimet e kërkuara si dhe kërkimi i vlerës prej 260,120 lekë nga operatori ekonomik “O. &C.”.</p> <p><i>(Më hollësisht trajtuar në Aneks 5, të këtij Raporti).</i></p>



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

6. Organizimi dhe mbajtja e evidencës kontabël, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e pasqyrave financiare. Analiza e debitorëve dhe kreditorëve, detyrimet fiskale, sigurimet shoqërore etj. Inventarizimi fizik i pasurisë, zbatimi i afateve , cilësia e tyre, si edhe mbyllja dhe sistemimi i rezultateve në pasqyrat financiare vjetore.

Titulli i Gjetjes	Paraqitje e pasaktë e informacionit financiar
Situata:	<p>Në pasqyrat financiare të vitit 2017 dhe 2018 vlera e truallit nga rivlerësimi paraqitet në kontabilitet me vlerë 650,950,000 lekë dhe në regjistrin e asetëve me një sipërfaqe prej 26,038 m². Nuk paraqitet në kontabilitet vlera analitike e tokës dhe ndërtesës sa janë specifikisht por vlera e tyre jepet e bashkuar, duke u amortizuar të dyja me normën e amortizimit prej 3%. Gjithashtu zërat e impianteve dhe makinerive dhe instalimeve e pajisjeve duhet të jenë analitike në mënyrë që të jepet informacion sa më transparent mbi mënyrën e amortizimit të tyre.</p> <p>-Nga auditimi i deklarimeve dhe të dhënave në sistemin tatimor rezultoi se në deklaratat e tatim fitimit për vitin fiskal 2017-2018 në sistemin tatimor nuk janë deklaruar shpenzimet e pazbritshme të ndara nga shpenzimet e përgjithshme sipas pasqyrave financiare dhe sipas shpjegimeve në lidhje me këto shpenzime. Shpenzimet e pazbritshme përfshihen në shpenzimet e përgjithshme duke ndikuar në këtë mënyrë në një rezultat të ndryshëm financiar.</p> <p>-Nuk reflektohen vendimet e aksionarit në lidhje me zvogëlimin e kapitalit për humbjen e vitit 2017 e cila paraqitet 21,122,417 lekë sipas shkresës nr 6135/1 prot., datë 25.05.2017 të MZHETTS.</p> <p>-Me vendimin nr. 12522/1 prot., Nr. 69 datë 15.08.2019 është marrë vendimi i asamblesë së përgjithshme të aksionarit mbi destinimin e humbjes për vitin 2018. Vendimi është marrë me vonesë dhe duhej depozituar brenda datës 31.07.2019, duke e ngarkuar shoqërinë me 10,000 lekë gjobë në sistemin tatimor. Ky vendim përcakton që humbja e ushtrimit të mbartet në bilancin kontabël. Nuk është bërë përcaktimi i saktë se ku do të mbartet realisht humbja, në humbje të akumuluar, në ulje të rezervave nga rivlerësimi etj</p> <p>-Në këtë shoqëri është përfituar një grant qeveritar me vlerë 649,774,625 lekë për të cilën edhe pse u kërkua dokumentacioni i plotë, nuk u gjend në shoqëri. Mungesa e dokumentacionit krijon paqartësi për përqindjen e njohjes së grantit në kontabilitet. Gjithashtu në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare nuk jepet informacion në lidhje me grantin dhe mënyrën e njohjes së tij nga viti në vit.</p> <p>-Nuk janë marrë masa për arkëtimin e detyrimit nga kompania D. “E” dhe ndaj personave të cilët kanë detyrime të cilat aktualisht kanë kaluar periudhën një vit dhe nuk janë shlyer as duke u mbajtur nga pagat dhe as duke i dërguar ndonjë shkresë në lidhje me këtë detyrim. Nuk është bërë provizioni i këtij detyrimi i cili ka kaluar periudhën një vjeçare dhe mund të mos jetë i arkëtueshëm.</p>
Kriteri:	Udhëzimi nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, Pikat 3.6 “Shpenzimet e panjohura” dhe 3.7 “Amortizimi”



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

	<p>Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, Kreu XIV Sanksionet, Neni 113 “Mosdeklarimi në afat”si dhe ligji nr. 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, Standartet Kombëtare të Kontabilitetit, SKK 05 Aktivët Afatgjatë Materiale dhe Aktivët Afatgjatë Jomateriale - i përmirësuar, SKK 10 Grantet dhe forma të tjera të Ndhmës - i përmirësuar, SKK nr. 6 Provizionet, detyrimet dhe aktivet e kushtëzuara.</p> <p>SKK nr. 1 Kuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, Vlerësimi i mëpasshëm Pika 61. Një njësi ekonomike mat aktivet dhe detyrimet financiare, me kosto të amortizuar minus ndonjë zhvlerësim të mundshëm, SKK nr. 02 Paraqitja e pasqyrave financiare. Paraqitja e vërtetë dhe e drejtë pika 8. Një paraqitje e vërtetë dhe e drejtë kërkon një regjistrim të besueshëm të efekteve të transaksioneve, ngjarjeve dhe kushteve të tjera në përputhje me përkufizimet dhe kriteret e njohjes së aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve të përcaktuara në SKK 1 – Kuadri i Përgjithshëm për Përgatitjen e Pasqyrave Financiare, si dhe pika 9. Pajtueshmëria me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.</p>
Ndikimi:	Dhënia e informacionit financiar jo real ose mospërputhje e informacionit real me atë kontabël.
Shkaku	Regjistrim i pasaktë i informacionit financiar
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	-Këshilli Mbikqyrës të analizojë me përgjegjësi letrat e menaxhimit lëshuar nga ekspertët kontabël dhe të marrë masa për të përmirësuar situatën duke synuar cilësi në pasqyrat financiare.

Titulli i Gjetjes	Pasaktësi dhe devijime në llogaritjen e amortizimit.
Situata:	<p>Në pasqyrat financiare të vitit 2017, nuk paraqitet e ndarë analitikisht vlera e tokës dhe ndërtesës, të cilat amortizohen bashkë me normën 5%. Vetëm ndërtesa amortizohet me ligj në normën 5% të vlerës së mbetur kurse Toka nuk amortizohet. Vlera e rivlerësuar e mbetur e Tokës në 31.12.2017 është 650,950,000 lekë, ndërsa vlera e rivlerësuar e ndërtesës është 926,171,973 lekë. Maksimumi ligjor me të cilën amortizohet ndërtesa është 5% e vlerës së mbetur dmth $5\% \times 926,171,973 \text{ lekë} = 46,308,598.65 \text{ lekë}$, duke krijuar një devijim në raportimin e pasqyrave financiare në shumën 2,669,209.³⁵ lekë nga amortizimi i llogaritur në 31.12.2017 48,977,808 lekë.</p> <p>-Shoqëria llogarit amortizimin për mjetet Vinç dhe Gjenerator ndërkohë që janë nxjerrë 2 urdhëra të ish titullarit E. P. për magazinimin e tyre, këto mjete nuk përdoren, nuk janë funksionale e për rrjedhojë vlera e tyre nuk duhet të amortizohet. (Më hollësisht trajtuar në Aneks 6, të këtij Raporti).</p>
Kriteri:	Udhëzimi nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, Pika 3.7 Amortizimi pika 3.7.1 Aktive të tilla si: toka, trualli, veprat e artit, sendet antike, bizhuteritë, metalet dhe gurët e çmuar, nuk amortizohen.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

	3.7.2 d. Llogaritja e amortizimit ndërpritet për të gjitha llojet e aktiveve afatgjata që nuk marrin pjesë në veprimtarinë ekonomike të tatimpaguesit, përfshirë mospërdorimin e tyre apo daljen jashtë veprimtarisë.
Ndikimi:	Rritja e shpenzimeve të shoqërisë, paraqitje jo reale e situatës financiare të shoqërisë të cilat do ta ndryshonin dukshëm rezultatin financiar vjetor.
Shkaku	Amortizim i aseteve të cilat nuk përdoren
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	-Drejtoria e Financës dhe Titullari të saktësojnë devijimet në llogaritjen e amortizimit, të saktësojnë vlerën reale të mbetur dhe të paraqesë në mënyrë korrekte shpenzimin e amortizimit të aseteve të shoqërisë sipas normave ligjore duke marrë parasysh jetëgjatësinë e çdo asemi.

7. “Zbatimi i ligjshmërisë në prokurimet për investime, për blerje mallrash e shërbimesh, si dhe zbatimi i kontratave”.

Për zbatimin e ligjshmërisë në procedurat e prokurimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Regjistri i parashikimit dhe realizimit të prokurimeve.
- Dokumentacioni mbi kryerjen e prokurimeve.
- Dokumentacioni shoqërues i likujdimeve të kryera.
- Kontratat e nënshkruara dhe zbatimi i tyre.

Titulli Gjetjes	Mbi Prokurimet
Situata:	<p><i>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se:</i></p> <p>Nga Porti Detar, nuk janë zbatuar plotësisht përcaktimet ligjore të bëra në: -Ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar. -VKM nr.914, datë 19.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. -Udhëzimin e Ministrisë Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.</p> <p>Auditimi është kryer bazuar në ligjin nr.9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 19.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Dokumentet Standarde të Tenderit (DST) si edhe në udhëzimet dhe manualët e APP-së.</p> <p>Për vitin 2017, nga Autoriteti Kontraktor janë programuar 19 procedura prokurimi me vlerë 1,400 mijë lekë, nga të cilat nuk është realizuar asnjë procedurë prokurimi.</p> <p>Për vitin 2018, janë programuar 4 procedura prokurimi me vlerë 5,300 mijë lekë, nga të cilat është realizuar dhe audituar 1(një) procedurë prokurimi me objekt “Blerje uniforma për sektorin e sigurisë” me fond limit 1,250 mijë lekë. Është nënshkruar 1 kontratë me vlerë 1,249,920 lekë.</p> <p>Për vitin 2019, janë programuar 2 procedura prokurimi me vlerë 2,300 mijë lekë, nga të cilat është realizuar dhe audituar 1(një) procedurë prokurimi me</p>



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

objekt “Blerje karburant” me fond limit 1,300 mijë lekë. Është nënshkruar 1 kontratë me vlerë 1,300 mijë lekë.

Auditimi është fokusuar në drejtim të:

- Parashikimi i fondit limit për çdo objekt të prokuruar, bazuar në çmimet e publikuara, përvojën e mëparshme ose testimin e tregut.
- Argumentimi ligjor i procedurave të prokurimit që ka zgjedhur enti prokurues. Realizimi i parimeve të prokurimit publik, si transparenca, nxitja e konkurrencës, barazia e kandidatëve dhe përdorimi ekonomik dhe efektiv i fondeve publike.
- Zbatimi i procedurave të prokurimit, nga nxjerrja e urdhrat të prokurimit deri në shpalljen e fituesit.
- Lidhja dhe zbatimi i kontratave, kontrolli fizik për marrjen në dorëzim të mallrave.
- Kërkesat nga degët dhe programimi i nevojave për punë, mallra dhe shërbime.
- Regjistrat e parashikimit dhe realizimit të prokurimeve të hartuara nga Autoriteti Kontraktor.
- Arsyet e mosrealizimit të tenderave dhe a mund të ketë ndodhur që Autoriteti Kontraktor ka shmangur procedurat e tenderimit duke kryer procedura blerje me vlera të vogla.
- Respektimi i afateve nga paraqitja e regjistrat deri në marrjen në dorëzim të mallrave.
- Komisionet e marrjes në dorëzim të mallrave/shërbimeve.

Në tenderat e zhvilluar në hartimin e dokumenteve të tenderit nga njësi e prokurimit, konstatohet se nuk janë argumentuar kriteret e vendosura, veprim në kundërshtim me nenin 61/2 “Dokumentet e tenderit” .

- Njësi e prokurimit nuk ka marrë pjesë në asnjë trajnim në fushën e prokurimeve,
- Llogaritja e fondit limit në tenderin me objekt “Blerje uniforma pune për punonjësit e sigurisë” është kryer formalisht, vetëm për 9 nga 14 artikujt e kërkuar, studimi i vlerës së kontratës nuk është plotësisht i saktë, pasi në përcaktimin e fondit limit nuk janë harmonizuar metodat e vendosura në aktet ligjore e nënligjore të prokurimeve, si çmimet e botuara nga INSTAT-i, çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse. Në përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, është mbështetur në studimin e tregut dhe sigurimin e ofertave për të njohur nivelin aktual të tregut, por nuk është dokumentuar nëse nga Autoriteti Kontraktor janë kryer analizat e kostos së mallrave që do të prokurohen, duke krahasuar elementet e mësipërm me specifikimet teknike, dhe komisioni ka llogaritur fondin limit apriori.
- Grupi i punës i ngritur për hartimin e specifikimeve teknike, në tenderin me objekt “Blerje uniforma pune për punonjësit e sigurisë” ka hartuar specifikimet teknike, në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 23 “Specifikimet teknike” komisioni kërkon bluza pambuku me material 50% leshi dhe 50% akriliku, si edhe ka kërkuar në



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

	<p>specifikime teknike që Uniformat të jenë të reja</p> <p>-Nuk janë paraqitur kërkesat nga AK për numrat e kostumeve, këmishëve, këpucëve, etj, veprime në kundërshtim me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit ku kërkohet që numrat dhe masat do të përcaktohen me nënshkrimin e kontratës, pra as kontrata nuk ka aneks ku të jenë përcaktuar këto specifikime.</p> <p>-Referuar kontratës së furnizimit me karburant datë 11.03.2019, rezulton se është llogaritur edhe taksa e markimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të naftës, e cila bie në kundërshtim me VKM nr. 498, datë 30.5.2013 “Për përcaktimin e procedurave të shënjimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të naftës”, pikat 4.1 dhe 4.2.</p> <p>Pra, për sasinë vjetore të furnizuar nga operatori ekonomik “K.” prej 9694 litra, referuar taksës së markimit të karburantit në grafikun e likujdimit të karburantit për gjithë furnizimin e kryer, është përcaktuar 0,614 lekë/litër + 20% = 0,737 lekë x 9694 litra = 7,114 lekë, e cila është përfituar më tepër nga kontraktori.</p> <p>-Dosjet e tenderave nuk janë inventarizuar dhe arkivuar, Njësia e Prokurimit në përfundim të çdo procedure prokurimi dhe për çdo dosje nuk ka kryer inventarizimin e brendshëm të saj, në përputhje me nenin 30, Modeli nr. 8 “Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë”, miratuar nga DP e Arkivave, në zbatim të neneve 3 e 29 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”. <i>(Më hollësisht trajtuar në Aneks 7, të këtij Raporti).</i></p>
Kriteri:	<p>Ligji nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar.</p> <p>-VKM nr. 914, datë 19.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.</p> <p>-Udhëzimi i Ministrisë Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.</p> <p>VKM nr. 498, datë 30.5.2013 “Për përcaktimin e procedurave të shënjimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të naftës”.</p>
Ndikimi:	Mosarritje e prokurimeve me efektivitet dhe sipas specifikimeve të kërkuara
Shkaku	Mosnjohje dhe moszbatim i procedurave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 19.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.
Rëndësia:	I mesëm
Rekomandimi:	-Njësia e Prokurimit, për të ardhmen, të marrë të gjitha masat për eliminimin e praktikave problematike të konstatuara në lidhje me kërkesat e veçanta kualifikuese, ato të hartohen në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit, të përcaktohen kriteret kualifikimi të sakta dhe të kuptueshme, pa lënë shteg për interpretime si dhe të detajohen sipas rregullave të prokurimit publik. Gjithashtu kërkesat kualifikuese të veçanta të hartuara e miratuara nga autoriteti kontraktor duhet të jenë detyrimisht të argumentuara.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

	<p>-Autoriteti kontraktor, të marrë masa për të përmirësuar përbërjen e Njesisë së Prokurimit, duke bërë të mundur trajnimin e vazhdueshëm të anëtarëve të Njesisë së Prokurimit, nëpërmjet trajnimeve në Agjencinë e Prokurimit Publik, për çështjet e prokurimit publik, në përmbushje të kërkesës së VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.</p> <p>-Autoriteti Kontraktor, të hartojë kërkesa të veçanta për kualifikim, specifikime teknike dhe të kryej llogaritje të sakta të vlerës së kontratës që të sigurojë konkurrencën e nevojshme, si një nga parimet bazë të prokurimit në blerjen e mallrave, shërbimeve dhe punëve, me qëllim arritjen e rezultateve të dëshirueshme në efektivitetin e përdorimit të fondeve publike.</p> <p>-Autoriteti Kontraktor dhe Njësia e Prokurimit në çdo rast të shmang kostot shtesë në procedurat e prokurimit si edhe të kombinoje anëtarët e njesisë së prokurimit sipas profileve të punës për menaxhuar me efikasitet dhe efikasitetë buxhetin e saj, me qëllim arritjen e rezultateve të dëshirueshme në efektivitetin e përdorimit të fondeve publike.</p>
--	---

8. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit.

Për zbatimin e ligjshmërisë dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit, grupi i auditimit u fokusua në:

- Praktikat dhe dokumentacionin e sektorëve në zbatim të Rregullores së Brendshme Sh.A “Porti Detar “ Shëngjin, e miratuar me Vendimin Nr.02, datë 09.02.2018 të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë.
- Intervista dhe pyetësor me sektorët e finances, shërbimeve, marketingut, ngarkim – shkarkimit.
- Përgjigje e pyetësorit mbi implementimin e MFK.
- Urdhëra, vendime, relacione, raporte të sektorëve, etj
- Raporte dhe programe të shoqërisë; rezultoi se:

Titulli i Gjetjes	Shkallë e ulët aplikimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.
Situata:	<p>Gjendja faktike e komponentëve përbërës të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none">-Në rregulloren e brendshme të shoqërisë proceset kryesore të përfshira janë kryesisht sipas linjave funksionale të përgjegjësisë, por nuk përshkruajnë me detaje procedurat dhe proceset për aktivitetet kryesore. Mungojnë procedurat e inspektimit, formatet e akteve të miratuara, procedurat e raportimit dhe kompetencat e inspektorëve, dhe për pasojë raportet periodike të inspektimeve. Nuk rezultoi të ketë urdhër për të përfshirë procedura dhe formate të përmisuara dhe të miratuara për proceset kryesore të veprimtarisë së shoqërisë.-Nuk janë hartuar dhe arkivuar gjurmët e auditimit dhe listat e proceseve kryesore.-Nuk rezultoi informimi i proceseve kryesore, përfshirë dokumentacionin përkatës të miratuar, procedurat e raportimit, etj.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

	<p>-Mungon regjistri i riskut. Grupi i Menaxhimit Strategjik nuk është krijuar dhe për pasojë nuk funksionon.</p> <p>-Veprimtaritë e kontrollit nuk janë të mjaftueshme. Mungesa e përdorimit për kohë të gjatë e pajisjeve si mjete transporti, vinça etj. apo mosfunksionimi i tyre, tregojnë se rikuperimi i proceseve apo sistemeve është i ngadaltë. Kjo do të thotë se ndikimi i riskut operacional është i lartë. Nga auditimi rezultoi që menaxhmi jo vetëm nuk identifikon riskun përkatës, por edhe nuk e regjistron atë në regjistrin e riskut me qëllim ndjekjen dhe monitorimin si edhe marrjen e masave për reduktimin e tij.</p> <p>-Mungon mbështetja e proceseve nëpërmjet sistemeve të IT (teknologjisë dhe informacionit).</p> <p>(Më hollësisht trajtuar në Aneks 8, të këtij Raporti).</p>
Kriteri:	<p>Ligji nr.10296, datë 08.07.2011, i ndryshuar, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” pikat 2,3,4,5 neni 11, neni 1, pika 3, neni12. ku përcaktohet: <i>Menaxherët e tjerë të strukturave të të gjitha niveleve të njësisë publike janë përgjegjës dhe raportojnë dhe i japin llogari eprorit, sipas shkallës hierarkike, për:</i></p> <p>2.<i>Identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejojnë. 3.Garantimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit në strukturat që ata drejojnë, bazuar në rregullat e vendosura nga titullari i njësisë publike, si dhe i raportojnë nëpunësit autorizues përkatës për çdo dobësi të sistemit që duhet trajtuar.</i></p> <p>4.<i>Ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit të njësisë kundrejt humbjeve, vjedhjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të paautorizuar.</i></p> <p>5.<i>Informacionin në kohë dhe në formën e kërkuar për rezultatet e arritura gjatë përmbushjes së përgjegjësisë të tyre, për risqet dhe defektet serioze në veprimtarinë e strukturave që drejojnë, si dhe për masat e marra e të zbatuara për riparimin e këtyre defekteve.</i></p> <p><i>Çështjet, që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, duhet të diskutohen gjatë takimeve periodike ndërmjet menaxherëve të niveleve të ndryshme në njësinë publike. Çështjet kryesore dhe mangësitë serioze që dalin brenda njësisë i parashtrihen grupit për menaxhimin strategjik, me qëllim diskutimin e mëtejshëm dhe marrjen e masave.</i></p> <p><i>Nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve të njësisë publike përgjigjen përpara nëpunësit autorizues përkatës për:</i></p> <p><i>dh)dokumentimin e të gjitha transaksioneve financiare dhe të tjera dhe garantimin e gjurmës së auditimit për të gjitha proceset që ndodhin në njësi;</i></p> <p><i>e)pranimin ose jo të dokumentacionit, bazuar në kontrollet pas faktit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;</i></p> <p>-Urdhëri i Ministrisë së Financave Nr.16, datë 20.07.2016, pika 2.3, “Për</p>



KONTROLI I LARTË I SHETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

	<p>përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”.</p> <p><i>Nëpunësi Autorizues duhet të sigurojë që do të ndiqet qasja e përgjithshme e rekomanduar për ngritjen, vlerëimin dhe përmisimin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, duke përfshirë hapat kryesore të vlerësuara të rëndësishme për një sistem të shëndoshë, si më poshtë:</i></p> <p><i>-Hartimi i listës dhe manualeve të proceseve të punës;</i></p> <p><i>-Përgatitja e gjurmës së auditimit për proceset kryesore të punës.</i></p>
Ndikimi:	Nuk realizohen objektivat e shoqërisë.
Shkaku	Nuk njihen dhe zbatohen kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator, që rregullojnë menaxhimin financiar dhe kontrollin.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	-Drejtori i shoqërisë të marrë masa për të implementuar një sistem eficient të menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke përfshirë të gjithë komponentët e tij. Shoqëria të hartojë regjistrin e rriskut, listën e proceseve kryesore dhe gjurmët e auditimit, me qëllim arritjen e mjaftueshme të aktiviteteve të kontrollit për identifikimin, kontrollin dhe reduktimin e risqeve që kërcënojnë shoqërinë. Gjithashtu, të krijohet Grupi për Menaxhimin Strategjik, me qëllim verifikimin për të identifikuar dhe menaxhuar risqet brenda njësisë publike.

9. Mbi respektimi i dispozitave ligjore në lidhjen dhe zbatimin e kontratave me subjektet private që operojnë në port, si dhe zbatimi i tarifave përkatëse.

Për zbatimin e dispozitave ligjore në nënshkrimin e kontratave me subjektet private që operojnë në Port, grupi i auditimit u fokusua në:

- Intervista dhe pyetësorë me sektorët e financës, shërbimeve, marketingut, ngarkim - shkarkimit,
- praktikat e përpunimit të anijeve;
- tarifat portuale;
- praktikat e lidhjes dhe zbatimit të kontratave;
- librat e shitjeve për vitet 2017,2018,2019;
- kartelat e klientëve etj.

Titulli i Gjetjes	Kontratat e qirasë nuk miratohen në Këshillin Mbikëqyrës.
Situata:	<p>Për periudhën objekt auditimi, Porti Detar Shëngjin SH A. ka lidhur kontratë qiraje me 8 subjekte private me afat 1/vjeçar, për objekte dhe truall deri në 200m², si edhe me çmime nga vlera dysHEME 100 lekë/m² deri 200 lekë/m²/muaj. Konform paragrafit 5, shkronja (a), kapitulli I^{rë} të V.K.M nr.54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", për kushtet e mësipërme këto subjekte ishin të përjashtuara nga procedurat e konkurimit. Gjatë zbatimit të procedurave të auditimit rezultoi që në të gjitha praktikat e lidhjes së kontratave të qirave, në dokumentacionin e tyre nuk rezultonte të</p>



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

	ishte marrë miratimi i Këshillit Mbikëqyrës. Në kundërshtim me paragrafin 1, shkronja (b), kapitulli II në V.K.M nr.54, datë 05.02.2014, "Për përcaktimin e kritereve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", kontratat e qirasë nuk janë miratuar më parë në Këshillin Mbikëqyrës. <i>(Më hollësisht trajtuar në Aneks 9, të këtij Raporti).</i>
Kriteri:	V.K.M nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore" paragrafin 1, shkronja (b), kapitulli II ^{të} . <i>1. Institucioni shtetëror, ndërmarrja apo shoqëria shtetërore, që ka në administrim objektin që do të jepet me qira ose enfiteozë, për të gjitha rastet, përgatit dokumentacionin si më poshtë vijon:</i> <i>b) vendimin e organit drejtues të institucionit shtetëror, ndërmarrjes apo shoqërisë shtetërore (Këshilli Mbikëqyrës, Këshilli Drejtues, Bordi Drejtues etj).</i>
Ndikimi:	Krijon subjektivitet dhe mungesë dhënie llogarie.
Shkaku	Nuk zbatohen dispozitat ligjore përkatëse.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Strukturat drejtuese të menaxhimit përpara nënshkrimit të kontratave për dhënien me qira të pasurive të portit të marrin miratimin e tyre në Këshillin Mbikëqyrës. Porti Detar Shëngjin SH. A të rrisë performancën në drejtim të përdorimit ekonomik, efikas, dhe efektiv të burimeve të veta.

Titulli i Gjetjes	Kontratat e qirasë nr.111/7 prot. datë 01.09.2017, nr.294/3 datë 17.09.2018 dhe nr.267 prot. date 01.11.2019 me subjektin "V. I. P." SH.A. nuk janë monitoruar gjatë rinovimit të tyre. Objekti i këtyre kontratave rezultoi jo i plotë.
Situata:	Subjekti "V. I. P." SH A, ka rinovuar kontratat e qirasë nr.111/7, datë 01.09.2017 dhe nr.294/3, datë 17.09.2018 për objektin "magazinë prej 50 m ² ", me një vlerë prej 10 000 lekë/ muaj. Gjatë auditimit rezultoi se subjekti me kontratën nr.267, datë 01.11.2019 ka rinovuar kushtet e kontratës për objektin magazinë nga 50 m ² në 200 m ² . Gjatë zbatimit të procedurave të auditimit rezultoi se në të gjitha praktikat mungonte proces-verbali për marrjen dhe dorëzim të objektit apo ndryshimin e kushteve të kontratës. Për këtë arsye më datën 14.02.2020, në prani të përfaqësuesit të subjektit qiramarrës zj. B. H. si edhe të përfaqësuesit të portit z. L. Gj. u verifikua se Qiramarrësi, ka të depozituar në pjesën Veri-Perëndimore të magazinës Nr.4, me sipërfaqe 419 m ² , 12.45 m x 33.65 m, një shesh depozitimi me përmasa 20 m x 10 m dhe sipërfaqe 200 m ² me pjesë ndërrimi për mjete lundruese brenda kushteve të kontratës Nr.267, datë 01.11.2019, por pa u shoqëruar me proces-verbal të ndryshimit të kushteve. Kontratat e qirasë nr.111/7 prot, datë 01.09.2017, nr.294/3 prot. datë 17.09.2018, dhe nr.267 prot. date 01.11.2019, në objektin e tyre nuk japin informacion të plotë dhe të saktë mbi objektin e dhënë me qira. Ato e



KONTROLI I LARTË I SHITETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

	përshkruanin objektin e qirasë si magazinë me 50 m ² dhe 200 m ² . Në fakt është shesh magazinimi prej 50 m ² dhe 200 m ² të dhënë me qira brenda objektit Magazina Nr.4 me sipërfaqe 419 m ² , 12.45 m x 33.65m.
Kriteri:	V.K.M nr. 54, datë 05.02.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore" pikat 1 dhe 2 shkronjat (a), (b), (c), kapitulli VI Monitorimi i Kontratave.
Ndikimi:	Krijon parregulsi gjatë zbatimit të kontratave të qirave.
Shkaku	Nuk respektohen kërkesat ligjore në momentin e lidhjes së kontratës dhe gjatë zbatimit të saj.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandimi:	Strukturat drejtuese të Portit Detar Shëngjin SHA, të analizojnë zbatimin kushteve të kontratës nr.267 prot, datë 01.11.2019 me subjektin privat "V. I. P." SH.A,

Titulli i Gjetjes	Të ardhura të munguara nga përfitimi i vend-akostimit të anijeve të peshkimit.
Situata:	<p>Me kontratën Nr.172 Prot. datë 31.07.2019 ishte dhënë me qira subjektit "R." SH.P.K, sipërfaqe e lirë truall prej 200 m² dhe çmim 200 lekë/m², në kalatën e re, në funksion të aktivitetit të peshkimit.</p> <p>Nga auditimi, sipas informacioneve të raportimeve ditore të sigurisë së portit, datë 01.08.2019, 21.08.2019, 13.09.2019, rezultoi se "R." SH.P.K ankoronte 6 anije peshkimi në këtë pjesë të kalatës së re dhe se ky shërbim rezultonte i papaguar, duke përfituar nga shfrytëzimi i kalatës për ankorim, jashtë kontratës të sipërpërmendur.</p> <p>"R." SH.P.K përfiton pa të drejtë shërbimin e ankorimit.</p> <p>Për periudhën nga 01.08.2019 deri më 31.12. 2019 shuma që i detyrohet portit rezulton 720 € (6 anije x 40€/muaj x 3 muaj = 720€, meqenëse 2 muaj janë lundrim i detyruar ndërkombëtar). Për pjesën tjetër të vitit 01.01.2019-31.07.2019, mbi bazën edhe të raportimeve ditore të sigurisë së portit datë 01.01.2019, 05.02.2019, 29.03.2019, 22.04.2019, 28.05.2019 dhe 07.06.2019 shuma që i detyrohet portit rezulton 1200 € (6 anije x 40€/muaj x 5 muaj)</p> <p>Sa sipër, shuma 1920€ (1200 €+720 €) përbën dëm në formën e të ardhurave të munguara për portin Detar Shëngjin.</p>
Kriteri:	<p>Urdhëri i Përbashkët Nr.3069, datë 14.06.2016, i ndryshuar geramat (b) dhe (c) pika 3 e pikes 1.2.1 , kapitulli I Tarifat e portit dhe kanalit, ku përcaktohet se:</p> <p><i>b)Tarifat e kalatës të përcaktuara nga këto tarifa janë të pagueshme menjëherë nga pronari ose agjenti i anijes, në përputhje me termat dhe kushtet e pagesës, dhe mblidhen nga Porti ose përfaqësuesi i tij.</i></p> <p><i>c)Detyrimet që lindin nga aplikimi e tarifës së kalatës janë të pavarura nga detyrimet që lindin nga aplikimi i tarifave të tjera portuale.</i></p>



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

Ndikimi:	Të ardhura të munguara.
Shkaku	Përfitim nga shfrytëzimi i pasurisë jashtë kontraktor
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Strukturat drejtuese të Portit Shëngjin SHA të ndjekin të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës prej 1920€ nga subjekti “R.” SH.P.K. për detyrimin e tarifës së ankorimit, ndaj Portit në shfrytëzimin e kalatës.

Titulli i Gjetjes	Të ardhura të ulta nga aktiviteti i përpunimit të mallrave si rezultat i ndryshimit të tarifave të pëdorura
Situata:	<p>Aktiviteti kryesor i shoqërisë rezulton ngarkim-shkarkimi i mallrave, i cili përbënte mesatarisht 61% të të ardhurave ose 60,716,000 lekë/vit, vlera këto të llogaritura sipas realizimit të volumeve të punës. Të ardhurat për këtë aktivitet kanë pësuar rënie jo vetëm për shkak të rënies së volumit të punës, por edhe nga mos operimi në përpunimin e anijeve me mjetet e veta të Portit.</p> <p>Për realizimin e volumeve të punës është hartuar dhe miratuar në Këshillin Mbikëqyrës libri i Tarifave Portuale, ku janë të përcaktuara edhe tarifat për përpunimin e mallrave për të cilën në çdo llojë malli kemi dy tarifa të miratuara:</p> <ul style="list-style-type: none">- përpunimi i mallrave me mjetet e portit, dhe-përpunimi i mallrave me mjetet e operatorëve privatë e cila është dukshëm më e ulët. <p>Në këtë shoqëri për këtë proces punë në vitin 2016, është shpenzuar një vlerë prej 30,316,800 lekë, me objekt “blerje vinçi”, mjet i cili nuk e kryen plotësisht funksionin për të cilin është prokuruar dhe ky proces punë kryhet me mjetet e operatorëve ekonomik privat.</p> <p>Në parashikimin e projekt-programit për vitin 2018 dhe vitet 2019 -2020, nr.182 prot., datë 25.11.2017, është parashikuar volumi i ngarkim-shkarkimit me një tarifë mesatare 363 lekë/ton. Në këtë mënyrë, shoqëria parashikon se aktiviteti i ngarkim-shkarkimit mund të kryhej kryesisht me mjetet e vetë operatorëve, dhe për këtë arsye kemi edhe aplikimin e tarifave shumë më të ulta, por të parashikuara në librin e tarifave. Menaxhmenti i lartë nuk kishte një raport të plotë për Këshillin Mbikëqyrës ku të shpjegonte arsyet e mospërdorimit në shumë raste të mjeteve të veta të portit. Gjatë auditimit rezultoi se aktiviteti kryesor i përpunimit të mallrave kryesisht realizohej me mjetet e veta nga firmat që operonin me portin.</p> <p>Nga auditimi i të ardhurave nëpërmjet librit të shitjes dhe likuidimeve të bankës u konstatua se: për vitin 2017 kemi një realizim të ardhurash prej 61,855,105 lekë me një ulje të tarifës së përpunimit mesatarisht me 43.3% kjo si rezultat i përpunimit të mallrave me mjetet e operatorëve ekonomik privat. Rënie e të ardhurave rezultoi 48,963,913 lekë (61,855,105 x 43.3%/54.7%). Për vitet 2018 dhe 2019 zbritja në vlerë e tarifës rezulton mesatarisht 32.5 % si rezultat i ndryshimeve të miratuara në librin tarifor, realizimi i të ardhurave paraqitet në</p>



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

	56,309,917 lekë për vitin 2018 dhe 63,152,527 lekë për vitin 2019 dhe renia e të ardhurave rezultoi përkatësisht 27,112,182 lekë dhe 30,806,619 lekë. Nga mos kryerja e procesit të ngarkim shkarkimit me mjetet e Portit dhe tarifimi me çmime më të ulta për periudhën objekt auditimit shoqëria ka pësuar një rënie të të ardhurave në rreth 106,882,714 lekë. <i>(Më hollësisht trajtuar në Aneks 9, të këtij Raporti).</i>
Kriteri:	Vendimi Nr. 4, datë 29.07.2016 nga Këshilli Mbikëqyrës neni 8, i ndryshuar, Rregullore e Brendshme e Portit Detar Shëngjin, miratuar Vendimin Nr.02, datë 09.02.2018
Ndikimi:	Objektivat e shoqërisë të porealizuara.
Shkaku	Mos përdorimi me efikasitet i aseteve të shoqërisë
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Këshilli Mbikëqyrës dhe Strukturat drejtuese të Portit Detar Shëngjin SHA të analizojnë situatën e krijuar gjatë aktivitetit të përpunimit të mallrave dhe të nxjerrin përgjegjësitë për krijimin e kësaj situatë.

10. Zbatimi i procedurave për arkivimin e dokumentacionit referuar Modelit nr. 8 “Norma tekniko profesionale dhe metodologjisë të shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë” miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në zbatim të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”.

Titulli i Gjetjes	Zyra e protokoll/arkivës.
Situata:	Për vitet 2017, 2018 dhe 2019 nuk janë ndjekur procedurat e veçimit dhe asgjësimit të dokumenteve që kanë plotësuar afatin e ruajtjes, ku të ngrihet një komision i posaçëm për vlerësimin e dokumentacionit që është për asgjësim. Zyra e protokoll/arkivës nuk disponon regjistër të inventarit të fondeve, regjistër të inventarit të dokumenteve teknike të institucionit dhe regjistër të shfrytëzimit. Gjithashtu, nuk kryhet numërimi i shkresave zyrtare në një regjister ku të përcaktohen shkresat që hyjnë dhe dalin nga Porti Detar Shëngjin SHA. Nga auditimi rezulton se kur dokumentacioni është klasifikuar “Sekret”, nuk është praktikuar që në zarfën që dërgohen shkresat të jetë e shkruar “sekret” në mënyrë që dokumentacioni të trajtohet me kujdes të lartë. <i>(Më hollësisht trajtuar në Aneks 8, të këtij Raporti).</i>
Kriteri:	Ligji nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat” dhe ne Rregulloren “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike e shërbimit arkivor ne RSH”.
Ndikimi:	Moszbatimi i plotë i të gjithë komponentëve të ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat” dhe ne Rregulloren “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike e shërbimit arkivor në RSH”.
Rekomandimi:	- Drejtoria e Portit Detar Shëngjin SHA, të marrë masat e nevojshme që zyra e protokoll/arkivës të zbatojë komponentët sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat” dhe ne Rregulloren “Norma tekniko-profesionale



dhe metodologjike e shërbimit arkivor ne RSH”.

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: KLSH për përmirësimin e situatës ka rekomanduar:

- 18 masa organizative, nga të cilat janë zbatuar 7 masa, 2 janë realizuar pjesërisht, 5 janë në proces realizimi dhe 4 prej tyre nuk janë zbatuar.

- 13 masa për shpërblim dëmi, në shumën 10,689,582 lekë, nga të cilat 2 masa janë zbatuar në vlerën 134,160 lekë, 5 janë në proces në vlerën 5,671,446 lekë, 5 masa nuk janë pranuar në vlerën 4,151,556 lekë dhe 1 masë nuk është realizuar në vlerën 732,420 lekë.

-7 masa për shpenzime jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit, nga të cilat 3 janë zbatuar, 1 është zbatuar pjesërisht, 2 janë në proces realizimi dhe 1 masë nuk është zbatuar.

- 9 masa disiplinore, nga të cilat janë zbatuar të gjitha.

Sa më sipër bie në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, neni 15, pika c. (Trajtuar më hollësisht në faqet 12-13, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Porti Detar Shëngjin SHA, të marrin masa për zbatimin dhe realizimin e plotë të rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme të KLSH-së, si edhe të ndiqen me prioritet në të gjitha shkallët e gjykimit ato të cilat janë në procese gjyqësore.

Brenda vitit 2020

2. Gjetje nga auditimi: Referuar dokumentacionit shoqëruar për mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës, zhvilluar në datat 17.06.2019, 18.09.2019 dhe 02.12.2019 u konstatua se 1 nga anëtarët e tij zj. L. S., ka munguar më shumë se në 3 mbledhje radhazi. Mungesa e saj u verifikua nga kontrolli i vendimeve dhe protokollit të mbledhjeve ku zj S. nuk ka firmosur duke mos respektuar Statutin e Shoqërisë neni 13, pika 5. (Trajtuar më hollësisht në faqet 12-13, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).



KONTROLI I LARTË I SHTETIT RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR SHËNGJIN SHA

2.1 Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës të marrë masat e nevojshme që të bëhet propozimi Asamblesë së Përgjithshme për shkarkimin e anëtares së tij L. S.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Programi ekonomik i shoqërisë për periudhën objekt auditimi, nuk është hartuar saktë mbi baza reale referuar kapaciteteve për realizimin e treguesve ekonomik-financiarë, si edhe flet për punë të pamjaftueshme nga strukturat drejtuese të shoqërisë, kjo si rezultat i mos vënies në efektivitet të plotë të aseteve të shoqërisë.

-Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të programit ekonomik financiar të shoqërisë dhe realizimin e objektivave për vitet 2017, 2018 dhe 2019 rezultoi se, realizimi i të ardhurave në 3 vite paraqitet me oshilacione negative: viti 2017- 70%, viti 2018- 80%, viti 2019 -68.5%, duke sjellë përkeqësim të situatës ekonomike dhe thellim të rezultatit ekonomik negativ në fund të vitit 2019 me *humbje në shumën 105,210 mijë lekë*.

-Shoqëria për 3 vitet, nuk ka realizuar të ardhurat nga përpunimi i anijeve, i cili është aktiviteti kryesor i punës dhe krijimit të të ardhurave, kjo jo vetëm për shkak të rënies së aktivitetit në përpunimin e anijeve por edhe pasojë e keqmenaxhimit të burimeve të brendshme të shoqërisë, pasi procesi i ngarkim-shkarkimit është kryer me mjetet e operatorëve ekonomikë privat me zbritje të vlerës së tarifës me 56 % se tarifat e miratuara për proceset e punës me mjetet e portit. Rritja e të ardhurave nga zëra “të tjerë” si tarifat portuale, qiratë etj., jo vetëm që shfaq mangësitë e programimit, por në të njëjtën kohë shfaq prirjen për sigurimin e të ardhurave jashtë aktivitetit kryesor të shoqërisë, duke shkaktuar paqëndrueshmëri financiare afatgjatë.

-Shoqëria Porti Detar Shëngjin, për 3 vitet objekt auditimi, konstatohet se nuk ka realizuar investimet e parashikuara, për vitet 2017 dhe 2019 janë parashikuar 2,570 milionë lekë investime, realizuar 0 lekë dhe për vitin 2018 janë parashikuar 1,183 milionë lekë, realizuar vetëm 9.6%. Realizimi i investimeve në këto nivele flet për një punë të dobët nga strukturat drejtuese si edhe nga Dega e investimeve, e cila përbëhet nga 6 punonjës, 1 shef sektori dhe 5 specialistë.

-Këshilli Mbikëqyrës dhe Strukturat drejtuese të Portit Detar Shëngjin të marrin në analizë ecurinë e zbatimit të programit ekonomik duke evidentuar përgjegjësitë për situatën e krijuar, marrjen e masave për vënien në efikasitet të aseteve të shoqërisë me qëllim arritjen e rezultatit ekonomik pozitiv, përmirësimin e treguesve ekonomik-financiar dhe arritjen e objektivave të zhvillimit të shoqërisë.

-Strukturat drejtuese të Portit Detar Shëngjin, Dega e Investimeve, Dega e Financës dhe Dega e Përpunimit, të marrë masa për programimin e saktë dhe të argumentuar të nevojave për investime, uljen e numrit të punonjësve në degën e investimeve, forcimin e kapaciteteve profesionale në degën e investimeve, nëpërmjet bashkërendimit të punës së degëve e specialistëve duke njohur dhe vlerësuar kapacitetet me qëllim arritjen e objektivave të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

përcaktuara për zhvillimin e shoqërisë. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 13-17, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1 Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës dhe Strukturat drejtuese të Portit Detar Shëngjin të marrin në analizë ecurinë e zbatimit të programit ekonomik duke evidentuar përgjegjësitë për situatën e krijuar, marrjen e masave për vënien në efikasitet të aseteve të shoqërisë me qëllim arritjen e rezultatit ekonomik pozitiv, përmirësimin e treguesve ekonomik-financiar dhe arritjen e objektivave të zhvillimit të shoqërisë.

Menjëherë.

3.2 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Portit Detar Shëngjin, Dega e Investimeve, Dega e Financës dhe Dega e Përpunimit, të marrë masa për programimin e saktë dhe të argumentuar të nevojave për investime, uljen e numrit të punonjësve në degën e investimeve, forcimin e kapaciteteve profesionale në degën e investimeve, nëpërmjet bashkërendimit të punës së degëve e specialistëve duke njohur dhe vlerësuar kapacitetet me qëllim arritjen e objektivave të përcaktuara për zhvillimin e shoqërisë.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

4. Gjetje nga auditimi: Niveli i pagave për vitin 2017 është i pa përcaktuar dhe është operuar sipas urdhërave të titullarit të shoqërisë. Në këtë mënyrë i lihet hapësirë e lirë titullarit për vendimmarrje në nivelin e pagave të punonjësve ku konstatohet se për pozicione të njehta ka nivele të ndryshme page duke treguar sjellje preferenciale ndaj punonjësve. Po kështu niveli i pagave për vitin 2017 nuk është miratuar në Këshillin Mbikëqyrës.

-Për vitet 2018-2019 nivelet e pagave janë miratuar nga organet kolegjiale drejtuese të shoqërisë brenda kufirit minimal e maksimal të pagës së caktuar nga Këshilli i Ministrave, në varësi të mundësive financiare të shoqërisë, por nuk janë miratuar nga ministri përkatës.

-Për vitin 2018 është miratuar niveli i pagave për këtë shoqëri me vendimin nr. 3, datë, 09.02.2018, i aplikuar edhe për vitin 2019 me ndryshimet e miratuara në vendimin nr. 8 datë, 28.09.2018 duke përcaktuar klasat sipas kualifikimit dhe pozicioneve të punës. Veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 10405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve” nenet 2 dhe 6. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 17-18, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1 Rekomandimi: Përcaktimi i nivelit të pagave të kryhet sipas legjislacionit në fuqi nga Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë dhe në çdo kohë pozicione pune të ngjashme duhet të kenë pagë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR SHËNGJIN SHA

të njëjtë. Diferencimi mund të kryhet në performancën e secilit punonjës, në çdo rast e dokumentuar me rezultate konkrete në punë dhe jo vetëm me vendim të titullarit duke favorizuar/diskriminuar punonjësit.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Shoqëria, sipas strukturës së miratuar është i organizuar me 150 punonjës. Nga auditimi me zgjedhje i 15 dosjeve të punonjësve të marrë rishtas në punë për periudhën objekt auditimi, rezulton se dokumentacioni në dosjet e personelit ka mangësi. Në tre raste emërimet në punë janë vetëm me dëftesë shkolle të mesme, ndërkohë që emërimi është kryer në pozicionin e specialistit të prokurimit, një sektor me shumë risk për shoqërinë. Dosjet janë me mangësi në dokumentacion si: karta e identitetit, çertifikatë familjare, dëftesa/diploma e studimeve të kryera (fotokopje të noterizuara) dokumente shtesë për grada e tituj shkencorë, për kurset e trajnimit, gjuhët e huaja, dëshmi penaliteti, etj. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” dhe Vendimi Nr. 117, datë 05.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 18-19, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1 Rekomandimi: Të plotësohen të gjitha dosjet e punonjësve dhe sidomos kontrata e punës ku të specifikohet qartë pozicioni i punës në përputhje me nivelin arsimor dhe profesional të çdo punonjësi si dhe paga bruto për periudhën e punësimit. Në çdo kohë, në dosjen e punonjësit duhet të figurojnë kopje të të gjithë urdhrave të transferimit në pozicione pune të tjera brenda shoqërisë për të rritur transparencën në afrimin e pozicioneve të punës me formimin përkatës.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Shoqëria nuk ka rregullore të miratuar, ku të përcaktohen procedurat që ndiqen për mënyrën e rekrutimit të stafit. Për periudhën objekt auditimi, mungon transparenca për shpalljen e vendeve vakante dhe intervistimin ose testimin e kandidatëve deri në përzgjedhjen e tyre. Në vitin 2017 nga 05.12.2017-04.01.2018 titullari ka kryer lëvizje të punonjësve, ku rekrutimet në punë kanë qenë vetëm me një urdhër të ish titullarit, pra përzgjedhjen e kandidatëve është kryer në mënyrë subjektive, pa marrë në konsideratë nivelin arsimor dhe eksperiencën e tyre, duke e ekspozuar drejt një risku akoma më të madh këtë shoqëri. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, Neni 167 “Përbërja, të drejtat e detyrimet e këshillit mbikëqyrës dhe administratorët”. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 19-22, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

6.1 Rekomandimi: Drejtori i shoqërisë dhe Dega e Burimeve Njerëzore, të hartojnë rregulla dhe procedura specifike ku të specifikohen qartë kriteret e punësimit për çdo pozicion pune lidhur me nivelin arsimor, përvojën në punë, formimin bazë apo trajnimet profesionale të nevojshme për përmbushjen efikase të detyrave për çdo pozicion pune, duke rritur transparencën e mënyrës së punësimit dhe rekrutimit në bazë të meritokracisë.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Administratori i shoqërisë nuk informon organet drejtuese, në këtë rast Këshillin Mbikqyrës, për rritjen e kostove operative për punësimet pa kriter, për marrjen në punë të punonjësve të pa specializuar ose të pa profesionalizuar, për emërimet pa kriter, për procedurat e pasakta të prokurimit, për moszbatim të vendimeve të asamblesë së aksionarëve, etj. Për 4 mujorin e fundit të vitit 2019, për këtë situatë edhe pse ka një vendim të asamblesë së përgjithshme nr. 69, datë 15.08.2019 ku është vendosur dhe i kërkohet urgjentisht reduktimi i shpezimeve ndër to edhe ato të personelit, nga ana e titullarit nuk është marrë asnjë masë, për më tepër mundësia ka qenë e madhe, nisur nga dorëheqjet e shumta që i janë paraqitur titullarit në këtë periudhë, sërisht ky i fundit ka bërë zëvendësim stafi. Administratori nuk respekton gjendjen e vështirësisë financiare të shoqërisë si edhe vendimin e asamblesë së përgjithshme duke e thelluar rezultatin negativ, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, Nenet 15 dhe 154. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 23-24, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1 Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë dhe Këshilli Mbikqyrës, të analizojnë situatën e krijuar dhe të nxjerrin përgjegjësitë gjithësecili për lënien dhe përkeqësimin e situatës me veprimet dhe mos veprimet e tyre si dhe për mos zbatimin e urdhërave.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Arkëtimi i detyrimeve nga subjektet të cilat kanë kontrata të nënshkruara me Portin Detar Shëngjin, është kryer 1-6 vjet me vonesë, pra faturat dhe situacionet e hartuara nga Porti Detar për punën e kryer ndaj tyre datojnë prej vitit 2014 e në vazhdim, ndërsa pagesat e detyrimeve vazhdojnë ende, duke sjellë vështirësi financiare për aktivitetin e Portit. Megjithëse janë dërguar disa shkresa për njoftim për pagesën e detyrimeve, si edhe përcaktimi në shkresën nr.159, datë 04.07.2019 se: detyrimet monetare përbëjnë titull ekzekutiv dhe vihen në ekzekutim të detyrueshëm, përsëri **nga strukturat drejtuese nuk është vepruar**. Detyrimi nga kompanitë e kontraktuara për ushtrimin e aktivitetit në Port kryesisht “Rafaelo 2002”, është **10,839 mijë lekë dhe 37,746 Euro, krijuar prej vitit 2014**. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 24-26, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

8.1 Rekomandim: Strukturat drejtuese të Portit Detar Shëngjin, Dega e Financës dhe Dega e Përpunimit, të marrin masa për kryerjen në afat të arkëtimeve dhe detyrimeve të prapambetura nga subjektet private të cilat kryejnë aktivitetet në Port sipas kontratave të nënshkruara, duke ndjekur procedurat ligjore me qëllim eliminimin e vonesave të pajustificuara, rritjen e të ardhurave të shoqërisë duke ndikuar në përmirësimin e treguesve ekonomiko-financiarë.

Brenda vitit 2020

9. Gjetje nga auditimi: Në procedurat e kryera për blerjet me vlera të vogla konstatohet se:

- AK, në 4 raste ka kryer blerje me vlera të vogla në formë shkresore duke shmangur procedurat on line dhe copëzuar fondin. Titullari i Autoritetit Kontraktor ka ngritur komisionet për blerjet me vlera të vogla në 6 mujorin e fundit të vitit. Autoriteti Kontraktor ka përdorur procedurën e blerjeve me vlera të vogla edhe në rastet kur kryerja e blerjes dhe shërbimeve nuk janë në kushtet e emergjencës, pa u respektuar përcaktimet sipas Udhëzimit nr.3, datë 27.01.2015, i ndryshuar me udhëzimin nr.2, datë 24.04.2017. Në procedurat e zhvilluara për blerjet me vlera të vogla nuk janë përcaktuar specifikime teknike për mallrat/punët apo shërbimet, veprime në kundërshtim me VKM nr.914, datë 19.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 24-26, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1 Rekomandim: Nëpunësi autorizues, Drejtori i shoqërisë, të hartojnë dhe miratojnë rregullat për gjurmët e auditimit, për procedurat standarde të shpenzimeve; AK të marrë masa që të mos kryhet asnjë blerje apo shërbim me procedurë të vogël, pa u kaluar nëpërmjet platformës elektronike, në respektim të legjislacionit të prokurimit publik në fuqi, me qëllim arritjen e objektivave të kërkuar.

Brenda vitit 2020

9.2 Rekomandim: Strukturat drejtuese të Portit Detar Shëngjin, Dega e Financës dhe Dega e Përpunimit, të marrin masa për kryerjen në afat të arkëtimeve dhe detyrimeve të prapambetura nga subjektet private të cilat kryejnë aktivitetet në Port sipas kontratave të nënshkruara, duke ndjekur procedurat ligjore me qëllim eliminimin e vonesave të pajustificuara, rritjen e të ardhurave të shoqërisë duke ndikuar në përmirësimin e treguesve ekonomiko-financiarë.

Brenda vitit 2020

10. Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat financiare të vitit 2017 dhe 2018 vlera e truallit nga rivlerësimi paraqitet në kontabilitet me vlerë 650,950,000 lekë dhe në regjistrin e aseteve me një sipërfaqe prej 26,038 m². Nuk paraqitet në kontabilitet vlera analitike e tokës dhe ndërtesës sa janë specifikisht por vlera e tyre jepet e bashkuar, duke u amortizuar të dyja me normën e amortizimit prej 3%. Gjithashtu zërat e impianteve dhe makinerive dhe instalimeve e pajisjeve



KONTROLI I LARTË I SHTETIT RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR SHËNGJIN SHA

duhet të jenë analitike në mënyrë që të jepet informacion sa më transparent mbi mënyrën e amortizimit të tyre. Nga auditimi i deklarimeve dhe të dhënave në sistemin tatimor rezultoi se në deklaratat e tatim fitimit për vitin fiskal 2017-2018 në sistemin tatimor nuk janë deklaruar shpenzimet e pazbritshme të ndara nga shpenzimet e përgjithshme sipas pasqyrave financiare dhe sipas shpjegimeve në lidhje me këto shpenzime. Shpenzimet e pazbritshme përfshihen në shpenzimet e përgjithshme duke ndikuar në këtë mënyrë në një rezultat të ndryshëm financiar. Nuk reflektohen vendimet e aksionarit në lidhje me zvogëlimin e kapitalit për humbjen e vitit 2017 e cila paraqitet 21,122,417 lekë, sipas shkresës nr 6135/1 prot., datë 25.05.2017 të MZHETTS. Me vendimin nr. 12522/1 prot., Nr. 69 datë 15.08.2019 është marrë vendimi i asamblesë së përgjithshme të aksionarit mbi destinimin e humbjes për vitin 2018. Vendimi është marrë me vonesë dhe duhej depozituar brenda datës 31.07.2019, duke e ngarkuar shoqërinë me 10,000 lekë gjobë në sistemin tatimor. Ky vendim përcakton që humbja e ushtrimit të mbartet në bilancin kontabël. Nuk është bërë përcaktimi i saktë se ku do të mbartet realisht humbja, në humbje të akumuluar, në ulje të rezervave nga rivlerësimi etj. Në këtë shoqëri është përfituar një grant qeveritar me vlerë 649,774,625 lekë për të cilën edhe pse u kërkua dokumentacioni i plotë, nuk u gjend në shoqëri. Mungesa e dokumentacionit krijon paqartësi për përqindjen e njohjes së grantit në kontabilitet. Gjithashtu në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare nuk jepet informacion në lidhje me grantin dhe mënyrën e njohjes së tij nga viti në vit. Nuk janë marrë masa për arkëtimin e detyrimit nga kompania Dushku “E” dhe ndaj personave të cilët kanë detyrime të cilat aktualisht kanë kaluar periudhën një vit dhe nuk janë shlyer as duke u mbajtur nga pagat dhe as duke i dërguar ndonjë shkresë në lidhje me këtë detyrim. Nuk është bërë provizioni i këtij detyrimi i cili ka kaluar periudhën një vjeçare dhe mund të mos jetë i arkëtueshëm. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 27-28, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1 Rekomandim: Këshilli Mbikqyrës të analizojë me përgjegjësi letrat e menaxhimit lëshuar nga ekspertët kontabël dhe të marrë masa për të përmirësuar situatën duke synuar cilësi në pasqyrat financiare.

Brenda vitit 2020

11. Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat financiare të vitit 2017, nuk paraqitet e ndarë analitikisht vlera e tokës dhe ndërtesës, të cilat amortizohen bashkë me normën 5%. Vetëm ndërtesa amortizohet me ligj në normën 5% të vlerës së mbetur kurse Toka nuk amortizohet. Vlera e rivlerësuar e mbetur e Tokës në 31.12.2017 është 650,950,000 lekë, ndërsa vlera e rivlerësuar e ndërtesës është 926,171,973 lekë. Maksimumi ligjor me të cilën amortizohet ndërtesa është 5% e vlerës së mbetur dmth $5\% \times 926,171,973 \text{ lekë} = 46,308,598.65 \text{ lekë}$, duke krijuar një devijim në raportimin e pasqyrave financiare në shumën **2,669,209.³⁵ lekë** nga amortizimi i llogaritur në 31.12.2017 48,977,808 lekë, në kundërshtim me Udhëzimi nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, Pika 3.7. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 28-29, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

11.1 Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe Titullari të saktësojnë devijimet në llogaritjen e amortizimit, të saktësojnë vlerën reale të mbetur dhe të paraqesë në mënyrë korrekte shpenzimin e amortizimit të aseteve të shoqërisë sipas normave ligjore duke marrë parasysh jetëgjatësinë e çdo aseti.

Brenda vitit 2020

12. Gjetje nga auditimi: Nga Porti Detar, nuk janë zbatuar plotësisht përcaktimet ligjore të bëra në: Ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, VKM nr.914, datë 19.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe në Dokumentet Standarde të tenderit. *Për vitin 2017*, nga Autoriteti Kontraktor janë programuar 19 procedura prokurimi me vlerë 1,400 mijë lekë, nga të cilat nuk është realizuar asnjë procedurë prokurimi. *Për vitin 2018*, janë programuar 4 procedura prokurimi me vlerë 5,300 mijë lekë, nga të cilat është realizuar dhe audituar 1(një) procedurë prokurimi me objekt “Blerje uniforma për sektorin e sigurisë” me fond limit 1,250 mijë lekë. Është nënshkruar 1 kontratë me vlerë 1,249,920 lekë dhe *për vitin 2019*, janë programuar 2 procedura prokurimi me vlerë 2,300 mijë lekë, nga të cilat është realizuar dhe audituar 1(një) procedurë prokurimi me objekt “Blerje karburant” me fond limit 1,300 mijë lekë. Është nënshkruar 1 kontratë me vlerë 1,300 mijë lekë.

Në tenderat e zhvilluar në hartimin e dokumenteve të tenderit nga njësia e prokurimit, konstatohet se nuk janë argumentuar kriteret e vendosura, veprim në kundërshtim me nenin 61/2 “Dokumentet e tenderit”.

Njësia e prokurimit nuk ka marrë pjesë në asnjë trajnim në fushën e prokurimeve. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 29-31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

12.1 Rekomandim: Njësia e Prokurimit, për të ardhmen, të marrë të gjitha masat për eliminimin e praktikave problematike të konstatuara në lidhje me kërkesat e veçanta kualifikuese, ato të hartohen në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit, të përcaktohen kriteret kualifikimi të sakta dhe të kuptueshme, pa lënë shteg për interpretime si dhe të detajohen sipas rregullave të prokurimit publik. Gjithashtu kërkesat kualifikuese të veçanta të hartuara e miratuara nga autoriteti kontraktor duhet të jenë detyruesisht të argumentuara.

Në vazhdimësi

12.2 Rekomandim: Autoriteti kontraktor, të marrë masa për të përmirësuar përbërjen e Njesisë së Prokurimit, duke bërë të mundur trajnimin e vazhdueshëm të anëtarëve të Njesisë së Prokurimit, nëpërmjet trajnimeve në Agjencinë e Prokurimit Publik, për çështjet e prokurimit publik, në përmbushje të kërkesës së VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Brenda vitit 2020



13. Gjetje nga auditimi: Llogaritja e fondit limit në tenderin me objekt “Blerje uniforma pune për punonjësit e sigurisë për vitin 2018” me fond limit 1,427 mijë lekë, nuk është kryer e plotë, por vetëm për 9 nga 14 artikujt e kërkuar, studimi i vlerës së kontratës nuk është plotësisht i saktë, pasi në përcaktimin e fondit limit nuk janë harmonizuar metodat e vendosura në aktet ligjore e nënligjore të prokurimeve, si çmimet e botuara nga INSTAT-i, çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse. Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, njësia e prokurimit është mbështetur në studimin e tregut dhe sigurimin e ofertave për të njohur nivelin aktual të tregut, por nuk është dokumentuar nëse nga Autoriteti Kontraktor janë kryer analizat e kostos së mallrave që do të prokurohen, duke krahasuar elementët e mësipërm me specifikimet teknike, në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, VKM nr.914, datë 19.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 59/2 “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës.

-Grupi i punës i ngritur për hartimin e specifikimeve teknike, në tenderin me objekt “Blerje uniforma pune për punonjësit e sigurisë” ka hartuar specifikimet teknike, në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 23 “Specifikimet teknike” komisioni kërkon bluza pambuku me material 50% leshi dhe 50% akriliku, si edhe ka kërkuar në specifikime teknike që Uniformat të jenë të reja.

-Nuk janë paraqitur kërkesat nga AK për numrat e kostumeve, këmishëve, këpucëve etj., veprime në kundërshtim me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit ku kërkohet që numrat dhe masat do të përcaktohen me nënshkrimin e kontratës, pra as kontrata nuk ka aneks ku të jenë përcaktuar këto specifikime.

-Dosjet e tenderave nuk janë inventarizuar dhe arkivuar, Njësia e Prokurimit në përfundim të çdo procedure prokurimi dhe për çdo dosje nuk ka kryer inventarizimin e brendshëm të saj, në përputhje me nenin 30, Modeli nr. 8 “Norma Teknike Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë”, miratuar nga DP e Arkivave, në zbatim të neneve 3 e 29 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 31-32, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

13.1 Rekomandim: Autoriteti Kontraktor, të hartojë kërkesa të veçanta për kualifikim, specifikime teknike dhe të kryej llogaritje të sakta të vlerës së kontratës që të sigurojë konkurrencën e nevojshme, si një nga parimet bazë të prokurimit në blerjen e mallrave, shërbimeve dhe punëve, me qëllim arritjen e rezultateve të dëshirueshme në efektivitetin e përdorimit të fondeve publike.

Në vazhdimësi

14. Gjetje nga auditimi: Referuar kontratës së furnizimit me karburant datë 11.03.2019, rezulton se është llogaritur edhe taksa e markimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të naftës, e



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

cila bie në kundërshtim me VKM nr. 498, datë 30.5.2013 “Për përcaktimin e procedurave të shënjimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të naftës”, pikat 4.1 dhe 4.2. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 31-32, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

14.1 Rekomandim: Autoriteti Kontraktor dhe Njësia e Prokurimit në çdo rast të shmang kostot shtesë në procedurat e prokurimit si edhe të kombinoje anëtarët e njësisë së prokurimit sipas profileve të punës për menaxhuar me efikasitet dhe eficientë buxhetin e saj, me qëllim arritjen e rezultateve të dëshirueshme në efektivitetin e përdorimit të fondeve publike.

Në vazhdimësi

15. Gjetje nga auditimi: Gjendja faktike e komponentëve përbërës të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezulton si më poshtë:

-Në rregulloren e brendshme të shoqërisë proceset kryesore të përfshira janë kryesisht sipas linjave funksionale të përgjegjësi, por nuk përshkruajnë me detaje procedurat dhe proceset për aktivitetet kryesore. Mungojnë procedurat e inspektimit, formatet e akteve të miratuara, procedurat e raportimit dhe kompetencat e inspektorëve, dhe për pasojë raportet periodike të inspektimeve. Nuk rezulton të ketë urdhër për të përfshirë procedura dhe formate të përmisuara dhe të miratuara për proceset kryesore të veprimtarisë së shoqërisë.

-Nuk janë hartuar dhe arkivuar gjurmët e auditimit dhe listat e proceseve kryesore.

-Nuk rezulton informimi i proceseve kryesore, përfshirë dokumentacionin përkatës të miratuar, procedurat e raportimit, etj.

-*Mungon regjistri i riskut.* Grupi i Menaxhimit Strategjik nuk është krijuar dhe për pasojë nuk funksionon.

-Veprimtaritë e kontrollit nuk janë të mjaftueshme. Mungesa e përdorimit për kohë të gjatë e pajisjeve si mjete transporti, vinça etj. apo mosfunksionimi i tyre, tregojnë se rikuperimi i proceseve apo sistemeve është i ngadaltë. Kjo do të thotë se ndikimi i riskut operacional është i lartë. Nga auditimi rezultoi që menaxhimi jo vetëm nuk identifikon riskun përkatës, por edhe nuk e regjistron atë në regjistrin e riskut me qëllim ndjekjen dhe monitorimin si edhe marrjen e masave për reduktimin e tij.

-Mungon mbështetja e proceseve nëpërmjet sistemeve të IT (teknologjisë dhe informacionit). Veprime në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2011, i ndryshuar, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” pikat 2,3,4,5 neni 11, neni 1, pika 3, neni12. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 32-34, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

15.1 Rekomandim: Drejtori i shoqërisë të marrë masa për të implementuar një sistem eficient të menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke përfshirë të gjithë komponentët e tij. Shoqëria të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR SHËNGJIN SHA

hartojë regjistrin e riskut, listën e proceseve kryesore dhe gjurmët e auditimit, me qëllim arritjen e mjaftueshme të aktiviteteve të kontrollit për identifikimin, kontrollin dhe reduktimin e risqeve që kërcënojnë shoqërinë. Gjithashtu, të krijohet Grupi për Menaxhimin Strategjik, me qëllim verifikimin për të identifikuar dhe menaxhuar risqet brenda njësisë publike.

Menjëherë

16. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi, Porti Detar Shëngjin SH A. ka lidhur kontratë qiraje me 8 subjekte private me afat 1/vjeçar, për objekte dhe truall deri në 200m², si edhe me çmime nga vlera dysHEME 100 lekë/m² deri 200 lekë/m² muaj. Gjatë zbatimit të procedurave të auditimit rezultoi se në të gjitha praktikatat e lidhjes së kontratave të qirave, në dokumentacionin e tyre nuk ishte marrë miratimi i Këshillit Mbikëqyrës. Në kundërshtim me paragrafin 1, shkronja (b), kapitulli II në V.K.M nr.54, datë 05.02.2014, "Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore". (Trajtuar më hollësisht në faqet 34-35, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

16.1 Rekomandim: Strukturat drejtuese të menaxhimit përpara nënshkrimit të kontratave për dhënien me qira të pasurive të portit të marrin miratimin në Këshillin Mbikëqyrës. Porti Detar Shëngjin SH. A të rrisë performancën në drejtim të përdorimit ekonomik, efikas, dhe efektiv të burimeve të veta.

Në vazhdimësi

17. Gjetje nga auditimi: Subjekti "V. I. P." SH A, ka rinovuar kontratat e qirasë nr.111/7, datë 01.09.2017 dhe nr.294/3, datë 17.09.2018 për objektin "magazinë prej 50 m²", me një vlerë prej 10 000 lekë/ muaj. Gjatë auditimit rezultoi se subjekti me kontratën nr.267, datë 01.11.2019 ka rinovuar kushtet e kontratës për objektin magazinë nga 50 m² në 200 m². Gjatë zbatimit të procedurave të auditimit rezultoi se në të gjitha praktikatat mungonte proces-verbali për marrjen dhe dorëzim të objektit apo ndryshimin e kushteve të kontratës. (Trajtuar më hollësisht në faqet 35-36, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

17.1 Rekomandim: Strukturat drejtuese të Portit Detar Shëngjin SHA, të analizojnë zbatimin kushteve të kontratës nr.267 prot, datë 01.11.2019 me subjektin privat "V. I. P." SH.A.

Menjëherë

18. Gjetje nga auditimi: Për vitet 2017, 2018 dhe 2019 nuk janë ndjekur procedurat e veçimit dhe asgjësimit të dokumenteve që kanë plotësuar afatin e ruajtjes, ku të ngrihet një komision i posaçëm për vlerësimin e dokumentacionit që është për asgjësim.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

Zyra e protokoll/arkivës nuk disponon regjistër të inventarit të fondeve, regjistër të inventarit të dokumenteve teknike të institucionit dhe regjistër të shfrytëzimit.

Gjithashtu, nuk kryhet numërimi i shkresave zyrtare në një regjister ku të përcaktohen shkresat që hyjnë dhe dalin nga Porti Detar Shëngjin SHA. Nga auditimi rezulton se kur dokumentacioni është klasifikuar “Sekret”, nuk është praktikuar që në zarfin që dërgohen shkresat të jetë e shkruar “sekret” në mënyrë që dokumentacioni të trajtohet me kujdes të lartë. *(Më hollësisht trajtuar në faqen nr. 39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

19.1 Rekomandim: Drejtoria e Portit Detar Shëngjin SHA, të marrë masat e nevojshme që zyra e protokoll/arkivës të zbatojë komponentët sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat” dhe në Rregulloren “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike e shërbimit arkivor në RSH”.

Menjëherë

B.1. MASA SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 shkronja (b) dhe (c) Të drejtat e KLSH dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr.44/2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, dhe pikën 93 të UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga Administratori të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin dhe arkëtimin e dëmit ekonomik në **shumën 1,163,640 lekë**, si më poshtë vijon:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël rezultoi se, në procedurën e prokurimit “*Blerje pajisje elektronike, kompjutera, printere dhe bateri(UPS)*” me fond limit 794,834 lekë, furnizimi i kryer nga operatori ekonomik është bërë duke mos respektuar specifikimet teknike për pajisjet Desktop dhe UPS. Furnizimi me mallra prej 553,000 lekë në kundërshtim me specifikimet teknike konsiderohet dëm ekonomik deri në zëvendësimin e tyre, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20/11/2006 “*Për prokurimin publik*”, të ndryshuar si dhe VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar neni 64. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 24-26, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: Drejtori i Portit Detar Shëngjin SHA në të ardhmen në çdo grup pune të vendosë specialist të fushës për shmangien e këtyre situatave. Komisioni për marrjen në dorëzim të marrë masa për zbatimin e kritereve të miratuar e pranuar në kërkesa për mallra punë apo



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

shërbime, për menjanimin e furnizimeve në kundërshtim me specifikimet teknike të kërkuara si dhe arkëtimi i vlerës prej **553,000 lekë** nga operatori ekonomik A. sh.p.k.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël rezultoi që, në procedurën e prokurimit “*Blerje mobilje zyre*” me fond limit 794,834 lekë, furnizimi i kryer nga operatori ekonomik është bërë duke mos respektuar specifikimet teknike për llojin e materialit të përdorur nga MDF në Melamin një product il ngjashëm nga ana vizuale por jo në cilësi dhe në vlerë, produkti i cili ka një vlerë rreth 40% më të ulët krahsuar në librin dogonar të referencave. Furnizimi me mallra në vlerën prej 260,120 lekë në kundërshtim me specifikimet teknike konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet kthehet nga përfituesi. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20/11/2006 “*Për prokurimin publik*”, të ndryshuar si dhe VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar nenin 64 (*Më hollësisht trajtuar në faqet nr. 24-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1 Rekomandimi: Drejtori i Portit Detar Shëngjin SHA në të ardhmen në çdo grup pune të vendosë specialist të fushës për shmangien e këtyre situatave. Komisioni për marrjen në dorëzim të marrin masa për të zbatimin e kriterëve të miratuar e pranuar në kërkesa për mallra punë apo shërbime, për menjanimin e furnizimeve në kundërshtim me specifikimet e kërkuara si dhe kërkimi i vlerës prej **260,120 lekë** nga operatori ekonomik “O. &C.”.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Referuar pagesave të kryera dhe dokumentacionit shoqëruar për shpërblimin/mbledhje të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës sipas përcaktimeve ligjore, u konstatua se 1 nga anëtarët e Këshillit ka munguar më shumë se në 3 mbledhje radhazi dhe ka **përfitur padrejtësisht shpërblimin në vlerën 116,280 lekë**. Më konkretisht zj. Lindita Sotiri nuk ka qenë prezent në mbledhjet e datave 17.06.2019, 18.09.2019 dhe 02.12.2019 e megjithatë pagesa për zj. Sotiri ka vazhduar normalisht, në kundërshtim me Statusi i shoqërisë nr. 7777/1 prot., datë 23.11.2011, neni 13 “*Skualifikimi dhe largimi i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës*”, pika 5. (*Më hollësisht trajtuar në faqet nr. 12-13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1 Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës të marrë masa për t’i propozuar Drejtorisë së Portit Detar Shëngjin SHA, ndjekjen e procedurave administrative në të gjitha shkallët e gjykimit për të kërkuar shpërblimin e dëmit ekonomik, në vlerën **116,280 lekë**, të përfituar në mënyrë të padrejtë nga anëtarja e Këshillit Mbikëqyrës znj. L. S.

Menjëherë dhe në vijimësi



B.2. TË ARDHURA TË MUNGUARA

1. Gjetje nga auditimi: Me kontratën Nr.172 Prot. datë 31.07.2019 ishte dhënë me qira subjektit “R.” SHPK, sipërfaqe e lirë truall prej 200 m² dhe çmim 200 lekë/m², në kalatën e re, në funksion të aktivitetit të peshkimit.

Nga auditimi rezultoi se “R.” SHPK ankoronte 6 anije peshkimi në këtë pjesë të kalatës së re dhe se ky shërbim rezultonte i papaguar, duke përfituar nga shfrytëzimi i kalatës për ankorim, jashtë kontratës të sipërpërmendur.

Në kundërshtim me pikën 3, shkronjat (b) dhe (c), paragrafi 1.2.1, kapitulli I-rë, “Tarifat e portit dhe kanalit” në Urdhërin e Përbashkët Nr.3069 datë 14.06.2016, i ndryshuar, rezultoi që “R.” SHPK përfiton pa të drejtë shërbimin e ankorimit.

Për periudhën nga 01.08.2019 deri më 31.12. 2019 shuma që i detyrohet portit rezulton 720 € (6 anije x 40€/muaj x 3 muaj = 720€, meqenëse 2 muaj janë lundrim i detyruar ndërkombëtar). Për pjesën tjetër të vitit 01.01.2019-31.07.2019, mbi bazën edhe të raportimeve ditore të sigurisë së portit datë 01.01.2019, 05.02.2019, 29.03.2019, 22.04.2019, 28.05.2019 dhe 07.06.2019 shuma që i detyrohet portit rezulton 1200 € (6 anije x 40€/muaj x 5 muaj)

Sa sipër, shuma gjithsej 1920€ ose **243,240 lekë**, e cila përbën **të ardhur të munguar** për portin Detar Shëngjin sh.a.për vitin 2019. *(Më hollësisht trajtuar në faqet nr. 36-37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Portit Shëngjin SHA të ndjekin të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës prej **243,240 lekë**, nga subjekti “R.” SH.P.K. përfituar padrejtësisht për detyrimin e tarifës së ankorimit, ndaj Portit në shfrytëzimin e kalatës së re.

Mënjëherë

B.3. TË ARDHURA TË MUNGUARA PA MUNDËSI ARKËTIMI

1. Gjetje nga auditimi: Aktiviteti kryesor i shoqërisë për sigurimin e të ardhurave është ngarkim/shkarkimi i mallrave, por nga auditimi është konstaur se të ardhurat për këtë aktivitet nuk janë realizuar jo vetëm për për shkak të rënies së volumit të punës, por edhe nga mos operimi dhe përdorimi i mjeteve të veta në ngarkim shkarkim. Për këtë proces punë në vitin 2016 shoqëria Porti Detarë Shëngjin ka shpenzuar një vlerë prej **30,316,800 lekë** për blerje vinç të cilin në auditimin e më parshëm të KLSH është konstaur: “...totalisht evaziv vit prodhimi i mjetit duke mos dhënë siguri të arsyeshme për jetëgjatësinë e këtij vinçi për Portin Detar Sh.A Shëngjin, për efektshmërinë e tij, ...”. Me urdhërin e ish titullarit E. P. nr. 66 datë 19.12.2017 protokolluar me nr. 193 datë 19.12.2017, afërsisht pas një viti ky mjet përpunes Vinç është magazinuar duke e nxjerr në gjëndje konservimi, madje dhe për ato veprimari që ai (vinçi) kryen,



KONTROLI I LARTË I SHTETIT RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR SHËNGJIN SHA

bëhen me mjetet e operatorëve, ndërkohë që në strukturën e shoqërisë është përcaktuar posti i punës me emërtimin “vinçier”.

Referuar tarifave të përpunimit të mallrave, me mjetet e portit dhe mjetet e privatit 483 lekë/ton dhe 270 lekë/ton, rezulton zbritje e vlerës së tarifës me 56%, ose në vlerë duke ulur të ardhurat e portit në shumat **48,602,796 lekë, për vitin 2017, 44,243,506 lekë për vitin 2018 dhe 30,806,619 lekë për vitin 2019**, në një kohë që shoqëria funksionin dhe të ardhurat kryesore i siguron nëpërmjet përpunimit të mallrave, pasi ende nuk ka një kontratë për përpunim pasagjerësh linja ndërkombëtare si Portet e tjera që operojnë në Republikën e Shqipërisë,

Nga sa më sipër arrijmë në konkluzionin se nga drejtuesit e kësaj shoqërie është bërë një punë e dobët duke e çuar shoqërinë drejt një “rrënimi të provokuar”, pasi me veprimet dhe mosveprimet e tyre kanë çuar në krizë likuiditeti shoqërinë dhe në një humbje financiare e cila thellohet vit pas viti. Kështu, vetëm për vitin 2019, po të krahasojmë humbjen e llogaritur të vitit e cila është 30,161,691 lekë, rezulton se humbja është e përafërt me vlerën të cilën kjo shoqëri ka ulur të ardhurat nga keq menaxhimi dhe mosperdorimi i mjeteve të veta të ngarkim/shkarkimit, por duke e orientuar dhe përdorur mjetete e operatorëve ekonomik privat.

Në total, për periudhën objekt auditimi vlera e të ardhurave të munguara nga mosperdorimi i mjeteve në pronesi të shoqërisë është **106,482,867 lekë**.

1.1 Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës dhe Strukturat drejtuese të Portit Detar Shëngjin SHA të analizojnë situatën e krijuar gjatë aktivitetit të përpunimit të mallrave dhe të ngakojnë me përgjegjësi duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore drejtuesit të cilët kanë shkaktuar këtë gjendje financiare të shoqërisë.

Gjithashtu të marrin masa të menjëhershme për të vënë në funksion dhe përdorur mjetet e ngarkim/shkarkimit që shoqëria ka në pronësi, me qëllim reduktimin në maksimum të marrjes së këtij shërbimi nga operatorët privat dhe rritjen e të ardhurave të shoqërisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICIENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Për periudhën 01.01.2017-31.12.2019, janë ndërprerë marrëdhëniet e punës për 23 punonjës të shoqërisë, 18 prej tyre larguar me dorëheqje. Largimet e punonjësve, si dhe mosndjekja e procedurave ligjore në ndërprerjen e marrëdhënieve të punës nga ish titullari Gj. T. si dhe nga Këshilli Mbikëqyrës për shkarkimin e ish titullarit Gj. T., deri më datë 31.12.2019, kjo shoqëri është palë (e paditur) në 3 çështje gjyqësore në lidhje me marrëdhëniet e



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

punës. Deri më datë 31.12.2019, ka përfunduar gjykimi në të gjitha shkallët. Vlera e kërkuar dhe e likuajduar është **4,501,760 lekë, e cila përbën efekt financiar negativ për shoqërinë**. Po të marrim parasysh që shoqëria ka në proces edhe një vendim me pretendimin e 16 pagave ose 1,085,760 lekë, efekti negativ do jetë edhe më i lartë për shoqërinë, në kundërshtim me Ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” pika 3, neni 155 Zgjidhja e menjëhershme e pajustificuar e kontratës së punës nga punëdhënësi, neni 27. (Më hollësisht trajtuar në faqet nr. 18-19 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Shoqëria duhet të marrë masa për shqyrtimin e **efektit financiar negativ** në vlerën totale **4,501,760 lekë**, me probabilitet për tu rritur edhe me 1,085,760 lekë, për çështjet të cilat janë ende në gjykim, ardhur si pasojë e mos-ndjekjes së procedurave ligjore në largimin e punonjësve nga puna, për evidentimin e përgjegjësive.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

1.2 Rekomandimi: Sektori Juridik të marrë masa për ndjekjen e të gjitha çështjeve gjyqësore në të gjitha shkallët e gjyqimit për shmangien e kostove shtesë nga proceset gjyqësore të cilat mbartin risk të lartë për këtë shoqëri. Shoqëria duhet të marrë masa të analizojë në mënyrë të detajuar rastet e largimit nga puna, si dhe krijimin e detyrimeve të shtuara përmbartimore, duke evidentuar përgjegjësitë individuale, humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, në sistemin tatimor rezultonin gjoba në vlerën 80,000 lekë si gjobë për deklarime të vonuar, nga të cilat 20,000 lekë për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, 10,000 lekë për tatim fitimin dhe 50,000 lekë për mos dhënie informacioni, vlerë e cila përbën efekt negativ financiar.

Për vitin 2017, u konstatuan pasaktësi në pozicione pune të cilat nuk janë në strukturën e miratuar të sektorit/degës, por janë në listëprezencë, listëpagesë dhe në sistemin tatimor, mospërputhje midis emërimit të pozicionit të punës të shënuar në kontratën e punës dhe atij të shënuar në listëprezencë, listëpagesë dhe në sistemin tatimor dhe dublim të pozicioneve të punës. Për të njëjtin departament gjatë vitit 2018 figurojnë 2 persona të siguruar si shef zyre me ndryshime të vogla në emërtime në sistemin tatimor ku paga aplikohet në nivel përgjegjësi; pozicione pune të cilat nuk paguhen sipas nivelit referues të pagave të miratuara nga Këshilli Mbikqyrës. Kjo ka krijuar diferenca ku disa persona paguhen për pozicione pune të ndryshme nga kontrata punës ose të ndryshme nga pozicioni i punës i miratuar.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

Diferencat e pagave sipas strukturës ekzistuese dhe emërimeve të drejtorit, për vitin 2017 janë 1,723,929 lekë. Për muajin janar 2018 i cili ka si referencë nivelin e pagave të vitit 2017 të Këshillit Mbikëqyrës është krijuar një efekt negativ në shumën 150,184 lekë.

Diferencat për vitin 2018 janë 210,453 lekë dhe për vitin 2019 janë 346,143 lekë. Në total diferencat e konstatuara në nivelin e pagave janë **2,430,709 lekë, vlerë e cila përbën efekt negativ financiar.**

-Nuk ka unifikim të emërtimeve në sistemin tatimor për pozicione pune të ngjashme dhe ka diferenca në caktimin e pagave për të njëjtat pozicione pune duke nxitur diskriminimin në punë.

-Gjithashtu administratori për disa punonjës ka nxjerr urdhëra me një nivel page të përcaktuar në kundërshtim me pagat e miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës dhe për disa të tjerë nxjerr urdhër ku niveli i pagës të vendoset sipas strukturës së miratuar nga Këshilli. *(Më hollësisht trajtuar në faqet nr. 21-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës dhe Titullari i Portit Detar Shëngjin, të marrin masa për përcaktimin e nivelit të pagave sipas pozicionit dhe vendit të punës, pozicione pune të ngjashme duhet të kenë pagë të njëjtë.

Menjëherë

2.2 Rekomandimi: Shoqëria të marrë masa për uljen e numrit të punonjësve, të rekrutojë punonjës të kualifikuar dhe të menaxhojë me efektivitet procedurat operacionale të përditshme për rritjen e rentabilitetit të shoqërisë.

Menjëherë

2.3 Rekomandimi: Këshilli Mbikëqyrës dhe Strukturat drejtuese të shoqërisë të marrin në shqyrtim dhe analizojnë **efektin negativ financiar shkaktuar në shumën 2,430,709 lekë**, duke ristrukturuar nivelin e pagave dhe pozicioneve të punës në përputhje me vendimet e miratuara.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2017, nga ish drejtori i përgjithshëm Gj. T. me urdhërin nr. 70 prot. datë 04.05.2017 është emëruar në detyrë z. D. M. me pagë 66,560 lekë në pozicionin e "Sinjalizuesit dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve". Emërimi në detyrë i këtij punonjësi apo i kujdo punonjësi tjetër, është në kundërshtim me VKM nr. 816 datë 16.11.2016 "*Për strukturën, kriteret e përzgjedhjes dhe marrëdhëniet e punës së punonjësve të njësisë përgjegjëse në autoritetet publike*", pasi në pikën 3 të kësaj VKM përcaktohet se kush është struktura përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve në rastet kur autoriteti publik nuk ka në strukturën e tij



KONTROLI I LARTË I SHTETIT RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR SHËNGJIN SHA

strukturë auditimi të brendshëm, njësi përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve është drejtuesi i strukturës së burimeve njerëzore dhe një nëpunës/punonjës i punonjës i saj. Në mungesë të tyre, kjo njësi përbëhet nga dy nëpunës/punonjës të strukturës së burimeve njerëzore. Për sa më lart shpenzimet në shumën **590,040 lekë** për 9 pagat e përfituara, **rezultojnë efekt negative financiar për shoqërinë Porti Detar Shëngjin**. (Trajtuar më hollësisht në faqet 19-21, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë dhe Drejtorja e financës të shqyrtohet me përgjegjësi rasti I emërimit të pambvështetur në dispozitat ligjiore, me qëllim shmangien e praktikave të tjera në të ardhmen dhe eliminimin e shpenzimeve që rëndojnë me të padrejtë buxhetin e shoqërisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

SHKURTIME

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
Shoqëria	Porti Detar Shëngjin Sh.A
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
IFAC	Federatës Ndërkombëtarë të Kontabilistëve



IT	Teknologjia e Informacionit
SHA	Shoqëri Aksionare
OE	Operator Ekonomik
KM	Këshilli Mbikëqyrës
AP	Asambleja e Përgjithshëm

VI. ANEKSE

Aneks 1

2. Mbi realizimin e rekomandimeve nga auditimi i mëparshëm.

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga Autoriteti Kontraktor të analizohet përgjegjësia e kryerjes së investimeve pa leje ndërtimi, dhe në vazhdimësi të mos procedohet me fillimin e punimeve pa u pajisur paraprakisht me leje ndërtimi. **Rekomandimi është në proces zbatimi.**
2. Të merren masa, nga “Porti Detar” Shëngjin, që në zbatim të kontratave për mallra të ngrihet komisioni me specialistë të fushës dhe të rregullohet procesi i marrjes në dorëzim të mallrave, si dhe të ngrejë grupin e kolaudimit të punimeve brenda 30 ditëve nga data e përfundimit të punimeve të ndërtimit të deklaruara nga zbatuesi i punimeve.

Nga ana e Porti Detar Shëngjin sha janë ngritur komisione për marrjen në dorëzim të mallrave me urdhër të titullarit për vitet 2017, 2018 dhe 2019, përse i përket për ngritjen e grupit të kolaudimit të punimeve nuk evidentohet pasi Porti Detar Shëngjin sha nuk ka kryer punime ndërtimi për periudhën e lartpërmëndur. **Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.**

3. Titullari i Portit Detar, Shëngjin dhe Sektori i Financës, të analizojnë parregullsitë e evidentuara në raportin e ekspertëve kontabël për pasqyrat financiare të vitit 2015, duke nxjerrë përfundime mbi arsyen e ekzistencës së këtyre problematikave dhe parandalimin e tyre në të ardhmen.

Nga Sektori i Financës, janë marrë masa për analizimin e parregullsitë e evidentuara në raportin e ekspertëve kontabël për pasqyrat financiare të vitit 2015, duke ju drejtuar Këshillit Mbikëqyrës me një kërkesë mbi arsyen e ekzistencës së këtyre problematikave dhe parandalimin e tyre në të ardhmen. Këshilli Mbikëqyrës me vendimin nr.04, datë 11.05.2018, ka vendosur “Të rakordohet llogaria “Diferenca rivlersimi” si dhe të kryhen shënimet përkatëse në kontabilitet”, “Për llogaritjen e amortizimit me vlerën e mbetur dhe vlerën e rivlersuar, të kryhet kalimi i diferencave të rivlersimit në llogarinë “fitim/humbje të mbartura”. **Rekomandimi është në proces zbatimi.**

4. Nga Titullari i Portit Detar Shëngjin, Sektori i Financës dhe Juristit i shoqërisë, të analizohet situata e debitorëve, nga ku të dalin përfundime për zgjidhjen e situatave të ndryshme të



KONTROLI I LARTË I SHËTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

krijuara, dhe të hartohet një procedurë standarde për arkëtimin e detyrimeve të debitorëve deri në adresimin në organet gjyqësore nëse do të jetë e nevojshme, pavarësisht nga vlera.

Nga ana e zyrës së financës janë dërguar evidenca për debitorët ndaj shoqërisë dhe në rastet e rekomanduara për shpërblim dëmi nga ana e KLSH-së janë ndjekur të gjithë procedurat ligjore për arkëtimin e detyrimeve ndaj Porti Detar Shëngjin sha deri në hapjen e proceseve gjyqësore ndaj subjekteve. **Rekomandimi është në proces zbatimi.**

5. Në vazhdimësi t'i kushtohet vëmendje maksimale inventarizimit vjetor të aseteve të shoqërisë, si një nga mjetet kryesore për dhënien e një sigurie të arsyeshme të mbrojtjes së pasurisë fizike të institucionit, duke zbatuar me rigorozitet rregullat për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik.

Nga drejtori i Portit Detar Shëngjin sha janë ngritur komisioni për inventarizimin e pasurisë për vitin 2017 me urdhërin nr. 205 prot., datë 04.01.2018 dhe për vitin 2019 është krijuar komisioni me urdhërin nr. 311 prot., datë 30.12.2019, u konstatua se bashkangjitur janë raportet përkatës . **Rekomandimi është zbatuar.**

6. Porti Detar SHA Shëngjin, të marrë masa që në vazhdimësi të ndërpritet rruga e sigurimit të mallrave dhe shërbimeve jashtë procedurave të prokurimit publik, për të cilat tregu ofron më shumë se një operator ekonomik, si një garanci për përdorimin me ekonomikitet, efektivitet dhe efikasitet të fondeve të shoqërisë. Nga dokumentacioni i paraqitur u konstatua se ky rekomandim është zbatuar. **Rekomandimi është zbatuar.**

6. Në vazhdimësi komisioni për blerjet e vogla të tregojë kujdes të veçantë në përcaktimin e specifikimeve teknike, duke shmangur kriteret diskriminuese, në mënyrë që të nxitet pjesëmarrje sa më e madhe e operatorëve ekonomik, me qëllim përdorimin me ekonomikitet, efektivitet dhe efikasitet të fondeve publike. Për këtë rekomandim janë marrë masat që në procedurat e prokurimeve të shmangen kriteret diskriminuese. **Rekomandimi është zbatuar.**

7. Titullari i Portit Detar SHA Shëngjin të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për testimin e normës së harxhimit të makinerive të portit, si dhe të hartojë një procedurë për testimin periodik të këtyre makinerive, në mënyrë që llogaritja e konsumit të karburantit të jetë sa më objektive. Këshilli Mbikqyrës të rishikojë Vendimin Nr. 3, datë 11.02.2015 për përcaktimin e normave fikse për përdorimin e karburantit, duke u bazuar tek testet e bëra nga Porti Detar SHA Shëngjin. Nga observacioni i dërguar konstatua se në lidhje me normativën e harxhimit të karburantit, janë marrë masa nga ana e Drejtorisë duke nxjerrë urdhrin nr. 192., 19.12.2017, "Krijimin e komisionit për testim periodik të normës së konsumimit/harxhimit të karburantit dhe vajit të makinerive të portit". Nga ana e komisionit të ngritur është mbajtur procesverbal me datën 21.12.2017 ku përcakton normën e konsumit të karburantit dhe vajit nga makineritë e portit, por nga ana e Drejtorisë nuk është dërguar në Këshillin Mbikqyrës për miratimin e këtyre normativave. Për arsyet e lartpërmendura rekomandimi do të konsiderohet i realizuar pjesërisht. **Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.**



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

8. Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Titullari i “Porti Detar Shëngjin” SHA, të merren masa për miratimin e nivelit të pagave nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë, në zbatim të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”.

U konstatua se nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Portit Shëngjin dhe Sektori i Financës, janë marrë masa për miratimin e nivelit të pagave nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë, në zbatim të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.07, datë 02.12.2019. **Rekomandimi është realizuar.**

9. Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Shoqërisë, të rihartohet rregullorja e përcaktimit të kriterëve të punësimit, sipas pozicionit të vendeve të punës dhe të merren masa për zbatimin korrekt në rekrutimin apo lëvizjen e punonjësve. Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Portit Shëngjin dhe Sektori i Financës, nuk janë marrë masa për rihartohimin e rregullores së përcaktimit të kriterëve të punësimit, sipas pozicionit të vendeve të punës dhe për zbatimin korrekt në rekrutimin apo lëvizjen e punonjësve. **Rekomandimi nuk është zbatuar.**

10. Titullari i Portit Detar Shëngjin dhe sektori Financës, të analizojnë me saktësi numrin e fuqisë punëtore aktuale dhe të harmonizojë atë me nevojën aktuale dhe perspektivën e organizimit dhe funksionimit të Shoqërisë, duke marrë në kohë masat e nevojshme organizative, procedurale dhe ligjore në këtë drejtim. Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë, të analizohen në mënyrë të detajuar rastet e largimit nga puna, si dhe krijimin e detyrimeve të shtuara gjyqësore, duke evidentuar përgjegjësitë individuale, humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme për shoqërinë.

Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Portit Shëngjin dhe Sektori i Financës, nuk janë marrë masa për analizimin me saktësi të numrit të fuqisë punëtore aktuale dhe harmonizimit të këtij numri me nevojën aktuale dhe perspektivën e organizimit dhe funksionimit të Shoqërisë, duke marrë në kohë masat e nevojshme organizative, procedurale dhe ligjore në këtë drejtim, si dhe nuk janë marrë masa për analizimin në mënyrë të detajuar rastet e largimit nga puna, si dhe krijimin e detyrimeve të shtuara gjyqësore, duke evidentuar përgjegjësitë individuale, humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme për shoqërinë. **Rekomandimi nuk është realizuar.**

Nga Sektori i Financave, juristi i shoqërisë si dhe nga drejtuesit e shoqërisë të hartohen kriterë për dhënien me qira të aseteve të shoqërisë dhe të kualifikohen dhe pranohen ato kërkesa për marrje me qira, të cilat plotësojnë kushtet sipas legjislacionit në fuqi. U konstatua se Porti Detar Shëngjin sha i referohet Vëndimit të Këshillit të Ministrave nr 54., 05.02.2014 “ Për përcaktimin e kriterëve të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, emifiteoze apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar. **Rekomandimi është realizuar.**

11. Nga sektori i financës dhe juristi, të merren të gjitha masat e nevojshme për përfundimin e identifikimit dhe regjistrimit të aseteve në ZVRPP Lezhë dhe vënien në shfrytëzim të tyre për interesat e shoqërisë. Porti Detar Shëngjin sha i është drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 91/1 prot., datë 06.03.2018 bashkangjitur më të gjithë pronat e paluajtshme që i përkasin Portit Detar Shëngjin sha dhe ka nisur procesin e regjistrimit të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

aseteve në ZVRPP Lezhë, proces i cili nuk ka përfunduar. **Rekomandimi është në proces zbatimi**

12. Këshilli Mbikëqyrës dhe Titullari i shoqërisë “Porti Detar Shëngjin” SHA, të marrin masa që të rishqyrtojnë shpërblimin e dhënë për punonjësit e Shoqërisë për vitet 2014 dhe 2015 në vlerën e 3,420,000 lekë, shpërblime të dhëna para daljes së rezultatit financiar vjetor pozitiv, si dhe të evidentohen përgjegjësitë e të merret vendimi përkatës për vlerën e mësipërme, e cila përbën efekt financiar negativ për Buxhetin e shoqërisë.

Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Portit Shëngjin dhe Sektori i Financës, nuk janë marrë masa për rishqyrtimin e shpërblimit të dhënë për punonjësit e Shoqërisë për vitet 2014 dhe 2015 në vlerën e 3,420,000 lekë, shpërblime të dhëna para daljes së rezultatit financiar vjetor pozitiv, si dhe evidentimin e përgjegjësive e marrjen e vendimit përkatës për vlerën e mësipërme. **Rekomandimi nuk është zbatuar.**

13. Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Portit Shëngjin dhe Sektori i Financës, nuk janë marrë masa për rishqyrtimin e vlerës 20,000 euro, si dhe evidentimin e përgjegjësive e marrjen e vendimit përkatës për vlerën e mësipërme e cila përbën efekt negativ financiar për buxhetin e shoqërisë.

Nga Drejtori i Portit Detar Shëngjin sha dhe Sektori i Financës, janë marrë masa duke bërë kërkesë padi me nr. 199 prot., datë 30.05.2018 duke u drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës për kthimin e shumës 20.000 euro nga OE E. S., për këtë arsye rekomandimi do të konsiderohet në proces.

Rekomandimi është në proces

14. Këshilli Mbikëqyrës dhe Titullari i shoqërisë “Porti Detar Shëngjin” SHA, të marrin masa që të rishqyrtojnë vlerën prej 20,600 lekë, si dhe të evidentohen përgjegjësitë e të merret vendimi përkatës për vlerën e mësipërme, e cila përbën efekt financiar negativ për Buxhetin e shoqërisë.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, në lidhje me këtë rekomandim nuk konstatohet të jenë marrë masa për zbatimin e tij. **Rekomandimi nuk është zbatuar.**

15. Titullari i Portit Detar SHA Shëngjin, në vazhdimësi të trajtojë me kujdes rastet e emergjencës për të shmangur veprimet e sforcuara që sjellin shkelje të dispozitave ligjore.

Nga Titullari i Portit Detar Shëngjin sha janë marrë masat e nevojshme duke trajtuar me kujdes rastet e emergjencave ne Port duke shmangur veprimet e sforcuara që bien në kundërshtim me ligjet në fuqi. **Rekomandimi është zbatuar.**

16. Porti Detar Shëngjin, të marrë masat për zbatimin e plotë të rekomandimeve të perealizuara nga auditimi i mëparshëm i KLSH, me qëllim realizimin e plotë të masës shpërblim dëmi në shumën 343,224 lekë. Porti Shëngjin ka fituar 2 shkallët e gjyqësorit



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

(Shkallën e Parë Lezhë dhe Gjykata e Apelit Shkodër), por shoqëria G. SHPK e ka dërguar çështjen në rekurs pranë Gjykatës së Lartë. Edhe pse çështja ka vajtur në rekurs, nga Porti Shëngjin nuk janë marrë masa për ekzekutimin e Vendimit nr. 1406, datë 26.11.2014, të Gjykatës së Apelit Shkodër, vendim i cili është i formës përfundimtare. Porti Detar Shëngjin sha, i është drejtuar zyres përbarimore Lezhe për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Apelit Shkoder nr. 1406., datë 26.11.2014. U konstatua se nga ana e shoqërisë G. shpk është arkëtuar vlera prej 372,024 lekë në llogarinë e Portit Detar Shëngjin sha me datë 13.02.2020, në këtë vlerë janë të përfshira të gjithë shpenzimet, për këtë arsye rekomandimi i lënë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit do të konsiderohet i realizuar. **Rekomandimi është realizuar.**

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Titullari i Portit Detar SHA Shëngjin, të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për analizimin e përgjegjësive dhe përcaktimin e përfituesve të sasisë prej 18,300 litra karburant në tre vitet objekt auditimi, si dhe të kërkohet në rrugë administrative bazuar në Kodin e Procedurave Administrative, shpërblimi i dëmit në shumën 3,066,314 lekë, vlerë e cila është përdorur në formën e tollonave të karburantit.

Këshilli Mbikëqyrës me Vendimin nr. 6, datë 15.05.2017, nuk ka pranuar këtë rekomandim, duke e quajtur të rregullt procedurën e përdorur për furnizime me karburant për periudhën 2014, 2015 dhe 2016. **Rekomandimi nuk është pranuar.**

2. Porti Detar Shëngjin, të marrë masa, që t'i kërkojë kontraktorit "N." SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës 2,248,994 lekë, të cilën e ka përfituar tepër për punime të pakryera.

Porti Shëngjin me shkresën nr. 55/5, datë 11.04.2017, drejtuar OE N. SHPK për shlyerje të detyrimit në mënyrë vullnetare. Si dhe me anë të Kërkesë Padisë nr. 89, datë 24.05.2018 pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, ka kërkuar arkëtimin e vlerës 2,248,994 lekë. Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga subjekti çështja është në gjykim pranë kësaj gjykate edhe pritet të merret vendim. **Rekomandimi është në proces zbatimi.**

3. Porti Detar Shëngjin, të marrë masa, që t'i kërkojë kontraktorit "I." SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës 1,448,800 lekë, të cilën e ka përfituar tepër për punime të pakryera.

Porti Shëngjin me shkresën nr. 55, datë 11.04.2017, drejtuar OE I. SHPK, ka kërkuar arkëtimin e vlerës 1,448,800 lekë. Me kërkesë padinë nr. 126 prot., 04.04.2018 i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për shlyerjen e detyrimit. Me vendimin nr. 3743, datë 22.10.2018 Gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë nga ana e Portit Detar Shëngjin sha. Me datën 19.11.2018 është depozituar ankimimi pranë Gjykatës Administrative të Apelit për ndryshimin e vendimit dhe Porti Detar Shëngjin sha është në pritje të një vendimi nga ana e Gjykatës. **Rekomandimi është në proces.**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

4. Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 1,237,560 lekë, nga bashkimi i operatorëve ekonomik “D.” SHPK & “E.” SHPK, për shkeljet e konstatuara në zbatimin e kontratës me objekt “Sistemi CCTV në Portin e Shëngjinit, Faza I”, viti 2016.

Porti Shëngjin me shkresën nr. 55/3, datë 11.04.2017, drejtuar OE D. SHPK, ka kërkuar arkëtimin e vlerës 1,237,560 lekë. Në lidhje me këtë masë për shpërblim dëmi, është vazhduar kërkimi i dëmit në rrugë gjyqësore përmes kërkesë padisë nr. 125 prot., datë 04.04.2018 drejtuar Gjykatës Administrative së Shkallës së Parë Tiranë, me objekt kthimin e shumës 1,237,560 lekë të përfituar në mënyrë të padrejtë për punë të pakryera. Me vendimin nr. 3185., datë 17.09.2018 gjykata ka vendosur pranimin e pjesshëm të kërkesë padisë, duke vendosur kthimin e vleres prej 54,920 lekë. Është bërë ankimim pranë Gjykatës Administrative të Apelit për pranimin e plotë të kërkesë padisë me datë 17.10.2018, Porti Detar Shëngjin sha është në pritje të një vendimi nga ana e Gjykatës. **Rekomandimi është në proces.**

5. Këshilli Mbikëqyrës të shqyrtojë vlerën 798,720 lekë. Kjo vlerë ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit “Shtrimi i pjesës së mbetur të sipërfaqes së portit, faza 1”, vlerë e cila ka dalë si rezultat i diferencës së ofertës së shpallur fituese, operatori Ekonomik “I.” SHPK, me vlerë të ofertës 2,721,000 lekë pa TVSH, me ofertën e operatorit ekonomik “N.” SHPK, e cila është skualifikuar pa të drejt me vlerë 2,055,400 lekë pa TVSH.

Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse për vlerën 798,720 lekë, vlerë e cila për shoqërinë “Porti Detar Shëngjin” SHA përbën dëm ekonomik. Me kërkesën nr. 74/2 prot., datë 12.05.2017, drejtorja e Portit Detar Shëngjin sha i është drejtuar Këshilli Mbikëqyrës për vlersimin si të rregullt të procedurës në vlerën 798,720 lekë, e cila ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit “Shtrimi i pjesës së mbetur të sipërfaqes së portit, faza 1”, vlerë e cila ka dalë si rezultat i diferencës së ofertës së shpallur fituese, operatori Ekonomik “I.” SHPK, me vlerë të ofertës 2,721,000 lekë pa TVSH, me ofertën e operatorit ekonomik “N.” SHPK, e cila është skualifikuar pa të drejt me vlerë 2,055,400 lekë pa TVSH. Këshilli Mbikëqyrës me vendimin nr. 07., datë 15.05.2017, vendos “Të konsiderohet e drejtë dhe e bazuar në legjislacionin në fuqi për prokurimet publike, dhe që në çdo rast kjo procedurë është kryer për ti shërbyer vijueshmërisë dhe mbarëvajtjes së punës në këtë institucion”. Rekomandimi i lënë nga KLSH nuk është pranuar. **Rekomandimi nuk është pranuar.**

6. Drejtori i Portit Detar Shëngjin, të marrë masa, që t’i kërkojë anëtarëve të KVO-së, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës 732,420 lekë, si dëm ekonomik i shkaktuar.

Drejtori i shoqërisë ka marrë masa duke ngritur një komision për vlerësimin e dëmit të shkaktuar por nuk është ndjekur asnjë hap për arkëtimin e kësaj vlere. **Rekomandimi nuk është zbatuar.**

7. Porti Detar Shëngjin, të marrë masa, që t’i kërkojë kontraktorit “I.” SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës 505,300 lekë, të cilën e ka përfituar tepër për punime të pakryera.

Porti Shëngjin me shkresën nr. 55, datë 11.04.2017, drejtuar OE I. SHPK, ka kërkuar arkëtimin e vlerës 1,448,800 lekë. Me kërkesë padinë nr. 126 prot., 04.04.2018 i është drejtuar Gjykatës



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për shlyerjen e detyrimit. Me vendimin nr. 3743, datë 22.10.2018 Gjykata ka vendosur rrezimin e kërkesë padisë nga ana e Portit Detar Shëngjin sha. Me datën 19.11.2018 është depozituar ankimimi pranë Gjykatës Administrative të Apelit për ndryshimin e vendimit dhe Porti Detar Shëngjin sha është në pritje të një vendimi nga ana e Gjykatës. **Rekomandimi është në proces.**

8. Të merren masa nga Porti Detar Shëngjin, që t'i kërkojë kontraktorit "L. 2007" SHPK. duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës 230,792 lekë. Porti Shëngjin me shkresën nr. 55/4, datë 11.04.2017, drejtuar OE L. 2007 SHPK, ka kërkuar arkëtimin e vlerës 230,792 lekë. Në lidhje me këtë masë për shpërblim dëmi, me kërkesë padinë nr 113 prot., datë 03.04.2018 i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër me objekt detyrimin e shoqërisë të kthejë shumën prej 230,792 lekë, të përfituar në mënyrë të padrejtë për dorëzimin e mallit si pasojë e moszbatimit të kushteve të kontratës. Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër ka vendosur rrezimin e padisë. Porti Detar Shëngjin sha brënda afatit ligjor ka paraqitur ankimimin në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë. Rekomandimi është në proces pasi nuk ka një vendim të formës së prerë nga gjykata. **Rekomandimi është në proces.**

9. Titullari i shoqërisë të marrë masa për ngritjen e një grup pune për përcaktimin e përgjegjësive individuale për gjobat e paguara nga të ardhurat e Portit Detar SHA Shëngjin, si dhe të kërkohet në rrugë administrative arkëtimi i shumës 207,069 lekë, nga personat përgjegjës për shkaktimin e tij. Drejtori i shoqërisë nuk ka marrë masa për ngritjen e një grupi pune për përcaktimin e përgjegjësive individuale për gjobat e paguara nga të ardhurat e Portit Detar SHA Shëngjin, si dhe kërkimin në rrugë administrative arkëtimi i shumës 207,069 lekë, nga personat përgjegjës për shkaktimin e tij. **Rekomandimi nuk është zbatuar.**

10. Të merren masa nga Porti Detar Shëngjin, që t'i kërkojë kontraktorit "G." SHPK. duke ndjekur të gjitha procedurat administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës 104,160 lekë, të përfituar tepër në mënyrë të padrejtë. Porti Shëngjin me shkresën nr. 55/1, datë 11.04.2017, drejtuar OE G. SHPK, ka kërkuar arkëtimin e vlerës 104,160 lekë. Është bërë kërkesë padia me nr. 123 prot., 04.04.2018, "Detyrimin e shoqërisë "G." shpk, të kthejë shumën 104,160 lekë të përfituar në mënyrë të padrejtë". Me datën 09.07.2018 OE G. ka shlyer detyrimin ndaj Porti Detar Shëngjin sha në vlerën 104,160 lekë. Drejtori Portit Detar Shëngjin sha ka kërkuar heqje dorë nga kërkesë padia pasi OE ka shlyer detyrimin. **Rekomandimi është realizuar.**

11. Këshilli Mbikëqyrës të marrë masa për ngritjen e një grup pune për përcaktimin e përgjegjësive individuale, si dhe të kërkohet në rrugë administrative arkëtimi i shumës për vlerën 76,666 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për shoqërinë "Porti Detar Shëngjin" SHA. Këshilli Mbikëqyrës nuk ka marrë masa për ngritjen e një grupi pune për përcaktimin e përgjegjësive individuale, si dhe kërkimin në rrugë administrative arkëtimi i shumës për vlerën 76,666 lekë. Këshilli Mbikëqyrës me vendimin nr. 07., datë 15.05.2017 nuk ka pranuar këtë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

rekomandim, duke e quajtur të rregullt procedurën e përdorur. **Rekomandimi nuk është pranuar.**

12. Porti Detar Shëngjin, të marrë masa, që t'i kërkojë kontraktorit "T. A. L." SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës 30,000 lekë, të cilën e ka përfituar tepër për punime të pakryera.

Porti Shëngjin me shkresën nr. 55/2, datë 11.04.2017, drejtuar OE T. A. L. SHPK, ka kërkuar arkëtimin e vlerës 30,000 lekë. Në lidhje me këtë masë për shpërblim dëmi, ka vazhduar kërkimi i dëmit në rrugë gjyqësore përmes kërkesë padisë me datë 25.04.2018 ku Porti Detar Shëngjin sha ka kërkuar shlyerjen e detyrimit nga OE. Drejtori i Porti Detar Shëngjin sha ka kërkuar heqjen dorë nga kërkesë padia me datën 12.09.2018 pasi OE T. A. L. SHPK, ka shlyer detyrimin me datë 24.05.2018 në vlerën 30,000 lekë kundrejt Porti Detar Shëngjin sha.

Rekomandimi është zbatuar.

13. Drejtori i Portit Detar Shëngjin, të marrë masa, që t'i kërkojë personave përgjegjës, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës 2,787 lekë, si dëm ekonomik i shkaktuar nga moskryerja e pagesave të shërbimit telefonik.

Drejtori i shoqërisë nuk ka marrë masa për ti kërkuar personave përgjegjës, arkëtimin e shumës 2,787 lekë, si dëm ekonomik i shkaktuar nga moskryerja e pagesave të shërbimit telefonik. **Rekomandimi nuk është zbatuar.**

C.1. TË ARDHURA TË MUNGUARA, NGA DETYRIME KONTRAKTUALE.

- I. Titullari i shoqërisë, sektori i financës si dhe juristi të ndjekin të gjitha procedurat e nevojshme administrative si dhe të kërkohej në rrugë ligjore, arkëtimi i vlerës prej 9,831,854 lekë nga ngarkim shkarkimi, 14,889 euro dhe 255 USD nga tarifrat portuale si dhe shumën 711,011 lekë e mbartur, nga debitorët deri në sekuestro të pasurive të tyre. Gjithashtu në të ardhmen të kryhet sistemimi i vlerës në pasqyrat financiare në klasat përkatëse të llogarive për të reduktuar barrën tatimore të vitit fiskal. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, në lidhje me këtë rekomandime u konstatua se janë marrë masa për zbatimin e tij. Nga zyra e financës është nxjerr gjëndja e detyrimeve debitore sipas agjensive dhe firmave me datë 31.12.2016. Nga ana e Portit Detar Shëngjin sha, janë marrë masa për arkëtimin e detyrimeve nga kompania "R. 2002" me datë 17.09.2019 dhe nga ana e kompanisë ka nisur likuidimet për detyrimet që ka ndaj Portit Detar Shëngjin sha. Për agjensinë Kadeli, Porti Detar Shëngjin sha i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë me kërkesë padinë nr.193/1 prot., datë 27.06.2018, kthimin e shumës prej 1,647,086 që rrjedh nga dy kontrata shërbimesh të lidhura ndërmjet palëve. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton që është marrë vendim në favor të Portit Detar Shëngjin sha. Nga pala e paditur është bërë ankimim në Gjykatën e Apelit Shkodër. **Rekomandimi është në proces.**



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

2. Titullari i shoqërisë, sektori i financës si dhe juristi të ndjekin të gjitha procedurat e nevojshme administrative si dhe të kërkohet në rrugë ligjore, arkëtimi i vlerës 858,000 lekë, nga qiramarrësit debitorë. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, në lidhje me këtë rekomandim konstatohet të jenë marrë masa për zbatimin e tij. Nga ana e agjensisë “V. I.” është arkëtuar detyrimi për ambjent me qira në vlerën 24,000 lekë, dhe nga ana e “C. A.” është arkëtuar detyrimi për ambjent me qira në vlerën 72,000 lekë. Për detyrimin prej 750.000 lekë rezulton që janë debitorë kompanitë “V. I. P.” me vlerë 120,000 lekë, “C.” A. 270,000 lekë, “B. A.” Albania me vlerë 240,000, “R. 2002” 120,000. Nga Porti Detar Shëngjin sha është bërë kërkesë padi me nr.369 prot., date 04.12.2018 drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë me objekt detyrimin e shoqërisë “C. A.” sh.p.k të kthejë shumën 270 000 lekë, për shkaktim dëmi jashtë kontraktor. Me vendimin nr. 194, Date 25.03.2019 Gjykata ka vendosur rrezimin e padise. Porti Detar Shëngjin sha brënda afatit ligjor ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Shkoder, çështja është në pritje të fillimit të procesit gjyqësor. Porti Detar Shëngjin sha me kërkesë-padinë me nr.370 prot., datë 04.12.2018 i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë me objekt detyrimin e shoqërisë “B. A.” sh.p.k të kthejë shumën 240,000 lekë, për shkaktim dëmi jashtë kontraktor, çështja është proces gjyqësor. Porti Detar Shëngjin sha i është drejtuar me kërkesë padinë nr.371 prot., datë 04.12.2018 jemi drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë me objekt detyrimin e shoqërisë “R. 2002” sh.a të kthejë shumën 120,000 lekë, për shkaktim dëmi jashtë kontraktor, çështja është në proces gjyqësor. Për kompanitë “V. I. P.” me detyrimin 120,000 lekë nuk u paraqit ndonjë dokument të vertetojë marrjen e masave për arkëtimin e vlerës së sipercituar, për këtë arsye për këtë kompani rekomandimi do të konsiderohet i pazbatuar dhe rekomandimi në tërësi do të konsiderohet që është në proces. **Rekomandimi është në proces.**

3. Titullari i shoqërisë, sektori i financës si dhe juristi të ndjekin të gjitha procedurat e nevojshme administrative si dhe të kërkohet në rrugë ligjore, arkëtimi i vlerës 3,850 euro, nga qiramarrësit debitorë. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, në lidhje me këtë rekomandim u konstatua se janë marrë masa për zbatimin e tij, të gjithë operatorët kanë shlyer detyrimin dhe i vetmi operator që nuk ka shlyer detyrimin është “R.” në vlerën 2.700 euro. **Rekomandimi është zbatuar pjesërisht**

C2. MASA PËR PËRDORIMIN PA EFEKTIVITET TË FONDEVE.

1. Autoriteti Kontraktor, SHA “Porti Detar” Shëngjin, të bëjë një analizë të kujdesshme të vlerave dhe të çdo kriteri të vendosur, në mënyrë që të garantojë cilësinë e mallrave dhe shërbimeve të ofruar nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Nga ana e Portit Detar Shëngjin sha, ka nisur trajtimin me kujdes i vlerave dhe kriterëve të vendosura për mallrat dhe shërbimet që kërkojnë, në mënyrë garantimin e cilësisë së mallrave. **Rekomandimi është zbatuar.**

2. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në vazhdimësi, të realizojë procesin e vlerësimit të ofertave të operatorëve ekonomike, duke gjykuar me korrektësi mbi plotësimin e kushteve të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR SHËNGJIN SHA

përgjithshme dhe të veçanta të kualifikim/s'kualifikimit të dekomencionit tekniko-ligjorë të dokumenteve të tenderit në menyrë që të garantojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik dhe të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Nga ana e Portit Detar Shëngjin sha, janë marrë masa që në vazhdimësi Komisioni i Vlersimit të Ofertave të realizojë procesin e vlerësimit të ofertave të OE duke gjykuar me korrektësi mbi plotësimin e kushteve të kërkuara. **Rekomandimi është zbatuar.**

3. Porti Detar SHA Shëngjin, të marrë masa që në vazhdimësi t'i kushtojë vëmendje maksimale:
- Përcaktimit të fondit limit për blerjet me vlera të vogla, si një nga parakushtet për dhënien e sigurisë së arsyeshme për përdorimin me economicitet, efektivitet dhe efikasitet të fondeve, duke argumentuar dhe dokumentuar vlerat e përcaktuara, në përputhje me udhëzimet për procedurat me vlera të vogla.
 - Marrjes në dorëzim të mallrave të prokuruar, si një dokument dhe një veprim vërtetues se këto procedura kanë përfunduar me sukses, dhe se mallrat e përfituara janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se nga Porti Detar Shëngjin sha është përcaktuar fondi limit për blerjet e vogla dhe janë ngritur komisione për marrjen në dorëzim të mallrave të prokuruar dhe komisioni mbanë dokumentacionin përkatës për mallrat e prokuruar që janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. **Rekomandimi është zbatuar.**

1. Titullari i Portit Detar, Shëngjin, nisur nga problematikat e shpeshta të hasura në procedurat e blerjeve me vlera të vogla, të marrë masa për trajnimin e stafit që angazhohet në njësi prokurimi apo komisione të vlerësimit të ofertave, me qëllim përmirësimin profesional të tyre në fushën e prokurimeve, duke përfituar kështu procedura të sakta, transparente dhe në përputhje me ligjin dhe rregullat për prokurimet publike. Nga ana e Portit Detar Shëngjin sha nuk janë kryer trajnime për stafin që angazhohet në njësi të prokurimeve. **Rekomandimi nuk është zbatuar.**

D. MASA DISIPLINORE.

I. Bazuar e në referim të nenit nr. 37 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me Ligjin Nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, Drejtori i Portit Detar SHA. Shëngjin të analizojë përgjegjësinë dhe t'i propozojë Këshillit Mbikëqyrës masën disiplinore nga "Vërejtje me paralajmërim" deri në "Zgjidhje të Kontratës së punës", sipas shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit për:

1. z. B. V., me detyrë Zv/Drejtor, sepse:

II. Bazuar e në referim të nenit nr. 37 të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, miratuar me Ligjin Nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, si dhe kontratës kolektive të punës nr. 6 datë 18.05.2016 neni 15, Drejtori i Portit Detar Shëngjin të analizojë përgjegjësinë dhe të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore nga "Vërejtje" deri në "Zgjidhje të kontratës së punës", sipas shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit për:



KONTROLI I LARTË I SHITETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

1. z. A. P., me detyrë Përgjegjës ofiçine.
2. znj. T. N., me detyrë Përgjegjëse e zyrës së prokurimeve.
3. z. E. D., me detyrë Përgjegjës i zyrës së marketingut.
4. z. E. Ç. me detyrë përgjegjëse administrate.
5. z. F. K. me detyrë përgjegjëse i Degës teknik.
6. znj. M. M., me detyrë Juriste.
7. z. L. Gj., me detyrë Përgjegjës i degës së ngarkim shkarkimit.
8. z. F. Gj., me detyrë Punonjës i emergjencës civile.

-Në mbledhjen e datës 02.05.2017, Këshilli Mbikqyrës ka vendosur dhënien e masës disiplinore “Vërejtje me paralajmërim” sipas shkeljeve të konstatuara, si dhe zbatimin e këtij vendimi nga Drejtori i Portit për personat e atakuar nga Raporti Përfundimtar i Auditimit. Me urdhërin nr. 18/1, datë 02.05.2017, Drejtori i Portit urdhëroj dhënien e masës disiplinore “Vërejtje me paralajmërim”, për 8 persona. Për z. B. V. nuk është dhënë masa disiplinore pasi personi në fjalë i ka nderprerë marrëdhëniet e punës me Porti Detar Shëngjin sha.
Rekomandimi është zbatuar.

Aneks 2

2. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese (Këshilli/ Bordi Mbikëqyrës dhe Drejtoria), vendimet e marra dhe zbatimi i tyre.

Këshilli Mbikqyrës përbëhet nga 3 anëtarë dhe përkatësisht M. Dh., V. C. dhe L. S..

Për vitin 2017, Këshilli Mbikqyrës i “Porti Detar Shëngjin” sha ka qënë i përbërë nga 3 anëtarë dhe përkatësisht M. Dh., E. A. dhe O. M..

Për vitin 2018, Këshilli Mbikqyrës i “Porti Detar Shëngjin” sha ka qënë i përbërë nga 3 anëtarë dhe përkatësisht M. Dh., E. A. dhe O. M.. Këshilli Mbikëqyrës ka ndryshuar njërin nga anëtarët më konkretisht duke liruar znj. O. M. nga detyra dhe duke emeruar z. G. Ll. (përfaqësues i MIE) me urdhërin e ministrit nr. 13510/1 prot., datë 04.10.2017. Këshilli Mbikëqyrës ka ndryshuar njërin nga anëtarët më konkretisht duke liruar z. E. A. nga detyra dhe duke emeruar z. A. Ll. (përfaqësues i MFE) me urdhërin e ministrit nr. 14792 prot., datë 24.10.2017.

Për vitin 2018, Këshilli Mbikqyrës i “Porti Detar Shëngjin” sha ka qënë i përbërë nga 3 anëtarë dhe përkatësisht M. Dh., G. Ll. dhe A. Ll.. Këshilli Mbikëqyrës ka ndryshuar njërin nga anëtarët më konkretisht duke liruar z. G. Ll. nga detyra dhe duke emeruar znj. L. S. (përfaqësues i MIE) me urdhërin e ministrit nr. 18466/1 prot., datë 23.01.2018.

Për vitin 2019, Këshilli Mbikqyrës i “Porti Detar Shëngjin” sha ka qënë i përbërë nga 3 anëtarë dhe përkatësisht M. Dh., L. S. dhe A. Ll.. Këshilli Mbikëqyrës ka ndryshuar njërin nga anëtarët më konkretisht duke liruar z. A. Ll. nga detyra dhe duke emeruar znj. V. Sh. (C.) (përfaqësues i MFE) me urdhërin e ministrit nr. 7457 prot., datë 24.04.2019.

Mbi vendimet e Këshillit Mbikqyrës për vitin 2017:

Këshilli Mbikqyrës i Porti Detar Shëngjin SHA është mbledhur 4 herë gjatë vitit 2017.

Në mbledhjen e datës 11.01.2017 janë marrë vendimet si më poshtë vijon:

-Vendimi nr.1, datë 11.01.2017 “Miratimin e regjistrimit të parashikimeve të prokurimit public për vitin 2017, sipas propozimit të paraqitur”;



KONTROLI I LARTË I SHITETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

- Vendimi nr.2, datë 11.01.2017 “Emërimin e z. L. G. në detyrën, zv/Drejtor i Porti Detar Shëngjin sh.a”;
 - Vendimi nr.3, datë 11.01.2017 “Të miratojë strukturën organizative të shoqërisë për vitin 2017, sipas propozimit të paraqitur”;
 - Në mbledhjen e datës 15.05.2017 janë marrë vendimet si më poshtë vijon:
 - Vendimi nr.4, datë 15.05.2017 “Emërimin e z. E. S., në detyrën, zv/Drejtor I Porti Detar Shëngjin sh.a;
 - Vendimi nr.5, datë 15.05.2017 “Të vlerësojë të rregullt procedurën e përdorur për furnizime me karburant për periudhën 2014, 2015 dhe 2016.”
 - Vendimi nr.6, datë 15.05.2017 “Paga baze minimale, mujore, për punonjësit të jetë 24.000 lekë.”
 - Vendimi nr.7, datë 15.05.2017 “Të konsiderohet e drejtë dhe e bazuar në legjislacionin në fuqi për prokurimet publike, dhe që në çdo rast kjo procedurë është kryer për ti sherbyer vijueshmërisë dhe mbarëvajtjes së punës në këtë institucion.”
 - Në mbledhjen e datës 06.07.2017 janë marrë vendimet si më poshtë vijon:
 - Vendimi nr. 9, datë 06.07.2017 “Të miratojë bilancin e vitit 2016.”
 - Në mbledhjen e datës 15.12.2017 janë marrë vendimet si më poshtë vijon:
 - Vendimi nr. 10, datë 15.12.2017 “Të miratojë projekt programin e zhvillimit ekonomik të shoqërisë për vitin 2018.”
 - Vendimi nr. 11, datë 15.12.2017 “Të miratojë propozimin për rritjen e disa tarifave në Porti Detar Shëngjin sha për vitin 2018 sipas manualit të tarifave portuale të Porti Detar Shëngjin sha.”
 - Vendimi nr. 12, datë 15.12.2017 “Të miratojë regjistrin e parashikimeve të prokurimit public për vitin 2018.”
 - Vendimi nr. 13, datë 15.12.2017 “Të miratojë lidhjen e kontratës së punës ndërmjet administratorit të shoqërisë dhe Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë së Porti Detar Shëngjin sha, për një periudhë 3 vjeçare.”
- Mbi vendimet e Këshillit Mbikëqyrës për vitin 2018:**
- Këshilli Mbikëqyrës i Albcontrol SHA është mbledhur 5 herë gjatë vitit 2018.
- Në mbledhjen e datës 09.02.2018 janë marrë vendimet si më poshtë vijon:
- Vendimi nr. 1, datë 09.02.2018 “Të miratojë strukturën organizative të shoqërisë për vitin 2018, sipas propozimit të paraqitur, me numër total 157 punonjës.”;
- Vendimi nr. 2, datë 09.02.2018 “Të miratojë rregulloren e brendshme të shoqërisë për vitin 2018, sipas propozimit të paraqitur”;
- Vendimi nr.3, datë 09.02.2018 “Të miratojë rishikimin e nivelit të pagave në bazë të ligjit 10405/24, datë 24.03.2011, për kompetencat për përcaktimin e pagave dhe të shpërblimeve.”;
- Në mbledhjen e datës 11.05.2018 janë marrë vendimet si më poshtë vijon:
- Vendimi nr.4, datë 11.05.2018 “Të miratojë kontabilizimin e aktit të kontrollit për uljen e gjendjes kreditore të TVSH-së”;
- Vendimi nr.5, datë 11.05.2018 “Të miratojë propozimin nga drejtoria e Portit Detar Shëngjin sham bi transferimin capital të vinçit ”.
- Në mbledhjen e datës 25.06.2018 janë marrë vendimet si më poshtë vijon:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

Vendimi nr.6, datë 25.06.2018 “ Të miratoj në aplikimin për garanci bankare pranë bankës Raiffeisen në shumën deri në 19,000,000 lekë dhe për tu lëshuar në favor të Drejtoria Rajonale e Tatimeve Lezhe”;

Vendimi nr.7, datë 25.06.2018 “Miratimin e bilancit të vitit 2017 sipas treguesve”;

Në mbledhjen e datës 28.09.2018 janë marrë vendimet si më poshtë vijon:

Vendimi nr.8, datë 28.09.2018 “Miratimin e strukture aktuale dhe nivelin e pagave”;

Në mbledhjen e datës 12.12.2018 janë marrë vendimet si më poshtë vijon:

Vendimi nr.9, datë 12.12.2018 “Të miratojë projekt programin e zhvillimit ekonomik të shoqërisë për vitin 2019”.

Vendimi nr.10, datë 12.12.2018 “Të miratojë propozimin për miratimin e “Librin e Tarifave Portuale” për vitin 2019 të Porti Detar Shengjin sha sipas manualit të tarifave”;

Mbi vendimet e Këshillit Mbikqyrës për vitin 2019:

Këshilli Mbikqyrës i Porti Detar Shengjin sha është mbledhur 4 herë gjatë vitit 2019.

Në mbledhjen e datës 07.01.2019 janë marrë vendimet si më poshtë vijon:

Vendimi nr.1, datë 07.01.2019 “Të miratojë regjistrin e parashikimeve të prokurimit public për vitin 2019, sipas propozimit të paraqitur”;

Vendimi nr.2, datë 07.01.2019 “Paga bazë minimale mujore, për punonjësit, të jetë 26,000 lekë.”

Vendimi nr.3, datë 07.01.2019 “Të miratojë znj. S. F. sekretare të Këshillit Mbikqyrës së Portit Detar Shëngjin sha”;

Në mbledhjen e datës 17.06.2019 janë marrë vendimet si më poshtë vijon:

Vendimi nr.4, datë 17.06.2019 “Të miratojë znj. E. C. sekretare të Këshillit Mbikqyrës së Portit Detar Shëngjin sha”;

Vendimi nr.5, datë 17.06.2019 “Të miratojë bilancin e vitit 2018”;

Në mbledhjen e datës 18.09.2019 është marrë vendimi si më poshtë vijon:

Vendimi nr.6, datë 18.09.2019 “Të miratojë lidhjen e kontrates së punës ndërmjet Administratorit të shoqërisë dhe Këshillit Mbikqyrës të shoqërisë së Porti Detar Shëngjin sha, për një periudhë 3 vjeçare.”

Në mbledhjen e datës 02.12.2019 është marrë vendimi si më poshtë vijon:

Vendimi nr.7, datë 02.12.2019 “Të miratojë rishikimin e nivelit të pagave në bazë të ligjit 10405/24, datë 24.03.2011 për kompetencat për përcaktimin e pagave dhe shpërblimeve”.

Mbi vendimet e Drejtorisë:

Për vitin 2017, me urdhërin e ministrit nr. 16467 prot., datë 15.11.2017 është emëruar z. E. P., në detyrën e Administratorit të shoqërisë “Porti Detar Shëngjin sha”.

Për vitin 2019, me urdhërin e ministrit nr. 15135/2 prot., datë 11.09.2019 është emëruar z. Gj. P., në detyrën e Administratorit të shoqërisë “Porti Detar Shëngjin sha”.

Për vitin 2017 janë nxjerrë rreth 100 urdhra mbi drejtimin e Porti Detar Shëngjin SHA, veprimtarinë operacionale dhe funksionale. Për vitin 2018 janë nxjerrë rreth 107 urdhra mbi drejtimin e Porti Detar Shëngjin SHA, veprimtarinë operacionale dhe funksionale dhe për vitin 2019 janë nxjerrë rreth 72 urdhra mbi drejtimin e Porti Detar Shëngjin SHA, veprimtarinë operacionale dhe funksionale.

-Nga auditimi i urdhërave të nxjerra nga Administratori i Porti Detar Shëngjin sha u konstatua se për vitet 2017, 2018 dhe 2019 ka pasur levizje të brëndshme të personelit brënda strukture



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

së miratuar por u konstatua se levizjet e punonjësve janë kryer pa analizuar kualifikimin e punonjësve nëse janë të përshtatshëm për pozicionet e punës ku janë emëruar.

Aneks 3

3. Auditim mbi hartimin, shqyrtimin dhe miratimin e planit të biznesit nga organet drejtuese të Portit Detar, Këshilli Drejtues dhe Ministria Infrastrukturës dhe Energjisë.

Projekt programet ekonomiko-financiare për vitet 2017, 2018 dhe 2019 janë hartuar mbi bazën e realizimit të treguesve të vitit paraardhës dhe realizimit të pritshme të vitit aktual, për vitin pasardhës që programohet. Projekt programi i çdo viti është hartuar nga Drejtoria e shoqërisë dhe pasi është miratuar nga këshilli mbikëqyrës është paraqitur për mendim në MIE dhe përfundimisht për miratim nga MFE, sipas procedurave dhe afateve të përcaktuara në Udhëzimin e METE nr. 394 datë 21.08.2014 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital tërësisht shtetëror” i ndryshuar me “Udhëzimin e METE nr. 15, datë 02.05.2018 “Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital tërësisht shtetëror”, si dhe në ligjin 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Programi i paraqitur nga shoqëria me shkresën nr. 126/1 datë 25.11.2016, shoqëruar me mendimin e METE, dhe vendimin e këshillit mbikëqyrës nr. 05 datë 26.01.2017, M.Ekonomisë me shkresën nr. 4309/1 datë 05.05.2017 ka miratuar programin e zhvillimit ekonomik të shoqërisë për vitin 2017.

Për hartimin e programit ekonomik për vitin 2017, SHA “Porti Detar Shëngjin”, është mbështetur në:

- Analizën e treguesve ekonomiko financiar të realizuar nga shoqëria për vitin 2016,
- Në objektivat që janë caktuar për vitin 2017-2018,
- Në koordinimin e aktiviteteve tregtare brenda territorit të portit, ndërtimin, menaxhimin, ruajtjen e objekteve dhe magazinimin e mallrave për llogari të veprimtarisë së shoqërisë.
- Në analizën për përmirësimin e rritjen e performancës, analizën e vlerësimit të riskut të investimeve, në qëndrueshmërinë dhe rentabilitetin të cilët përcaktojnë kapacitetin e shoqërisë.
- Në bashkëpunimin e ngushtë me bankat, me klientët tradicionalë si dhe me klientë të tjerë që mendohet të operojnë në port.
- Në politikat e ndjekura për zhvillimin e biznesit dhe turizmit në rajonin e veriut.

Treguesit kryesor ekonomik dhe financiar të programuar dhe të realizuar për vitin 2017, janë pasqyruar në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr. 1 Programi dhe realizimi i treguesve ekonomik dhe financiar për 2017

Nr	Emërtimi	Programi	Realizimi	Në mijë lekë
				Realizimi në %
1.	Të ardhura gjithsej	145,500	102,297	70%
2.	Shpenzime gjithsej	144,200	142,186	98%
	Nga këto: Telefon celular	0.000	0.00	00%
3.	Fitimi bruto	1,300	-39,889	
4.	Tatim Fitimi	0,350	00	



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

5.	Fitimi neto	18,60	00	
6.	Investime	1,358,754	00	
7.	Numri i punonjësve (nr)	146	147	100.7%
8.	Paga mesatare mujore (lekë)	35,388	33,502	95%
9.	Fondi i Pagave	62,000	59,100	95%

Burimi: Dokumente të SHA Porti Detar Shëngjin dhe përlllogaritje të grupit të auditimit të KLSH

-Në programimin e të ardhurave, shoqëria ka parashikuar si volum pune ngarkim-shkarkimi prej 290,000 ton me një tarifë 502 lekë/toni, që do të sjellë të ardhura 145,500 mijë lekë, ose 52% e të ardhurave gjithsej, janë parashikuar të ardhura nga zënia e kalatës, aktivitet trageti, të ardhura nga qiratë, etj.

Parë në tërësi konstatohet se shoqëria rezulton me humbje për vitin 2017 në vlerë 39,889 mijë lekë, nga 1,3 milionë lekë, programuar me fitim, si pasojë e mosrealizimit të disa treguesve krahasuar me programin si:

-Volumi i ngarkim shkarkimit në më pak të ardhura prej 14,179 mijë lekë.

-Mosrealizimi i të ardhurave nga zënia e kalatës prej 1,321 mijë lekë.

-Përpunimi i trageteve prej 19,846 mijë lekë.

-Qiradhënia prej 80,000 lekë.

Realizimi i të ardhurave është në masën 70%, ç'ka flet për një programim jo të saktë dhe mbi baza reale referuar kapaciteteve për realizimin e tyre si edhe punë e pamjaftueshme nga strukturat drejtuese të shoqërisë.

-Programimi i shpenzimeve, është bazuar në nivelin e realizimit të vitit 2016, duke reflektuar rritje të nivelit të pagave në masën 10%. Shpenzimet janë realizuar në masën 98%.

Investimet janë parashikuar të realizohen kryesisht me fondet e buxhetit të shtetit në shumën 1,358,754 mijë lekë, ku peshën kryesore e zë "Vazhdimi i ndërtimit të kalatës lindore", po kështu është parashikuar financimi i punimeve për financimin e punimeve për "Thellimin e basenit të portit faza V", pasi pa këtë financim Kalata e re e ndërtuar nga fondet e BE nuk mund të vihet në punë. Nga porti Detar Shëngjin nuk është realizuar asnjë nga investimet e parashikuara, realizimi i investimeve është 0 nga 19 investime të parashikuara.

-Realizimi i të ardhurave sipas burimeve të krijimit, për vitin 2017 paraqitet në vijim.

Tabela nr. 2 Programi dhe realizimi i të ardhurave për vitin 2017

Në mijë lekë

Nr	Treguesit	Programi	Realizimi	%
1	Të ardhura gjithsej	145,500	102,297	70
a	Nga përpunimi i anijeve	76,000	61,858	81
b	Të tjera	25,800	6,423	25
c	Rimarrje amortizimi	43,700	34,016	78

Burimi: Dokumente të SHA Porti Detar Shëngjin dhe përlllogaritje të grupit të auditimit të KLSH

Siç vërehet nga tabela e mësipërme, gjatë vitit 2017 në veçanti nuk janë realizuar të ardhurat nga përpunimi i anijeve, kjo për shkak të rënies së aktivitetit në sektorin e ndërtimit dhe rritjes së prodhimit vendas. Rritja e të ardhurave nga zëra të tjerë, jo vetëm që shfaq mangësitë e programimit, por në të njëjtën kohë shfaq prirjen për sigurimin e të ardhurave jashtë aktivitetit kryesor të shoqërisë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

Në përpunimin e mallrave për vitin 2017, në portin e Shëngjinit është realizuar vëllimi i përpunimit në 248,330 ton kundrejt 290,000 ton të programuar, ose 15% më pak nga parashikimi. Zërin kryesor në përpunimin e mallrave e zë përpunimi i klinker, i cili për portin e Shëngjinit është realizuar 190,773 ton.

-Shpenzimet administrative gjithsej janë realizuar 69,279 mijë lekë, nga 72,000 mijë lekë të programuara ose 96%. Në mënyrë analitike shpenzimet paraqiten në tabelën në vijim:

Tabela nr. 3 Programi dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2017

Në mijë lekë

Nr	Treguesit Ekonomikë	Viti 2017		
		Programi	Realizimi	%
I	Shpenzime administrative	72,000	69,279	96%
1	- Pagat	62,000	59,097	95%
2	- Sigurimet shoqërore	10,000	10,171	101%
3	- Shpërblime, personel i jashtëm/dëmshpërbl.	5,800	6,002	103%
4	- Shteti Tatim Taksa	700	560	80%
II	Furnitura	4,000	2,518	62%
1	- Energji elektrike			
2	-Udhëtime dieta			
III	Shpenzime blerje (Mallra)	3,000	1,930	64%
1	- Karburant			
2	- Vajra			
3	- Goma			
4	- Pjesë Këmbimi			
IV	Shpenzime për zhvlerësimin e aktiveve			

Burimi: Dokumente të SHA Porti Detar Shëngjin dhe përlogaritje të grupit të auditimit të KLSH

Duke analizuar shpenzimet administrative vërehet se megjithëse ato nuk janë realizuar, janë tejkualuar shpenzimet për sigurimet shoqërore me 171 mijë lekë, ndonëse nuk zënë një përqindje të konsiderueshme në këtë zë shpenzimesh. Po kështu, është tejkualuar në shpenzime zëri “Personel i jashtëm/dëmshpërblime” i cili është realizuar për 600 mijë lekë.

Ndërsa mosrealizimi i detyrimeve fiskale për tatime taksa prej 140 mijë lekë, duhet parë si element i mangësive në programim, dhe nuk duhet konsideruar si kursim i shpenzimeve. Në këtë këndvështrim duhen parë edhe mosrealizimet e theksuara ose tejkualimet e ndjeshme në zëra të veçantë (siç është trajtim personeli-përmbaues për fitim në proces gjyqësor),duke kompromentuar marrjen në konsideratë të realizimeve të mëparshme apo ecurinë e shoqërisë.

Për vitin 2018, Projekt programi ekonomik pasi është përgatitur nga shoqëria me shkresën nr. 182 prot., datë 25.11.2017, shoqëruar me mendimin e MPPT, me shkresën nr.195/1, datë 16.02.2018, dërguar MEI “Projekt Programi i zhvillimit ekonomik” dhe vendimin e këshillit mbikëqyrës nr. 10 datë 15.12.2017, MFE me shkresën nr. 3547/1 Prot. datë 19.03.2018, ka miratuar programin e zhvillimit ekonomik të shoqërisë për vitin 2018 si vijon:

Tabela nr. 1 Programi dhe realizimi i treguesve ekonomik dhe financiar për vitin 2018

Në mijë lekë

Nr	Emërtimi	Programi	Realizimi	%
----	----------	----------	-----------	---



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

1.	Të ardhura gjithsej	121,000	97,509	80
2.	Shpenzime gjithsej	117,500	130,180	111
3.	Fitimi bruto	3,5	-32,671	
4.	Tatim Fitimi	0,53	0	
5.	Fitimi neto	2,97	0	
6.	Investime gjithsej (Mln/l)	1,183	0,114	9.6
7.	Numri i punonjësve (numër)	150	149	99
8.	Paga mesatare mujore (lekë)	34,247	31,946	93
9.	Fondi i Pagave	60,000	57,676	96

Burimi: Dokumente të SHA Porti Detar Shëngjin dhe përlllogaritje të grupit të auditimit të KLSH

-Në programimin e të ardhurave, shoqëria ka parashikuar si volum pune ngarkim-shkarkimi prej 280,000 ton me një tarifë 363 lekë/toni, që do të sjellë të ardhura 101,640 mijë lekë, ose 65% e të ardhurave gjithsej, janë parashikuar të ardhura nga zënia e kalatës, aktivitetet trageti, të ardhura nga qiratë, etj.

Parë në tërësi konstatohet se shoqëria rezulton me humbje në për vitin 2018 në vlerë 32,671 mijë lekë, nga 3 milionë lekë, programuar me fitim, si pasojë e mosrealizimit të disa treguesve krahasuar me programin si:

-Volumi i ngarkim shkarkimit në më pak të ardhura prej 30,130 mijë lekë, si pasojë e mosrealizimit të volumit të punës prej 79,179 ton.

-Mosrealizimi i të ardhurave nga zënia e kalatës prej 1,030 mijë lekë.

-Përpunimi i trageteve prej 19,846 mijë lekë.

Realizimi i të ardhurave është në masën 80%, flet për një programim jo të saktë dhe mbi baza reale referuar kapaciteteve për realizimin e tyre dhe punë e pamjaftueshme nga strukturat drejtuese të shoqërisë.

Referuar realizimit të volumit të punës për vitin 2017, ku realizimi i volumit të punës është 248,330 ton, nga strukturat drejtuese të portit programimi i volumit të punës prej 280,000 ton është parashikim euforik dhe i parealizueshëm në kushtet ku në vitin 2017, nuk u realizuan investimet e parashikuara për përmirësimin e kushteve të punës në Port si edhe nuk janë paraqitur politika të studiuara marketingu për rritjen e volumit të punës, etj.

-Programimi i shpenzimeve, është bazuar në nivelin e realizimit të vitit 2017, Shpenzimet janë realizuar në masën 111 %, ose me tejkalim prej 11%, ku ka ndikuar tejkalimi i shpenzimeve në zërin “Amortizim”.

Investimet janë parashikuar të realizohen kryesisht me fondet e buxhetit të shtetit në shumën 1,145,845 mijë lekë, ku peshën kryesore e zë “Vazhdimi i ndërtimit të kalatës lindore”, po kështu është parashikuar financimi i punimeve për financimin e punimeve për “Thellimin e basenit të portit faza V”, pasi pa këtë financim Kalata e re e ndërtuar nga fondet e BE nuk mund të vihet në punë. Nga porti Detar Shëngjin nuk është realizuar asnjë nga investimet e parashikuara, realizimi i investimeve është 0.

Realizimi i të ardhurave sipas burimeve të krijimit, për vitin 2018 paraqitet në vijim.

Tabela nr. 2 Programi dhe realizimi i të ardhurave për vitin 2018

Në mijë lekë

Nr	Treguesit	Programi	Realizimi	%
1	Të ardhura gjithsej	121,000	97,509	80



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

a	Nga përpunimi i anijeve	79,000	56,310	71
b	Të tjera	16,000	8,711	54
c	Rimarrje amortizimi	26,000	32.488	125

Burimi: Dokumente të SHA Porti Detar Shëngjin dhe përllogaritje të grupit të auditimit të KLSH

Siç vërehet nga tabela e mësipërme, gjatë vitit 2018 në veçanti nuk janë realizuar të ardhurat nga përpunimi i anijeve, kjo për shkak të rënies së aktivitetit në sektorin e ndërtimit dhe rritjes së prodhimit vendas. Rritja e konsiderueshme e të ardhurave nga zëra të tjerë, jo vetëm që shfaq mangësitë e programimit, por në të njëjtën kohë shfaq prirjen për sigurimin e të ardhurave jashtë aktivitetit kryesor të shoqërisë, duke shkaktuar paqëndrueshmëri financiare afatgjatë.

Në përpunimin e mallrave për vitin 2018, në portin e Shëngjinit është realizuar vëllimi i përpunimit në 200,826 ton kundrejt 280,000 ton të programuar, ose 28% më pak nga parashikimi. Zërin kryesor në përpunimin e mallrave e zë përpunimi i klinker, i cili për portin e Shëngjinit është realizuar 160,685 ton.

Tabela nr. 3 Programi dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2018

Në mijë lekë

Nr	Treguesit Ekonomikë	Viti 2018		
		Programi	Realizimi	%
I	Shpenzime administrative	85,500	76,600	89
1	- Pagat	62,000	57,676	93
2	- Sigurimet shoqërore	10,000	9,901	99
3	- Shpërblime, personel i jashtëm/dëmshpërblim	5,800	1,904	32
4	- Shteti Tatim Taksa	700	530	76
II	Furnitura	4,000	3,979	99
1	- Energji elektrike			
2	- Udhëtime dieta			
III	Shpenzime blerje (Mallra)	3,000	2,610	87
1	- Karburant			
2	- Vajra			
3	- Goma			
4	- Pjesë Këmbimi			
IV	Shpenzime për zhvlerësimin e aktiveve			

Burimi: Dokumente të SHA Porti Detar Shëngjin dhe përllogaritje të grupit të auditimit të KLSH

Për vitin 2019, Projekt programi ekonomik pasi është përgatitur nga shoqëria, me shkresën nr. 364 Prot., datë 26.11.2018, shoqëruar më mendimin e MPPT, dhe vendimin e këshillit mbikëqyrës nr. 09 datë 12.12.2018, MFE, ka miratuar programin e zhvillimit ekonomik të shoqërisë për vitin 2019 si vijon.

Tabela nr. 1 Programi dhe realizimi i treguesve ekonomik dhe financiar për 2019

Në mijë lekë

Nr	Emërtimi	Programi	Realizimi	Realizimi në %
1.	Të ardhura gjithsej	143,250	98,190	68.5
2.	Shpenzime gjithsej Nga këto: Telefon celular	138,500	130,840	94
		0.00		
3.	Fitimi bruto	4,75	-32.649	
4.	Tatim Fitimi	0,712	0	



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

5.	Fitimi neto	.	0	
6.	Investime	1,212,100	0	
7.	Numri i punonjësve (nr)	150	148	98
8.	Paga mesatare mujore (lekë)	33,333	33,527	100
9.	Fondi i Pagave	60,000	59,543	99

Burimi: Dokumente të SHA Porti Detar Shëngjin dhe përlogaritje të grupit të auditimit të KLSH

-Në programimin e të ardhurave, shoqëria ka parashikuar si volum pune ngarkim-shkarkimi prej 280,000 ton me një tarifë 363 lekë/toni, që do të sjellë të ardhura 99,250 mijë lekë, ose 55% e të ardhurave gjithsej, janë parashikuar të ardhura nga zënia e kalatës, aktivitet trageti, të ardhura nga qiratë, etj.

Parë në tërësi konstatohet se shoqëria rezulton me humbje në për vitin 2019 në vlerë 32,650 mijë lekë, nga 3 milionë lekë, programuar me fitim, si pasojë e mosrealizimit të disa treguesve krahasuar me programin si:

-Volumi i ngarkim shkarkimit në më pak të ardhura prej 18,923 mijë lekë, si pasojë e mosrealizimit të volumit të punës prej 52,128 ton.

-Mosrealizimi i të ardhurave nga zënia e kalatës prej 1,320 mijë lekë.

-Përpunimi i trageteve prej 10,000 mijë lekë.

Realizimi i të ardhurave është në masën 68.5 %, flet për një programim jo të saktë dhe mbi baza reale referuar kapaciteteve për realizimin e tyre dhe punë e pamjaftueshme nga strukturat drejtuese të shoqërisë.

Referuar realizimit të volumit të punës për vitin 2018, ku realizimi i volumit të punës është 200,826 ton, nga strukturat drejtuese të portit programimi i volumit të punës prej 280,000 ton, është parashikim euforik dhe i parealizueshëm në kushtet ku në vitin 2018, nuk u realizuan investimet e parashikuara për përmirësimin e kushteve të punës në Port, si edhe nuk janë paraqitur politika të studiuara marketingu për rritjen e volumit të punës, etj.

-Programimi i shpenzimeve, është bazuar në nivelin e realizimit të vitit 2018, Shpenzimet janë realizuar në masën 94 %,

Investimet janë parashikuar të realizohen kryesisht me fondet e buxhetit të shtetit në shumën 1,145,845 mijë lekë, ku peshën kryesore e zë “Vazhdimi i ndërtimit të kalatës lindore”, po kështu është parashikuar financimi i punimeve për financimin e punimeve për “Thellimin e basenit të portit faza V”, pasi pa këtë financim Kalata e re e ndërtuar nga fondet e BE nuk mund të vihet në punë. Nga porti Detar Shëngjin nuk është realizuar asnjë nga investimet e parashikuara, realizimi i investimeve është 0.

Realizimi i të ardhurave sipas burimeve të krijimit, për vitin 2019 paraqitet në vijim.

Tabela nr. 2 Programi dhe realizimi i të ardhurave për vitin 2019

Në mijë lekë

Nr	Treguesit	Programi	Realizimi	%
1	Të ardhura gjithsej	143,250	98,190	68.5
a	Nga përpunimi i anijeve	79,000	63,980	81
b	Nga përpunimi i trageteve	23,000	0	
c	Të tjera	5,250	4,200	80



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

d	Rimarrje amortizimi	36,000	30,000	83
---	---------------------	--------	--------	----

Burimi: Dokumente të SHA Porti Detar Shëngjin dhe përlogaritje të grupit të auditimit të KLSH

Siç vërehet nga tabela e mësipërme, gjatë vitit 2019 në veçanti nuk janë realizuar të ardhurat nga përpunimi i anijeve, kjo për shkak të rënies së aktivitetit në sektorin e ndërtimit dhe rritjes së prodhimit vendas. Rritja e konsiderueshme e të ardhurave nga zëri “të tjera”, jo vetëm që shfaq mangësitë e programimit, por në të njëjtën kohë shfaq prirjen për sigurimin e të ardhurave jashtë aktivitetit kryesor të shoqërisë, duke shkaktuar paqëndrueshmëri financiare afatgjatë.

Në përpunimin e mallrave për vitin 2019, në portin e Shëngjinit është realizuar vëllimi i përpunimit në 227,872 ton kundrejt 280,000 ton të programuar, ose 19 % më pak nga parashikimi. Zërin kryesor në përpunimin e mallrave e zë përpunimi i klinker, i cili për portin e Shëngjinit është realizuar 159,702 ton.

Tabela nr. 3 Programi dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2019

Në mijë lekë

Nr	Treguesit Ekonomikë	Viti 2019		
		Programi	Realizimi	%
I	Shpenzime administrative	79,400	80,362	101
1	- Pagat	60,000	59,543	99
2	- Sigurimet shoqërore	10,000	10,188	101
3	- Shpërblime, personel i jashtëm/dëmshpërblim	5,800	5,250	90
4	- Shteti Tatim Taksa	600	411	68
II	Furnitura	4,400	3,320	75
1	- Energji elektrike			
2	-Udhëtime dieta			
III	Shpenzime blerje (Mallra)	3,000	1,650	55
1	- Karburant			
2	- Vajra			
3	- Goma			
4	- Pjesë Këmbimi			
IV	Shpenzime për zhvlerësimin e aktiveve			

Burimi: Dokumente të SHA Porti Detar Shëngjin dhe përlogaritje të grupit të auditimit të KLSH

Tabelë përmbledhëse krahasuese për 3 vitet

Në mijë lekë

Nr	Emërtimi	Viti 2017 Realizimi	Viti 2018 Realizimi	Viti 2019 Realizimi
1.	Të ardhura gjithsej	102,297	97,509	98,190
2.	Shpenzime gjithsej	142,186	130,180	130,840
	Nga këto: Telefon celular	0.00	0	0
3.	Fitimi bruto	-39,889	-32,671	-32,649
4.	Tatim Fitimi	00	0	0
5.	Fitimi neto	00	0	0
6.	Investime gjithsej:	00	0,114,	0
7.	Numri i punonjësve (nr)	147	149	148
8.	Paga mesatare mujore (lekë)	33,502	31,946	33,527
9.	Fondi i Pagave	59,100	57,676	59,543



KONTROLI I LARTË I SHËTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

Burimi: Dokumente të SHA Porti Detar Shëngjin dhe përlogaritje të grupit të auditimit të KLSH

-Realizimi i të ardhurave në 3 vite paraqitet në nivele: viti 2017 - 70%, viti 2018 - 80%, viti 2019 - 68.5%, pra aktiviteti kryesor për zhvillimin e shoqërisë është në rënie duke sjellë përkeqësim të situatës ekonomike dhe thellim të rezultatit ekonomik negativ me **humbje në shumën 105,210 mijë lekë**. Referuar treguesve, ndërsa të ardhurat dhe shpenzimet janë ulur, investimet nuk janë realizuar, numri i punonjësve, paga mesatare dhe fondi i pagave janë rritur.

-Shoqëria Porti Detar Shëngjin, për 3 vitet objekt auditimi, konstatohet se nuk ka realizuar investimet e parashikuara, pasojë e mungesës së financimeve të buxhetit të shtetit si edhe nga rënia volumit të punës në port, nuk janë realizuar investimet e parashikuara për përmirësimin e kushteve të punës në Port, si edhe nuk janë paraqitur politika të studiuara marketingu për rritjen e volumit të punës, etj. Po kështu konstatohet se ky rezultat ka ardhur edhe nga neglizhenca për ndjekjen e problematikave dhe mungesa e bashkëpunimit me ministrinë e linjës për realizimin e objektivave, nga strukturat drejtuese.

Realizimi i investimeve në nivel 0 për 3 vitet, flet për një punë të dobët nga strukturat drejtuese si edhe nga Dega e investimeve, e cila përbëhet nga 6 punonjës, 1 shef sektori dhe 5 specialistë. Në këto kushte numri i punonjësve nuk justifikon punën e kryer nga dega e investimeve, por është një risk i lartë për përmirësimin e rezultatit ekonomik dhe vazhdimin e aktivitetit të ndërmarrjes.

-Shoqëria për 3 vitet, nuk ka realizuar të ardhurat nga përpunimi i anijeve, i cili është aktiviteti kryesor i punës dhe krijimit të të ardhurave, kjo për shkak të rënies së aktivitetit në përpunimin e anijeve. Rritja e të ardhurave nga zëra “të tjerë”, jo vetëm që shfaq mangësitë e programimit, por në të njëjtën kohë shfaq prirjen për sigurimin e të ardhurave jashtë aktivitetit kryesor të shoqërisë, duke shkaktuar paqëndrueshmëri financiare afatgjatë.

Si përfundim, konstatohet se programi ekonomik i shoqërisë për 3 vitet 2017, 2018 dhe 2019, nuk është hartuar saktë mbi baza reale referuar kapaciteteve për realizimin e treguesve ekonomiko-financiarë si edhe flet për punë të pamjaftueshme nga strukturat drejtuese të shoqërisë.

Aneks 4

4. Mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

-Struktura organizative e “Porti Detar Shëngjin” SHA është miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës Nr. 3, datë 11.01.2017 me një total prej 149 vetë dhe ka mbetur e pa ndryshuar deri 09.2.2018. Kjo strukturë është rritur në 157 veta në vitin 2018 me vendimin nr.1 datë 09.02.2018. Kjo strukturë përbëhet dhe organizohet nga Drejtori i Përgjithshëm dhe 3 nëndrejtorë. Degët kryesore janë Dega teknike dhe e Investimeve e përbërë nga 18 punonjës, Dega e financës e përbërë nga 5 punonjës, Ngarkim Shkarkimi e përbërë nga 62 punonjës, drejtoria e emergjencave civile 27 punonjës etj.

Programi dhe realizimi i numrit mesatar të punonjësve.

Total	Numri mesatar i punonjësve	Fondi i pagave në mln/lekë	Paga mesatare mujore në lekë
-------	----------------------------	----------------------------	------------------------------



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

Vitet	Prog.	Realiz.	Prog.	Realiz.	Prog.	Realiz.
2017	146	147	62,000	59,100	35,388	33,502
2018	150	149	60,000	57,676	34,247	31,946
2019	150	149	60,000	59,543	33,333	33,527

Burimi: Të dhëna nga Porti Detar Shëngjin

Nga evidenca rezulton se për vitin 2018 është parashikuar një rritje e numrit të punonjësve si rezultat i miratimit të strukturës së re të portit me vendimin nr. 3, datë 09.02.2018 kjo për arsye se janë bërë disa ndryshime nga struktura ekzistuese duke shtuar sektorë me miratim nga Këshilli Mbikqyrës. Fuqia punëtore është rritur pa asnjë analizë ekonomike, nisur edhe nga fakti se për këtë vit e në vazhdim gjatë 2019 volumi i punës në këtë port ka ardhur në rënie. Për rrjedhojë numri i punonjësve duhet të vinte në ulje e jo në rritje si është vepruar në fakt nga strukturat drejtuese. Kjo shoqëri, në numër punonjësish tejkalon edhe numrin e punonjësve të Portit Detar të Vlorës i cili për nga aktiviteti është në nivele shumë më të larta (volum pune + pasagjerësh) ndërkohë që operon një strukturë e miratuar me 120 punonjës.

(Më hollësisht trajtuar në Aneks 4, pikën 4 faqet nr. 89-93 të këtij Raporti).

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi z.Gj. T. ish-Administrator, E. P. ish-Administrator, Gj. P. me detyrë Administrator i Shoqërisë, K. M., me detyrë shefe sektorit të Burimeve Njerëzore, D. M., me detyrë shefe sektorit të financës.

Aneks 4.1

Sektori administratës, ri llogaritje e pagave VITI 2017

Nr	Emër Mbiemër	Pozicioni në sistemin tatimor	Pozicioni kontratë punës	Paga sipas kontratës punës	Niveli referues i pagave 2017 sipas KM	Paga në sistemin tatimor janar-dhjetor 2017	Diferencat 2017 (pozicioni kontratës-niveli referues KM)
1	Gj. M.	Ekonomist finance dhe banke	Ekonomist banke	62.000	42.670	67.860	302.280
2	B. M.	Nëpunës finance	ZV përgjegjës zyra financës	65.000	42.670	65.000	156.310
3	M. M.	Juriste	Juriste	64.000	56.200	64.000	85.800
4	S. D.	Specialiste të sigurimit teknologjisë informacionit dhe komunikimit, specialistë IT	Përgjegjës për teknologjinë e info në sektorin e sigurisë, oficer sigurie	60.000	40.820	60.000	230.160
5	L. M.	Specialist infrastrukturën mjedisin	Specialist marketingu	55.000	44.540	55.000	115.060



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

6	T. N.	Specialist infrastrukturën për dhe mjedisin	Përgjegjës investimesh	67.860	67.860	68.000	1.540
7	M. P.	Përgjegjës i repartit të zjarrefikësës	Përgjegjës për sektorin e zjarrefiksëve	33.840	34.040	55.000	236.405
8	S. T.	Drejtor marketingu	Zv përgjegjëse e zyrës marketingut	48.000	44.540	48.000	31.203
9	A. V.	Specialist i programeve të burimeve mbrotjes	Jurist	55.000	40.820	66.560	273.631
10	D.M.	Specialist i programeve të burimeve mbrotjes	Punonjës për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve	66.560	40.820	66.560	180.180
11	E. K.	Përgjegjës sektori në administratë&fushë sociale	Përgjegjëse burimeve njerezore	68.000	67.860	73.000	61.680
12	D. M.	Përgjegjës sektori në administratë&fushë sociale	Shefe zyrës finances	65.000	67.860	72.000	49.680
TOTALI							1.723.929

Anex 4.2: Sektori administratës, ri llogaritje e pagave JANAR 2018

		Sistemi tatimor	pagat ST	Niveli referues KM vendimi 2017	Diferencat janar 2018
1	Gj. M.	ekonomist finance dhe banke	67.860	42.670	25.190
2	B. M.	nepunes finance	65.000	42.670	22.330
3	m. m.	juriste	64.000	56.200	7.800
4	s. d.	specialiste te sigurimit te teknologjise informacionit dhe komunikimit, specialiste IT	60.000	40.820	19.180
5	A. K.	specialist per infrastrukturën dhe mjedisin	55.000	44.540	10.460
6	T. P.	pergjegjes i repartit te zjarrefikeses	55.000	67.360	-12.360
7	M. p.	pergjegjes i repartit te zjarrefikeses	33.840	34.040	-200
8	s. t.	drejtor marketingu	48.000	44.540	3.460



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

9	a. v.	specialist i programve te burimeve te mbrotjes	41.204	55.000	-13.796
10	d. m.	specialist i programve te burimeve te mbrotjes	66.560	40.820	25.740
11	E. K.	pergjegjes sektori ne administrate&fushe sociale	73.000	67.860	5.140
12	D. M.	pergjegjes sektori ne administrate&fushe sociale	72.000	67.860	4.140
13	S. F.	Drejtor I burimeve njezore	68.000	44.540	23.460
14	F. Gj.	Specialist menaxhimi sisteme telefonik	49.500	40.820	8.680
15	R. m.	Shofer	48.540	27.580	20.960

150.184

Anex 4.3: Sektori administratës, ri llogaritje e pagave Viti 2018

		Sistemi tatimor	Pozicioni kontratë punës 2018	Paga sipas kontratës punës 2018	Niveli referues pagave KM	Diferencat janar dhjetor 2018 (Sistemi tatimor - niveli referues)
1	Gj. M.	ekonomist finance dhe banke	Ekonomist banke	62.000	62.000	8.371
2	B. M.	nepunes finance	zv pergjegjes	65.000	48.000	26.284
3	B. M.	ekonomist per turizem	Specialist turizmi	48.000	48.000	0
4	M. m.	juriste	juriste	64.000	48.000	41.713
5	G. M.	Juriste	specialist jurist pastaj shef zyra juridike	48000 dhe 60000	48000 dhe 60000	30.000
6	A. K.	specialist per infrastrukturen dhe mjedisin	Agjent marketingu	48.000	48.000	0
7	T. P.	pergjegjes i repartit te zjarrefikseses	Përgjegjës për sektorin e zjarrefiksëve	65.000	65.000	0
8	M. p.	pergjegjes i repartit te zjarrefikseses	Specialist promocioni	48.000	48.000	0
9	S. T.	drejtor marketingu	Specialiste investimesh	45.000	45.000	27.856
10	A. V.	specialist i programeve te burimeve te mbrotjes	juriste	55.000		18.560



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

11	D. M.	specialist i programeve te burimeve mbrotjes	Punonjës në sallën operative	27.000	27.000	16.953
12	F. P.	nëpunës investimesh	Punonjës në sallën operative	27.000	27.000	0
13	E. K.	pergjegjes sektori ne administrate&fushe sociale	Përgjegjëse zyrës investimeve	65.000	65.000	24.284
14	D. M.	pergjegjes sektori ne administrate&fushe sociale	Shefe zyrës finances	65.000	65.000	9.998
15	S. F.	Drejtor I burimeve njerezore	Përgjegjës burimeve njerezore	58000		4.285
16	F. Gj.	Specialist menaxhimi sisteme telefonik	Specialist zjarrëfikës	48000		221
17	R. m.	Shofer	Furnitor	45000		1.928

210.453

Anex 4.4: Sektori administratës, ri llogaritje e pagave Viti 2019

		Sistemi Tatimor	Kontrate pune	Niveli referues 2019	Diferencat
1	G. M.	Juriste	shef zyra juridike	60.000	31.517
2	V. M.	Juriste	shef zyra juridike		0
3	E. K.	pergjegjes sektori ne administrate&fushe sociale	Përgjegjëse zyrës investimeve	65.000	41.000
4	S. F.	Drejtor I burimeve njerezore	Përgjegjës burimeve njerezore	58.000	40.000
5	K. M.	Drejtor i administrates		58.000	0
6	J. D.	Vincier	Vincier	26.000	233.626
					346.143

Aneks 5 Rregullshmëria e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe blerjet me të vogla

- *Urdhër prokurimi nr.67/1, datë 20.12.2017 “Blerje kompjuter”* fondi limit 97,300 lekë.

Procesverbal për llogaritjen e fondit limit datë 19.12.2017, bazuar në ofertat që kanë marrë pjesë në konkurim, ofertat e paraqitura janë pa data dhe nuk mund të gjykohej për kohën e



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

marrjes së tyre, Ofertat: A. me vlerë 96,900 lekë, E. I. me vlerë 96,000 lekë dhe M. L. me vlerë 99,000 lekë. Shpallur fitues E. I. me vlerën më të ulët

Procesverbal marrje në dorëzim datë 22.12.2017, komisioni konfirmon se malli është sipas specifikimeve teknike të kërkuara. Specifikimet teknike mungojnë, në kundërshtim me ligjin nr.9643 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 23 “Specifikimet teknike”.

-Urdhër prokurimi nr.62/1, datë 07.12.2017 “Riparim tarace” fondi limit 100,000 lekë.

Procesverbal për llogaritjen e fondit limit datë 07.12.2017, bazuar në ofertat që kanë marrë pjesë në konkurim, ofertat e paraqitura janë pa data dhe nuk mund të gjykohet për kohën e marrjes së tyre, Ofertat: O. me vlerë 106,444 lekë, D. me vlerë 98,220 lekë dhe F. me vlerë 99,992 lekë. Shpallur fitues D. me vlerën më të ulët. Procesverbal marrje në dorëzim datë 16.12.2017, në të cilin konfirmohet se kryerja e punimeve është sipas specifikimeve teknike të kërkuara. Specifikimet teknike mungojnë.

- Urdhër prokurimi nr.62/2, datë 12.12.2017 “Riparim zyra drejtorit” fondi limit 100,000 lekë.

Procesverbal për llogaritjen e fondit limit datë 11.12.2017, ku janë paraqitur ofertat që kanë marrë pjesë në konkurim, ofertat e paraqitura janë pa data dhe nuk mund të gjykohet për kohën e marrjes së tyre. O. me vlerë 101,104 lekë, D. me vlerë 99,430 lekë dhe F. me vlerë 99,997 lekë. Shpallur fitues D. me vlerën më të ulët. Procesverbal marrje në dorëzim datë 15.12.2017, ku konfirmohet se kryerja e punimeve është sipas specifikimeve teknike të kërkuara. Specifikimet teknike mungojnë.

-Urdhër prokurimi nr.56/2, datë 05.12.2017 “Riparim kondicioneri” fondi limit 100,000 lekë
Procesverbal për llogaritjen e fondit limit datë 05.12.2017, ku janë paraqitur ofertat që kanë marrë pjesë në konkurim, ofertat e paraqitura janë pa data dhe nuk mund të gjykohet për kohën e marrjes së tyre, Ofertat: S. L. me vlerë 99,000 lekë, M. Xh. me vlerë 100,000 lekë dhe C. me vlerë 101,000 lekë. Shpallur fitues L. me vlerën më të ulët. Procesverbal marrje në dorëzim datë 15.12.2017, ku konfirmohet se kryerja e punimeve është sipas specifikimeve teknike të kërkuara. Specifikimet teknike mungojnë.

-Urdhër prokurimi nr.60/1, datë 07.12.2017 “Tabela ndriçimi sinjalistike” fondi limit 100,000 lekë

Procesverbal për llogaritjen e fondit limit datë 06.12.2017, nuk ka bazë për llogaritje të fondit limit. Procesverbal marrje në dorëzim datë 14.12.2017, të cilët konfirmojnë se kryerja e punimeve është sipas specifikimeve teknike të kërkuara. Specifikimet teknike mungojnë. Mungon procesverbali vlerësimit të ofertave nga komisioni, datë 06.12.2017 fitues Ulaj me vlerën 98,000lekë, e vetmja ofertë e paraqitur.

-Urdhër prokurimi nr.56/1, datë 04.12.2017 “Spot televiziv” fondi limit 100,000 lekë

Procesverbal për llogaritjen e fondit limit datë 04.12.2017, ku janë paraqitur ofertat që kanë marrë pjesë në konkurim TV Lezha me vlerë 85,000 lekë, R. TV me vlerë 86,000 lekë, Kukës TV me vlerë 86,500 lekë. Shpallur fitues TV Lezha me vlerën më të ulët.

Ofertat e paraqitura janë pa data dhe nuk mund të gjykohet për kohën e marrjes së tyre për efekt të llogaritjes së fondit limit. Procesverbal marrje në dorëzim datë 16.12.2017, ku konfirmohet se kryerja e punimeve është sipas specifikimeve teknike të kërkuara. Specifikimet teknike mungojnë, nuk ka përcaktuar nr/ditë të spoteve, kohëzgjatjen, mënyrën e paraqitjes së spotit me zë dhe figure apo me titra, tekstin, etj, element të domosdoshëm për kryerjen e shërbimit.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

-Urdhër prokurimi nr.72, datë 02.07.2018 “Riparim kondicionerë” fondi limit 98,900 lekë.

Procesverbal për llogaritjen e fondit limit datë 02.11.2018, ku janë paraqitur ofertat që kanë marrë pjesë në konkurim E. D. me vlerë 99,800 lekë, E. I. me vlerë 99,400 lekë dhe M. K. me vlerë 97,500 lekë. Shpallur fitues M. K. me vlerën më të ulët

Ofertat e paraqitura për llogaritjen e fondit limit datojnë më 07.11.2018, pra si u llogarit fondi limit në 02.11.2018? Specifikimet teknike mungojnë. Në datën 09.11.2018 janë studiuar 3 ofertat. Procesverbal i marrjes në dorëzim i shërbimit datë 07.11.2018 E. D., S. T. dhe F. M., pram ë pare se të shpallej oferta fituese ë kryer marrja në dorëzim. Fatura nr.194, datë 07.11.2018 shuma 117,000 lekë.

-Urdhër prokurimi nr.72, datë 02.07.2018 “Riparim kompjutera” fondi limit 99,050 leke

Procesverbal për llogaritjen e fondit limit datë 06.11.2018, ku janë paraqitur ofertat që kanë marrë pjesë në konkurim, Ofertat: E. D. me vlerë 99,400 lekë, E. I. me vlerë 99,750 lekë dhe M. K. me vlerë 98,000 lekë. Këkesa për kryerjen e shërbimit në datën 02.11.2018 nga S. F.. Ofertat e paraqitura për llogaritjen e fondit datojnë më 07.11.2018, pra si u llogarit fondi limit në 06.11.2018? Specifikimet teknike mungojnë. Në preventivin e datës 06.11.2018 për llogaritjen e fondit limit komisioni ka përcaktuar përshtkrimin e shërbimeve si: Formatim për 7 kompjutera, Bllok PSU 3 copë, Motherboards 3 copë, UPS bateri 6 copë, Antivirus 7 copë dhe VGA servis për 7 copë. Specifikimet dhe identifikimi defekteve nuk pasqyrohen asnjë procesverbal të mbajtur. Shpallur fitues M. K. me vlerën më të ulët

Procesverbal i marrjes në dorëzim të shërbimit datë 12.11.2018 E. D., S. T. dhe F. M.

- Urdhër prokurimi nr.72, datë 02.07.2018 “Riparim pompe naftë piru Toyota dhe i pjesëve motorike xhenerike piru COMATSU” fondi limit 99,500 leke

Procesverbal për llogaritjen e fondit limit datë 02.11.2018, ku janë paraqitur ofertat që kanë marrë pjesë në konkurim, Ofertat: Pagle exelence me vlerë 100,500 lekë, S. me vlerë 98,000 lekë dhe P. Group me vlerë 100,000 lekë. Shpallur fitues S. me vlerën më të ulët. Këkesa për kryerjen e shërbimit në datën 02.11.2018 nga A. P.. Procesverbal i marrjes në dorëzim të shërbimit datë 05.11.2018 specifikimet dhe identifikimi defekteve nuk pasqyrohen në asnjë procesverbal të mbajtur.

Procedura është zhvilluar brenda 1 dite që nga kërkesa për kryerjen e shërbimit, vlerësimi i ofertave, shpallja e fituesit, kryerja e shërbimeve, marrja në dorëzim dhe paraqitja e faturës tatimore për likuidim. Pra, nuk është në dispozicion koha e mjaftueshme për kryerjen e shërbimit brenda 1 dite. Procedura është zhvilluar formalisht. Po kështu në strukturën e shoqërisë miratuar me vendimin nr.3, datë 09.02.2018 janë përcaktuar funksionimi i sektorit mekanik dhe oficinës me 12 punonjës ku në përbërje të tij janë 2 mekanikë, 1 motorist, 1 pompist dhe 1 xhenerik, pra në këto kushte AK nuk duhet të zhvillonte procedura prokurimi (drejtori E. P.) pasi punonjësit për kryerjen e shërbimit janë në organikën e shoqërisë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

- **Urdhër prokurimi nr.72, datë 02.07.2018 “Riparim dyer dritare zyrave”** fondi limit 96,650 leke Procesverbal për llogaritjen e fondit limit datë 20.09.2018, ku komisioni citon se llogaritja është kryer sipas manualit të ndërtimit por në fakt nuk ka asnjë dokument. Këkesa për kryerjen e shërbimit në datën 21.09.2018 nga S. F., ose 1 ditë mbasi është nxjerrë urdhri i prokurimit. Specifikimet teknike mungojnë. Në preventivin për llogaritjen e fondit limit komisioni ka përcaktuar përskrimin e shërbimeve si edhe çmimet njësoj si situacioni i op ek. Marrja në dorëzim më datë 25.09.2018.

-**“Lyerje e godinës së Administratës”** me fond limit 623,828 lekë sipas procesverbalit llogaritjes së fondit limit datë 26.03.2019, urdher prokurimi nr. 16 datë 27.03.2019 për prokurimin me vlerë të vogël. Ftesa për ofertë datë 27.03.2019 me datë zhvillimi tenderi datë 28.03.2019 ora 14:00. Në kriteret e vecata të kualifikimit kërkohet 300 m2 skela.

Me procesverbalin datë 28.03.2019 nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël është pasqyruar klasifikimi perfundimtarë sipas sistemit të APP ku i klasifikuar i pari renditet “D.-G” me vlere oferte 199,324 lekë ku morë pjesë 24 operatorë.

Nga dokumentacioni i paraqitur ky operator me faturë nr. 172 datë 29.04.2014 disponon vetem 200 m2 skela, por nisur nga vlera me e vogël e ofruar KVO e ka kualifikuar dhe lidhur kontratë nga titullari.

Kontratat për pune civile nr. 62 prot. datë 29.03.2019 me nje afat perfundimi prej 5 ditësh.

Me shkresën nr. 72 datë 02.04.2019 titullari i Ak me urdhërin nr. 22 datë 02.04.2019 ka kjuar komisionin për marrjen në dorëzim të objektit të prokuruar “Lyerje të godinës së Administratës”. Më datë 03.04.2019 komisioni i marrjes në dorëzim ka hartuar aktin për marrjen në dorëzim sipas kontratës, po në këtë datë është lëshuar dhe fatura tatimore nr.8 datë 03.04.2019.

Punimet janë kryer.

- **“Riparim dhe kompletim i 4 magazinave”** të Portit detar Shëngjin me fond limit 790,000 lekë sipas procesverbalit llogaritjes së fondit limit datë 25.07.2019, urdher prokurimi nr. 34 datë 26.07.2019 për prokurimin me vlerë të vogël. Ftesa për ofertë datë 26.07.2019 me datë zhvillimi tenderi datë 29.07.2019 ora 09:00.

Me procesverbalin datë 29.07.2019 nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël është pasqyruar klasifikimi perfundimtarë sipas sistemit të APP ku i klasifikuar i pari renditet “D.-G” me vlere oferte 747,000 lekë ku morën pjesë 4 operatorë.

Kontrata pune civile nr. 168 prot. Datë 31.07.2019 me nje afat perfundimi prej 10 ditësh.

Me shkkresën nr. 179 datë 13.08.2019 titullari i AK me urdhërin nr. 35 datë 13.08.2019 ka kjuar komisionin për marrjen në dorëzim të objektit të prokuruar “Riparim dhe kompletimi 4 (katër) magazinave të Portit detar Shëngjin”.

Më datë 13.08.2019 komisioni i marrjes në dorëzim ka hartuar aktin për marrjen në dorëzim sipas kontratës.

- **“Sigurim Asetesh”** të Portit detar Shëngjin me fond limit 500,000 lekë sipas procesverbalit llogaritjes së fondit limit pa datë, urdher prokurimi nr. 02 datë 17.01.2019 për prokurimin me vlerë të vogël. Ftesa për ofertë datë 17.01.2019 me datë zhvillimi tenderi datë 18.01.2019 ora 13:00.

Me procesverbalin datë 18.01.2019 nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël është pasqyruar klasifikimi perfundimtarë sipas sistemit të APP ku i klasifikuar i pari renditet “ALBSIG” me vlere oferte 497,200 lekë ku morën pjesë 1 operatorë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

Kontrat pune civile nr. 168 prot. Datë 31.07.2019 me nje afat perfundimi prej 10 ditësh.

Me shkkresën datë 29.01.2019 komisioni për marrjen në dorzim të shërbimit të prokuruar “Sigurim Asetesh”.

Më datë 13.08.2019 komisioni i marrjes në dorzim ka hartuar aktin për marrjen në dorzim, policen e sigurimit nr. 59148663 dhe fatura tatimore nr.11 datë 23.01.2019 nga kompania Albsig.

- **“Blerje pajisje elektronike, kompjutera, printere dhe bateri(UPS)”** me fond limit 794,834 lekë sipas procesverbalit llogaritjes së fondit limit datë 23.01.2019, urdher prokurimi nr. 02/1 datë 24.01.2019 për prokurimin me vlerë të vogël. Ftesa për ofertë datë 24.01.2019 me datë zhvillimi tenderi datë 25.01.2019 ora 12:00.

Me procesverbalin datë 24.01.2019 nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël vendosi të ftoi për pjesmarrje 5 operatorë ekonomik.

Me procesverbalin datë 25.01.2019 nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël është pasqyruar klasifikimi perfundimtarë sipas sistemit të APP ku i klasifikuar i pari renditet “I.” me vlere oferte 600,000 lekë ku morë pjesë 28 operatorë.

Mbas procesverbaleve per njoftim fituesi dhe terheqjes se operatorëve apo mos paraqitjen e tyre, ne date 05.02.2019 komisioni njofton operatorin A. I renditur I 8 me ofertë ekonomike 737,000lekë.

Kontrat pune civile nr. 62 prot. Datë 29.03.2019 me nje afat perfundimi prej 5 ditësh.

Me shkkresën nr. 12/3 datë 08.02.2019 titullari I Ak me urdhërin nr. 02/3datë 08.02.2019 ka kjuar komisionin për marrjen në dorzim të objektit të prokuruar “Blerje pajisje elektronike, kompjutera, printere dhe bateri(UPS)”.

Më datë 08.02.2019 komisioni I marrjes në dorzim ka hartuar aktin për marrjen në dorzim sipas kontratës, po në këtë datë është lëshuar dhe fatura tatimore nr.78 datë 08.02.2019.

Nga verifikimi i mallrave u konstatua se Kompjuter Desktop, UPS 1200VA nuk janë në përputhje me specifikimet teknike.

Nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar kompjuteri sipas specifikimeve të mëposhtme dhe është furnizuar sipas kushteve të mëposhtme.

Kompjuter desktop	Specifikimet e kërkuara	Malli i Furnizuar (idokumentuar me foto)
Pikët minimum për procesorin	12,000	5,052
Ram	8GB	4GB
Hard DISK	500GB	120GB

Gjithashtu për sa i përket ups ajo është kërkuar 1200VA ndërkohë që është furnmizuar me 800VA ose 400VA amper më pak fuqi.

Sic shikohet Asnjë nga specifikimet e kërkuara nuk është respektuar nga operatori fitues A. e për rrjedhojë vlera prej 504,000 lek kompjutera dhe 49,000lek USP konsiderohet dëm ekonomik deri në momentin e zëvendësimit të produkeve nga operatori fitues A.

Për pranimin e mallit në kundërshtim me specifikimet teknike ngarkohet me përgjegjësi grupi i marrjes në dorzim i përbërë nga E. I., S. F. dhe A. P., për sa i përket E. I. pasi ju bënë më dije devijimet e produktit të pranuar, dhe nga ana e tij u morr një kopjo e dokumentacionin ai nuk e solli më mbrash sipas deikutimit verbal mes palëve.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

-“*Blerje mobilje zyre*” me fond limit 794,834 lekë sipas procesverbalit llogaritjes së fondit limit , urdher prokurimi për prokurimin me vlerë të vogël. Ftesa për ofertë datë 24.01.2019 me datë zhvillimi tenderi datë 25.01.2019 ora 12:00.

Me procesverbalin datë 20.06.2018 nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël vendosi të ftoi për pjesmarrje 5 operatorë ekonomik.

Më datë 04.07.2018 komisioni i marrjes në dorzim ka hartuar aktin për marrjen në dorzim sipas kontratës, po në këtë datë është lëshuar dhe fatura tatimore nr.1 datë 04.07.2018.

Nga verifikimi i mallarave u konstatua se të gjithë mallrat e furnizuara janë kërkuar M.D.F ndërkohë që i gjithë malli i furnizuar është Melamin një product i ngjashëm nga ana vizuale por jo në cilësi dhe në vlerë, produkti i cili ka një vlerë rreth 40% më të ulët krahsuar në librin dogonar të referencave.

Gjithashtu për sa i përket zërit 4 “Furnizim vendosje sirtaresh zyrash” me trashësi 4cm me *shina me thithje* dhe me 4 sirtarë u konstatua se ky produkt është furnizuar nga operatori fitues me 3 sirtarë dhe me shina të thjeshta që kanë një kosto minimale prej 150 lek çifti ndryshe nga shinat me thithje që fillojnë me 1500 lekë çifti.

Edhe pse me këto mangësi nga ana e grupit të marrjes në dorzim është pranuar dhe likuaduar me faturën nr. 1 datë 04.07.2018 me vlerë 652,800 me TVSH.

Për sa më sipër nga furnizimi me dijeni të produkteve jo në përputhje me specifikimet teknike me një efekt finaciare dëm ekonomik për shoqërinë pej 260,120 lekë vlerë e cila do të ktheht nga përfituesi.

Për sa më lart ngarkohen me përgjegjësi z. G. T. ish-Administrator, z.E. P.ish-Administrator , zj D. M. shefe e sektorit të financës, z. E. D., me detyrë specialist shërbimi, zj F. M., me detyrë specialiste marketingu , zj. S. T., me detyrë specialiste investimi, z. E. I., me detyrë specialist peshkimi, z. A. P., me detyrë shef i degës mekanike, zj. S. F., ish-shefe e burimeve njerëzore, zj. B. G., ish-specialiste investimi, z. B. M. specialist investimesh.

Aneksi 6 Mbajtja e evidencës kontabël, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilanceve

Gjatë vitit 2017 shoqëria ka llogaritur amortizimin si më poshtë

Emërtimi	Viti 2017			%
	Vlera mbetur 01.01.2017	Amortizimi 2017	Vlera e mbetur 31.12.2017	
Toka e ndërtesa	1.626.101.877	48.977.808	1.577.124.069	3%
Impiantemakineri	28.997.764	5.799.553	23.198.211	20%
Të tjera Ins. pajisje	9.397.572	2.266.953	7.226.619	24%
Shuma	1.664.497.213	57.044.314	1.607.548.899	

Kjo

tabelë nuk është e saktë pasi Toka nuk ka amortizim dhe ndërtesa duhet të amortizohet e ndarë. Gjithashtu shpenzimet e pazbritshme janë në shumën 200,000 lekë dhe kjo shumë i shtohet humbjes apo fitimit para tatimit, duke krijuar një rezultat tjetër tatimor real.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

Edhe pse shoqëria është me humbje llogarit amortizim në kufijt ligjorë.

Ndërtesat nuk është e nevojshme të amortizohen në maksimumin ligjor pasi kanë jetëgjatësi deri në 100 vjet dhe nuk amortizohen brenda 20 vjetëve. Kufiri ligjor për ndërtesat nuk specifikon normën minimale por citon se mund të amortizohen deri me 5% të vlerës së mbetur duke lënë mundësinë që shoqëritë të cilat rezultojnë me humbje të mund të ulin humbjen e tyre. Pas miratimit të PF të vitit 2018 është marrë vendimi i asamblesë së ortakëve që të shkurtohen shpenzimet dhe stafi, vendim që nuk është zbatuar pasi struktura e vitit 2019 vazhdon e njëjta. Nuk ka shkurtim të pozicioneve të punës dhe pse nuk është i njëjti fluks pune si në vitet e mëparshme, duke ngarkuar shoqërinë me detyrime për paga edhe në kushtet e humbjes.

Duke marrë parasysh efektin negativ që shkakton norma e lartë e amortizimit, efektin negativ që shkaktojnë shpenzimet për paga, dëmet në paga dhe blerje mund të ndryshonte rezultati financiar i shoqërisë

-Në pasiv dhe në seksionin detyrime afatgjata llogaria 4661 të ardhura të shtyra është njohur një grant qeveritar në shumën 649,774,625 lekë për vitin 2017 dhe 617.285.894 lekë për vitin 2018 kontabilizuar sipas SKK nr. 10.

-Ka një listë me debitorë detyrimi i të cilëve është rritur në vitin 2018 me 31% në krahasim me vitin 2017.

Debitorët	Debitorët 2017	Debitorët 2018	% rritjes
Ngarkim shkarkim	8.433.416	10.184.672	17%
Tarifa portuale	1.042.503	3.739.880	72%
Qira	670.579	826.579	19%
Shuma totale	10.146.498	14.751.131	31 %

Debitorët kryesorë të vitit 2017-2018 paraqiten në tabelë

Viti 2017	Rafaello 2002	Colacem Albania	Kadeli Shëngjin	Shega Trans	Rozafa Fish	Cna DR	Të tjerë
Ngarkim shkarkim	43%	13%	20%				24%
Tarifa portuale	55%				26%		19%
Qira		21%			70%		9%
Viti 2018							
Ngarkim shkarkim							
Tarifa portuale	64%			29%			7%
Qira					56%	29%	15%

Debia është rritur si pasojë e rritjes së detyrimeve për ngarkim shkarkim dhe detyrimeve për pagesën e tarifës portuale ku debitori kryesor është R.. 2002 pasuar nga C. A.. Ka rritje të detyrimeve për qira kryesisht nga debitori C. DR dhe të tjerë me 15% të detyrimit. Në lidhje me 2 debitorët kryesorë shoqëria ka nënshkruar marrëveshje për shlyerjen e detyrimit me pjesë ndërsa në lidhje me debitorët e tjerë verëhet një ulje e detyrimit në 2018 në krahasim me 2017



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

duke rritur arkëtimet. Gjithsesi shuma e përgjithshme e debisë është rritur pasi përqindja e debisë së debitorëve kryesorë është më e lart se përqindja e debisë së gjithë debitorëve të tjerë. Në vitin 2017 shoqëria ka pasur probleme edhe me shlyerjen e paradhënieve për paga në kohë reale, problem që e ka përmirësuar në vitin 2018.

Llogaria 423	Viti 2017	Viti 2018
Detyrime mbi 1 vit	637,743	0
Detyrime nën 1 vit	133,500	75,500
	771,243	75,500

Llogaria 467	Viti 2017	Viti 2018
Firma D. "E" akt kontrolli	533.200	533.200
Detyrime nën një vit (Bileta)	420.000	410.000
M. N.	20.000	20.000
H. N.	40.000	0
P.V.,H.N., M.N.,V.B.	256.500	306.500
V. B.	40.000	20.000
P.V.,H.N., M.N.,V.B. (500)	43.500	43.500
TOTALI	953.200	943.200

Nuk është bërë asgjë për arkëtimin e detyrimit nga kompania "D. E" dhe ndaj personave të cilët kanë detyrime të cilat aktualisht kanë kaluar periudhën një vit dhe nuk janë shlyer as duke u mbajtur nga pagat dhe as duke i dërguar ndonjë shkresë në lidhje me këtë detyrim. Nuk është bërë provizioni i këtij detyrimi i cili ka kaluar periudhën një vjeçare dhe mund të mos jetë i arkëtueshëm. Provizioni është një detyrim aktual, për të cilin koha e shlyerjes ose shuma janë të pasigurta.

Arkëtimi i debitorëve do ta lehtësonte situatën financiare të Portit i cili ka prej vitit 2014 e në vazhdim që figuron me humbje dhe vjen duke u thelluar çdo vit.

Për sa më lart ngarkohen me përgjegjësi, z.E. P. ish-Administrator, zj D. M., me detyrë shefe e sektorit të financës.

Aneksi 7

7. "Zbatimi i ligjshmërisë në prokurimet për investime, për blerje mallrash e shërbimesh, si dhe zbatimi i kontratave".

Auditimi është kryer bazuar në ligjin nr.9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 19.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Dokumentet Standarde të Tenderit (DST) si edhe në udhëzimet dhe manualet e APP-së.

Auditimi është fokusuar në drejtim të:

-Parashikimi i fondit limit për çdo objekt të prokuruar, bazuar në çmimet e publikuara, përvojën e mëparshme ose testimin e tregut.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

- Argumentimi ligjor i procedurave të prokurimit që ka zgjedhur enti prokurues. Realizimi i parimeve të prokurimit publik, si transparenca, nxitja e konkurrencës, barazia e kandidatëve dhe përdorimi ekonomik dhe efektiv i fondeve publike.
- Zbatimi i procedurave të prokurimit, nga nxjerrja e urdhrat të prokurimit deri në shpalljen e fituesit.
- Lidhja dhe zbatimi i kontratave, kontrolli fizik për marrjen në dorëzim të mallrave.
- Kërkesat nga degët dhe programimi i nevojave për punë, mallra dhe shërbime.
- Regjistrat e parashikimit dhe realizimit të prokurimeve të hartuara nga Autoriteti Kontraktor.
- Arsyet e mosrealizimit të tenderave dhe a mund të ketë ndodhur që Autoriteti Kontraktor ka shmangur procedurat e tenderimit duke kryer procedura blerje me vlera të vogla.
- Respektimi i afateve nga paraqitja e regjistrat deri në marrjen në dorëzim të mallrave.
- Komisionet e marrjes në dorëzim të mallrave/shërbimeve.

Për vitin 2017, nga Autoriteti Kontraktor janë programuar dhe realizuar prokurimet si më poshtë:

- Janë programuar 19 procedura prokurimi me vlerë 1,400 mijë lekë, nga të cilat nuk është realizuar asnjë procedurë prokurimi.

000/lekë

N r	Objekti i prokurimit	Procedura	Fondi limit
1	Blerje naftë	Tender i hapur	3,000
2	Blerje motor vinçi	“ ”	1,800
3	Rikonstruksion i zyrave	“ “	3,000
4	Rikonstruksion rep.zjarrfikës	“ ”	2,000
5	Rikonstruksion i ofiçinës	“ “	1,000
6	Blerje uniforma siguria/zjarrfikës	“ “	2,000
7	Blerje kabine elektrike komplet	“ “	14,000
8	Blerje pajisje elektronike	“ “	1,500
9	Ndriçimi territorit te Portit	“ “	12,500
10	Blerje pajisje teknologjike (vinç)	“ “	50,000
11	Blerje pajisje teknologjike (pirunj)	“ “	5,000
12	Rikonstruksion i puntilit të vjetër	“ “	5,000
13	Asfaltimi i sipërfaqes së Portit (pjesa e mbetur)	“ “	4,000
14	Ndërtimi i skolieres lindore	“ “	55,000
1	Studim projektimi i kalatës	“ “	10,000



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

5	së re		
1 6	Transport vinçi elektrik nga APD	“ “	20,000
1 7	Thellimi i basenit të Portit	“ “	100,000
1 8	Lidhja e puntilit me kalatën lindore	“ “	10,000
1 9	Vazhdimi ndërtimit të kalatës së re	“ “	1,100,000
	Shuma		1,399,800

Autoriteti Kontraktor me shkresën nr.1, datë 16.01.2017 ka dërguar në Agjencinë e Prokurimit Publik regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike për vitin 2017 dhe me shkresën nr.7, datë 16.01.2018 ka dërguar regjistrin e realizimit të prokurimeve.

Për vitin 2018, nga Autoriteti Kontraktor janë programuar dhe realizuar prokurimet si më poshtë:

-Janë programuar 4 procedura prokurimi me vlerë 5,300 mijë lekë, nga të cilat është realizuar 1(një) procedurë prokurimi me objekt “Blerje uniforma për sektorin e sigurisë” me fond limit 1,250 mijë lekë.

Eshtë nënshkruar 1 kontratë me vlerë 1,249,920 lekë.

000/lekë

N r	Objekti i prokurimit	Procedura	Fondi limit	Vlera kontratës	Operatori ek fitues
1	Sigurimi i vinçit elektrik	Kërkesë/propozim	1,500	-	-
2	Blerje pajisje elektronike	“ ”	1,500	-	-
3	Sinjalistikë	“ “	1,000	-	-
4	Blerje uniforma	“ ”	1,300	1,250	Artan Shtjefni
	Shuma		5,300	1,250	

Autoriteti Kontraktor me shkresën nr.6, datë 12.01.2018 ka dërguar në Agjencinë e Prokurimit Publik regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike për vitin 2018 dhe me shkresën nr.4, datë 09.01.2019 ka dërguar regjistrin e realizimit të prokurimeve.

Për vitin 2019, nga Autoriteti Kontraktor janë programuar dhe realizuar prokurimet si më poshtë:

-Janë programuar 2 procedura prokurimi me vlerë 2,300 mijë lekë, nga të cilat është realizuar 1(një) procedurë prokurimi me objekt “Blerje karburant” me fond limit 1,300 mijë lekë.

Eshtë nënshkruar 1 kontratë me vlerë 1,300 mijë lekë.

000/lekë

N	Objekti i prokurimit	Procedura	Fondi limit	Vlera	Operatori
---	----------------------	-----------	-------------	-------	-----------



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

r				kontratës	ek fitues
1	Blerje naftë	Kërkesë/propozim	1,300	1,300	Kastarati
2	Sinjalistika e Portit	Kërkesë/propozim	1,000	-	-
	Shuma		2,300		

Autoriteti Kontraktor me shkresën nr.5, datë 09.01.2019 ka dërguar në Agjencinë e Prokurimit Publik regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike për vitin 2019 dhe me shkresën nr. 4, datë 09.01.2000 ka dërguar regjistrin e realizimit të prokurimeve.

-Në tenderin e zhvilluar me objekt **“Blerje uniforma pune për punonjësit e siguirisë”**.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Blerje uniforma pune për punonjësit e siguirisë”		
Urdhër Prokurimi Nr.313, Dt 03.10.2018	Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Specifikimet teknike Urdhër Nr. 310, datë 03.10.2018 G. M., ish jurist E. I., specialist peshkimi B. M., specialist turizmi	Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr.312 dt. 03.10.2018 S. F., ish shefe personeli L. Gj., shef sek ngarkim shkarkim B. G., ish spec investimeve
Lloji i Procedurës së Prokurimit “Kërkesë/propozim”		
Fondi Limit (pa tvsh) 1,427,400 lekë	Oferta fituese A. Sh.	Diferenca me fondin limit 177,480 Lekë
Data e hapjes së tenderit 16.10.2018	Burimi Financimit Fondet e shoqërisë	Operatorët Ekonomike Pjesëmarrës në tender “A. Sh. ” 1,249,920 lekë “M. ” nuk ka “P. ” 1,385,600 lekë “U. P. ” 1,390,000 lekë
Zbatimi i Kontratës		
Lidhja e kontratës Nr. 351 Datë 07.11.2018	Vlera e kontratës Lekë	1,249,920 Likujduar 1,499,904 Lekë me tvsh USH BKT datë 07.12.2018

-**Dosja e tenderit** është e painventarizuar dhe e pa arkivuar, *Njësia e Prokurimit* në përfundim të çdo procedure prokurimi dhe për çdo dosje nuk ka kryer inventarizimin e brendshëm të saj, në përputhje me nenin 30, Modeli nr. 8 “Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë”, miratuar nga DP e Arkivave, në zbatim të neneve 3 e 29 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”.

-**Llogaritja e vlerës së fondit limit** dhe hartimi i specifikimeve teknike datojnë më 02.10.2018, pra 1 ditë më parë se të dalë urdhri i kryetarit të AK për përcaktimin e anëtarëve të komisionit për llogaritjen e fondit limit dhe specifikimeve teknike.

Po kështu nuk përputhen artikujt e kërkuar nga AK me artikujt e marrë reference për llogaritjen



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

e fondit e limit dhe ato të specifikuar në procesverbalin e mbajtur këtë qëllim.

Referuar listës së artikujve të kërkuar nga shefi i sektorit të sigurisë A. Gj., janë kërkuar 14 artikuj për uniformat. Llogaritja e fondit limit nga grupi i ngritur për këtë qëllim është bërë për 9 prej tyre.

Në artikujt që nuk janë përfshirë për llogaritjen e fondit limit janë:

- Kostume shërbimi (xhakete, 2 palë pantallona, kapele sportive, kollare) 32palë/komplete
- Xhakovento të zeza doku 32 copë
- Këpucë dimërore 32 palë
- Këpucë verore 32 palë
- Logo krahu 32 copë
- Stema copë

Pra, sipas procesverbali të mbajtur në datën 02.10.2018 komisioni ka llogaritur fondin limit pa analizuar çmimet/artikujt që kërkohen dhe ka vendosur apriori vlerën e ofertave të marra nga operatorët ekonomikë, si mëposhtë:

- M. vlera - 1,421,400 lekë,
- A.-E. vlera - 1,618,200 lekë
- I. tekstile vlera 1,242,680 lekë

Llogaritja e fondit limit është kryer formalisht, veprime në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 19.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 59/2 “Për llogaritja e vlerës limit të kontratës”, ku citohet: “Në për llogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe a) çmimet e tregut; ose/dhe b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe c) çmimet ndërkombëtare, të shpallura publikisht”.

-Në dokumentet e tenderit të hartuara e miratuara nga AK, sipas procesverbalit të mbajtur për hartimin e dokumenteve të tenderit nga njësia e prokurimit, konstatohet se nuk janë argumentuar kriteret e vendosura, veprim në kundërshtim me nenin 61 “hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” ku citohet se: “Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.

-Në specifikimet teknike germa “d” dhe “e”, janë kërkuar:

d) bluza pambuku me mëngë të gjata

Ngjyra - e zezë

Materiali leshi 50% dhe akrilik 50%

Jaka V

Masat mbas lidhjes së kontratës

e) bluza pambuku me mëngë të shkurtra

Ngjyra - e zezë

Materiali leshi 50% dhe akrilik 50%

Jaka V



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

h) Pelerinë shiu, nuk është kërkuar asnjë specifikim.

Masat mbas lidhjes së kontratës

Pra, komisioni kërkon bluza pambuku me material leshi dhe akriliku, si edhe komisioni ka kërkuar në specifikime teknike që Uniformat të jenë të reja, veprime në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 23 “Specifikimet teknike” ku citohet se: *“Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve”* si edhe VKM nr.914, datë 19.12.2014, i ndryshuar, neni 59/2 “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës”, ku citohet: *“Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet”*.

-Sipas procesverbalit të datës 16.10.2018, ora 8.30, kvo ka marrë në shqyrtim mostrat e paraqitura nga operatori ekonomik fitues A. Sh. dhe i ka quajtur të rregullta sipas specifikimeve të kërkuara, por nga artikujt e kërkuar konstatohet se nuk është paraqitur modeli për 32 kostume shërbimi si edhe nuk ka pasur kërkesë nga AK për artikullin “rip sigurie” për të cilin është paraqitur model.

-Sipas procesverbalit të hapjes së tenderit janë paraqitur 4 operatorë ekonomikë, s’kualifikuar 2 operatorë ekonomikë për mangësi në dokumentacionin e kualifikimit, si edhe nuk ka dorëzuar ofertën ekonomike dhe dokumentet e kualifikimit 1 operator ekonomik, kvo ka shpallur fitues operatorin ekonomik që ka plotësuar kriteret e kualifikimit dhe paraqitur ofertën ekonomike me vlerën më të ulët.

Komisioni i pritjes së mallit sipas Urdhrit nr.351/1, datë 16.11.2018, i përbërë nga:

R. Xh., ish shef marketingu

A. K., specialist marketingu

G. M., specialist investimeve

-Nga auditimi i dosjes konstatohet se nuk janë paraqitur kërkesat nga AK për numrat e kostumeve, këmishave, këpucëve, etj, veprime në kundërshtim me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit ku kërkohet që numrat dhe masat do të përcaktohen me nënshkrimin e kontratës, pra as kontrata nuk ka aneks ku të jenë përcaktuar këto specifikime.

-Në tenderin e zhvilluar me objekt **“Blerje karburant”**.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Blerje karburant ”		
Urdhër Prokurimi Nr.6, Dt 28.01.2019	Hartuesit e Dokumenteve Tenderit	Komisioni i Vlerësimit Ofertave
Lloji i Procedurës së Prokurimit “Kërkesë/propozim”	Urdhër Nr. 3, datë 28.01.2019 G. M., ish jurist E. I., specialist peshkimi S. F., ish shefe personeli Specifikimet teknike Urdhër Nr. 4, datë 28.01.2019	Urdhër Nr.5 dt. 28.01.2019 S. M., ish zv drejtor L. Gj., shef sek ngarkim shkarkim A. P., ing mekanik



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

	D. M., shefe financës S. T., spec investime. G. M., punonjes investime	
Fondi Limit (pa tvsh) 1,300,000 lekë	Oferta fituese K.	Diferenca me fondin limit -
Data e hapjes së tenderit 11.02.2019	Burimi Financimit Fondet e shoqërisë	Operatorët Ekonomike Pjesëmarrës në tender “K. ” marzhi 4.9 % “D.&E.” marzhi 7.99% “O. dhe A.. ” marzhi 7.9%
Zbatimi i Kontratës		
Lidhja e kontratës Nr. -, Datë 11.03.2019	Vlera e kontratës 1,300,000 Lekë	Likuiduar 1,559,998 Lekë me tvsh USH BKT datë 02.04.2019

-Nuk janë kërkuar specifitime teknike, por vetëm Gazoil 10 ppm, nuk janë kërkuar specifitime teknike si viskoziteti, ndotja e përgjithshme, niveli i përmbajtjes së squfurit, densiteti, pika e flakërimit, etj, në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 23 “Specifikimet teknike” ku citohet se: Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.

-Në dokumentet e tenderit “kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë, nuk është kërkuar asnjë kriter /kualifikim.

-Për kapacitetin teknik AK ka kërkuar fletë analizë jo më vonë se 3 muaj nga një laborator i certifikuar në RSH, dhe nuk kërkohet asnjë e dhënë/parametër në lidhje me karburantin. Veprime në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 46 “Kualifikimi i kandidatëve” dhe VKM nr.914, datë 19.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku citohet se: “Në rastet kur njësia e prokurimit nuk ka kapacitetet e duhura për hartimin e kërkesave për kualifikim dhe/ose specififikimet teknike dhe/ose kriteret e vlerësimit, këto përgatiten nga struktura të specializuara për objektin që prokurohet, brenda autoritetit kontraktor apo edhe jashtë tij, kur kjo ekspertizë mungon. Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specififikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.-Në datën 11.02.2019 janë paraqitur në sistemin elektronik APP 3 operatorë ekonomikë:

Kastrati me marzh fitimi 4.9%

Bashkimi operatorëve D.&E. me marzh fitimi 7.99%

Bashkimi operatorëve O. dhe A. me marzh fitimi 7.9%



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

Sipas procesverbalit të mbajtur për vlerësimin e ofertave më 14.02.2019 janë kualifikuar të 3 operatorët ekonomikë dhe vlerësuar fitues operatori ekonomik “K.” me marzhin e fitimit më të ulët.

-Fletë hyrje nr.1, datë 12.03.2019

-Likuiduar sipas faturës tatimore nr.75, datë 12.03.2019 sasia 9694 litra me vlerë 1,299,999 lekë pa tvsh.

Pra, për sasinë vjetore të furnizuar nga operatori ekonomik “K.

” prej 9694 litra, referuar taksës së markimit të karburantit në grafikun e likuidimit të karburantit për të gjithë sasinë e furnizuar $0,614 \text{ lekë} + 20\% = 0,737 \text{ lekë} \times 9694 \text{ litra} = 7,114 \text{ lekë}$, likuiduar më tepër.

-Referuar kontratës së furnizimit me karburant rezulton se në nenin 2 që përcakton çmimin dhe vlerën e kontratës, është llogaritur edhe taksa e markimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të naftës, e cila bie në kundërshtim me VKM nr. 498, datë 30.5.2013 “Për përcaktimin e procedurave të shënjimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të naftës”, pikat 4.1 dhe 4.2, ku e përcakton qartë detyrimin se “Asnjë nga produktet e shënjimit nuk do të tregtohet në tregun e Republikës së Shqipërisë apo eksportohet jashtë tij, nëse nuk i është nënshtruar më parë shërbimit të shënjimit të ofruar nga koncesionari”, për këtë arsye kontrata me operatorin fitues duhet të ishte e mirë përcaktuar në termat ligjorë dhe të mos ishte kontratë tip, për të mos rënë ndesh me legjislacionin në fuqi.

Këto veprime ngarkojnë me përgjegjësi Njësinë Prokurimit për mos përcaktim të saktë të termave ligjorë të kontratës së furnizimit me karburant, referuar VKM nr.498, datë 30.5.2013 “Për përcaktimin e procedurave të shënjimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të naftës”, dhe një rritje të vlerës, për liter karburanti në kontratë në vlerën **7,114 lekë**, e cila është përfituar më tepër nga kontraktori.

Lidhur me observacionin Nr.137 prot., datë 14.04.2020 sqarojmë si më poshtë:

-Në lidhje me pretendimin se nuk duhen argumentuar kriteret e kualifikimit, pasi janë kërkesë ligjore e përcaktuar në dokumentet standarde, ju kujtojmë se jemi shprehur për argumentimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit referuar kërkesave të VKM nr.914, datë 19.12.2014.

-Pretendimi në lidhje me hartimin e specifikimeve teknike për 9 artikuj dhe jo për 14 të kërkuar, nuk qëndron pasi në VKM nr.914, datë 19.12.2014, neni 59/2 përcaktohet se llogaritja e vlerës së kontratës kryhet pas hartimit të specifikimeve teknike dhe për të gjithë artikujt që do të prokurohen.

-Në lidhje me pretendimin se operatori ekonomik ka sjellë modelet e veshjeve referuar një procesverbal, sqarojmë se nuk ka gjurmë me foto të modeleve si edhe nuk janë përcaktuar masat dhe numrat e veshjeve sipas personave që do ti përdorin, kërkesë kjo e përcaktuar në dokumentete tenderit. Pra, nuk janë të përcaktuar në kontratën e nënshkruar nga palët/në aneks kontratë numrat dhe masat sipas personave që do ti përdorin. Ju kujtojmë legjislacioni mbi prokurimin publik nuk merr parasysh lapsuset e njësisë së prokurimit ose komisioneve të ngritura për këtë qëllim, po kështu specifikimet teknike të veshjeve nuk janë hartuar drejt, psh janë kërkuar bluza pambuku me përbërje 50% lesh dhe 50% akrilik, etj. Observacioni nuk ka bazë ligjore dhe nuk merret në konsideratë.

Aneks 8



8. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit.

Gjatë auditimit rezultoi se procedurat apo proceset kryesore të përfshira në rregulloren e brendëshme të shoqërisë janë kryesisht sipas linjave funksionale të përgjegjëseve, por nuk përshkruajnë me detaje proceset, rrjedhën e punës dhe procedurat. Sa më sipër, në nenin 24 të rregullores së brendëshme, sektori i shërbimeve, mungojnë procedurat e inspektimit, formatet e akteve të miratuara, procedurat e raportimit dhe kompetencat e inspektorëve, dhe për pasojë raportet e inspektimeve të transportit dhe peshkimit.

Githashtu, nuk rezultoi të ketë urdhër për të përfshirë procedura dhe formate të miratuara për proceset kryesore të veprimtarisë së shoqërisë.

Në kundërshtim me pikën 2.3 të Urdhërit të Ministrisë së Financave Nr.16, datë 20.07.2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinorit të riskut në njësitë publike”, nuk ishin hartuar gjurmët e auditimit, listat e proceseve kryesore, në mënyrë që të parashikohej realizimi i procesit, përfshirja e sektorëve të ndryshëm, dokumentacioni i miratuar përkatës, si edhe identifikimi i riskut.

Mungesa e gjurmëve të auditimit nuk krijonte mundësinë për informimin e proceseve, për mbajtjen e një dokumentacioni përkatës të miratuar, për njohjen e procedurave të raportimit, veprimet ekonomike të caktuara përmes kontabilitetit, mbështetjen e proceseve nëpërmjet sistemeve të IT (teknologjisë dhe informacionit) si edhe sistemin e mbajtjes së dosjeve.

Gjatë auditimit rezultoi se nuk evidentohej risku, veçanërisht në sektorët operacionaal, si ngarkim – shkarkimi, për pasojë kishte ngjarje të mundshme që ndikonin në zbatimin e funksioneve kryesore të sektorëve përkatës. Ato ishin mospërdorimi funksional dhe për kohë të gjatë e mjeteve të ngarkim-shkarkimit, që ka shoqëria. Në këtë mënyrë, shoqëria operonte me mjetet e vetë operatorëve, duke përdorur tarifa më të ulta (të parashikuara në librin e tarifave si alternativë për raste pamundësie të përdorimit të mjeteve të veta të Portit). Faktorët, që ndikojnë këtu janë funksionimi stukturave, ndryshime në menaxhim, mungesa e stafit të nevojshëm, cilësia e sistemit të kontrollit të brendshëm, etj. Nga auditimi rezultoi se menaxhmenti jo vetëm nuk identifikonte risqet përkatës, por edhe nuk i regjistronte ato, me qëllim ndjekjen dhe monitorimin në regjistrin e riskut, me qëllimin final arritjen e objektivave.

Drejtori i portit në cilësinë e Nëpunësit Autorizues nuk ka siguruar se do të ndiqet qasja e përgjithëshme e rekomanduar për ngritjen, vlerësimin dhe përmisimin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, duke përfshirë hapat kryesore të vlerësuara të rëndësishme për një sistem të shëndoshë, sikurse janë lista me proceset kryesore dhe gjurmët e auditimit.

Personeli drejtues nuk merrte pjesë aktive në procesin e identifikimit, vlerësimit, dhe monitorimit të risqeve, me qëllim vendimmarrjen më të mirë, dhënien e garancisë të arsyeshme se objektivat do të arrihen, planifikim më të mirë të burimeve, si edhe adresim të prioriteteve.

Për sa më lart ngarkohen me përgjegjësi z. G. T. ish-Administrator, z.E. P. ish-Administrator, zj D. M., me detyrë shefe e sektorit të financës, z.G. M. ish-jurist, z.Xh.T., me detyrë shef i sektorit të Shërbimeve, z.L. Gj., me detyrë shef i degës së ngarkim shkarkimit.

për këtë çështje subjekti i audituar me shkresën nr.97/9 prot. datë 27.02.2020 ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

Në lidhje me inventarizimin, bashkëngjitur Urdhëri i Brendshëm për inventarizimin për ngritjen e komisionit të posaçëm. Në bazë të rregullores së brendëshme, p/sectorit mekanik propozon nxjerrjet jashtë përdorimit të mjeteve etj. kur ato amortizohen, si edhe në bazë të kësaj nuk ngarkohet me përgjegjësi për nxjerrjet jashtë përdorimit të mjeteve. Në vendimin nr.01. datë 09.02.2018 për miratimin e strukturës është parashikur se sektori i ngarkim-shkarkimit të jenë 4 peshues. Në strukturën e re do të merren masa, që kjo strukture të jetë funksionale. Në vazhdim do të merren masa që specialistët e peshkimit dhe transportit të mbajnë procedura dhe raporte inspektimi konform akteve të miratuara.

Observacioni, sa më sipër, nuk pranohet për arsye se: Në nenit 22, paragrafi 11, të rregullores së brendëshme me vendosjen e përgjegjësit të sektorit mekanik si kryetar i komisionit të inventarizimit, nuk ka sqaruar funksionin dhe rolin e plotë të përgjegjësive ndaj përdorimit të aktiveve përkatës. Prandaj është komentuar, nga ana jonë se me respektimin e paragrafit 81, e vijues, të Udhëzimit të Ministrisë të Financave, nr.30, dt. 27.12.2011, ku përmendet për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, udhëzimi i sipërpërmendur parashikon se inventarizimi kryhet nga një **komision i posaçëm** që krijohet me urdhër të Titullarit të njësisë publike ose Nëpunësit Autorizues të çdo niveli të njësisë publike. Lista e aktiveve për inventarizim hartohet nga **Nëpunësi Zbatues** në bazë të të dhënave të rregjistrave kontabël të aktiveve të njësisë, etj. Gjithashtu, sipas paragrafeve 95 dhe 98 të udhëzimit të mësipërm, nxjerrja e aktiveve të rëndësishme jashtë përdorimit është një proces që kryhet ose gjatë ose pas procesit të inventarizimit, dhe më tej **komisionet e vlerësimit dhe të nxjerrjes të aktiveve jashtë përdorimit** përgjigjen për zbatimin e ligjshmërisë dhe dhe kriterëve të miratuara në këtë udhëzim. Nga auditimi nuk rezulton raport i plotë lidhur me funksionin e pajisjeve të ngarkim shkarkimit si edhe masa të marra nga Drejtoria e Portit.

Në periudhën objekt auditimi, janë realizuar 8 kontrata me periudhë kohe deri në 1 vit dhe realizimi i tyre në 31. 12.2019 paraqitet si më poshtë:

Nr.	Emeritimi subjekteve dhëna me qira të	Tipi i pasurisë	Sip e objektit m2	Afati kontratës së qirase	Veprimtaria që kryhet	Qira Mujore +TVSH	Detyrimi progresiv 2017	Detyrimi progresiv 2018	Detyrimi progresiv 2019
1	"C." A.	shesh	200	05.05.2017-04.05.2018 (e rinovuar)	Sillose çimentoje	72000 lekë	144 000 lekë	72 000	0
3	E. Z.	shesh	100	01.05.2017-31.08.2017 (e rinovuar)	Aktivitet sportiv	24 000 lekë	0	0	-



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

4	V. I. P.	Magazini	50(200 në vitin 2019)	01.09.2017-01.09.2018 (e rinovuar)	magazini m	12 000 lekë 48 000 lekë (nga 01.11.2019)	60 000 lekë	24 000	96 000
5	R. sh.p.k.	Shesh	200	31.07.2019-31.07.2020	Nevoja të aktivitetit të peshkimit	48 000 lekë	466 579 lekë	466 579 lekë	562 579 lekë
6	E.Z.	shesh	150	01.06.2019-31.08.2019	Aktivitet sportiv	36 000 lekë	-	-	0
7	C...A. sh.p.k.	Shesh	200	28.03.2018-27.03.2019 (e rinovuar)	Kantier riparimi	48 000 lekë	-	240 000	120 000
V 8	Sh.T.Sh.a.	Zyra shërbimi	26.67	25.10.2018-24.10.2019	Transport mallrash	12 000 lekë		24 000	0
	Totali						670 579 lekë	826 579 lekë	788 579 lekë

Tab nr.1 Qiratë e realizuara 2017-2019

-Subjektet C. A., Sh.T. sh.a., E. Z., E. Z. kanë zero detyrime.

-R. sh,p,k me 96,000 lekë detyrime, meqenëse shuma 466,579 lekë rezulton e mbartur nga Gushti i vitit 2012.

-V. I.P.me 96,000 lekë detyrime.

-C...A. sh.p.k me 120,000 lekë detyrime.

-Nga auditimi konstatohet se për periudhën e auditimit shoqëria R. sh.p.k. rezulton me një shumë debitore 466 579 lekë, e mbartur nga Gushti i vitit 2012, për shkak të marrjes me qira të magazines nr.3 të portit me sipërfaqe 473.30 m² Nga auditimi konstatohet se nuk është bërë asgjë për arkëtimin e këtij detyrimi. Nga tabela e mësipërme më 31 Dhjetor 2019, nga kontratat e qirasë ndaj Sh.A Porti Detar Shëngjin, pas zbritjes 466 579 lekë të mbartura, rezulton se detyrimi për periudhën e auditimit në vlerën **312,000** lekë.

Nga auditimi rezultuan mangësitë si më poshtë:

-Nuk janë mbajtur proces-verbale për dorëzimin e objektit, veprime në kundërshtim me kërkesave me pikat 1 dhe 2 shkronjat (a), (b), (c), kapitulli VI, "Monitorimi i Kontratave", të V.K.M nr.54, datë 05.02.2014, "Për përcaktimin e kritereve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore".



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

- Kontratat e qirasë nuk janë miratuar në Këshillin Mbikëqyrës, veprime në kundërshtim me paragrafin 1, shkronja (b), kapitulli II sipas germave (a) dhe (b) kapitulli II i V.K.M nr. 54, datë 05.02.2014, "Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiletozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore".

Gjatë aktivitetit kryesor të përpunimit të mallrave, agjencitë spedicionare për përpunimin e mallrave kontraktajnë me Sh.A Porti Detar Shëngjin për çdo anije që ankorohet. Sipas kushteve të kontratës përpara lidhjes së kontratës spedicionari merr përsipër dorëzimin e dokumenteve shoqëruese të mallit, lejen e Autoritetit Doganor, kontratën ose prokurën nga pronari i mallit ose anijes, si edhe çdo dokument tjetër të kërkuar nga porti.

Procesi i përpunimit të mallrave mbështetet në tarifatat portuale të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë, bazuar në Urdhërin e Përbashkët Nr.3069, datë 14.6.2016 "Për Përcaktimin e Tarifave të Shërbimeve Portuale në Portet Detare Vlorë, Sarandë dhe Shëngjin". Gjithashtu, Sh.A. Porti Detar Shëngjin miraton çdo vit librin e tarifave portuale me vendim të Këshillit Mbikëqyrës. Me vendimin e fundit nr.10, datë 12.12.2018 është miratuar Libri i Tarifave Portuale për vitin 2019.

1.Lidhur me observacionin Nr.137 Prot. Datë 14.04.2020, mbi zbatimin e tarifës më të ulët me mjetet e vetë subjekteve privatë, gjatë ngarkim – shkarkimit, pranohet pjesërisht pretendimi i subjektit të audituar për arsye se:

-Në librin e tarifave për vitin 2019, miratuar me Vendimin Nr.10 datë 12.12.2018 të KM, nuk thuhet në asnjë vend se tarifatat e ngarkim shkarkimit varen nga kërkesa e anijes apo disponibilitetit të mjeteve të saja. Në librat e tarifave parashikimi i tarifave me mjetet e portit ose të firmave që operojnë në port, paraqitet si alternativë, kur mjetet e portit nuk janë disponibël për çfardo arsye.

-Nuk raportohet në Këshillim Mbikëqyrës mbi zbatimin e politikës tragtare me tarifa më të ulta për veprimtarinë e përpunimit të mallrave, konfoorm shkronjës (e) neni 8 i Rregullores së Brendëshme.

2.Në observacionin Nr.137 Prot. Datë 14.04.2020 lidhur me gjetjen dëm në formën e të ardhurave të munguara nga subjekti Velipoja Investment Projects ju bëjmë me dije se pranohet pjesërisht, për arsye si më poshtë:

-Kontratat e qirasë nr.111/7 prot. datë 01.09.2017 dhe ajo nr.294/3 datë 17.09.2018 në objektin e tyre nuk japin informacion të plotë mbi objektin e dhënë me qira. Ato e përshkruajnë objektin si magazine me 50m². Në fakt ajo është shesh magazinimi prej 50 m² brenda objektit Magazina Nr.4 me sipërfaqe 419 m², 12.45 m x 33.65m.

-Në kundërshtim me pikën 1, gërma c) pika 2, Kapitullit VI Monitorimi i Kontratave, sipas V.K.M nr. 54, datë 05.02.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiletozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore"

nuk ka asnjë proces-verbal për verifikim të ndryshimit të kushteve.

- Me rinovimin e kontratës datë 01.11.2019, ku sipërfaqia e dhënë me qira u bë 200 m², përsëri nuk kemi proces-verbal, dhe se meqenëse çelsin e magazinës nr.4 e posedonte vetëm subjekti me qira, u krye verifikimi i posedimit real, i cili vërtet ishte sipas kontratës datë 01.11.2019, por mungesa e proces-verbalit të ndryshimit të kushteve nuk vërteton se subjekti nuk e ka poseduar vendin që më parë.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË PORTIN DETAR
SHËNGJIN SHA

Për sa më lart ngarkohet me përgjegjësi z. Gj. T. ish- Administrator dhe Z. E.P. ish-Administrator.

1.Lidhur me observacionin Nr.137 Prot. Datë 14.04.2020, mbi zbatimin e tarifës më të ulët me mjetet e vetë subjekteve privatë, gjatë ngarkim – shkarkimit, pranohet pjesërisht pretendimi i subjektit të audituar për arsye se:

-Në librin e tarifave për vitin 2019, miratuar me Vendimin Nr.10 datë 12.12.2018 të KM, nuk thuhet në asnjë vend se tarifat e ngarkim shkarkimit varen nga kërkesa e anijes apo disponibilitetit të mjeteve të saja. Në librat e tarifave parashikimi i tarifave me mjetet e portit ose të firmave që operojnë në port, paraqitet si alternativë, kur mjetet e portit nuk janë disponibël për çfardo arsyeje.

2.Në observacionin Nr.137 Prot. Datë 14.04.2020 lidhur me gjetjen dëm në formën e të ardhurave të munguara nga subjekti Velipoja Investment Projects ju bëjmë me dije se pranohet pjesërisht, për arsye si më poshtë:

-Kontratat e qirasë nr.111/7 prot. datë 01.09.2017 dhe ajo nr.294/3 datë 17.09.2018 në objektin e tyre nuk japin informacion të plotë mbi objektin e dhënë me qira. Ato e përshkruajnë objektin si magazine me 50m². Në fakt ajo është shesh magazinimi prej 50 m² brenda objektit Magazina Nr.4 me sipërfaqe 419 m², 12.45 m x 33.65m.

-Në kundërshtim me pikën 1, gërma c) pika 2, Kapitullit VI Monitorimi i Kontratave, sipas V.K.M nr. 54, datë 05.02.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore" nuk ka asnjë proces-verbal për verifikim të ndryshimit të kushteve.

- Me rinovimin e kontratës datë 01.11.2019, ku sipërfaqia e dhënë me qira u bë 200 m², përsëri nuk kemi proces-verbal, dhe se meqenëse çelsin e magazinës nr.4 e posedonte vetëm subjekti me qira, u krye verifikimi i posedimit real, i cili vërtet ishte sipas kontratës datë 01.11.2019, por mungesa e proces-verbalit të ndryshimit të kushteve nuk vërteton se subjekti nuk e ka poseduar vendin që më parë.

Grupi i Auditimit

1. E. S.

2. S.H.

3. M. B..

4. A. R..